



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 2, 7 DHE 23 NËNTOR 2018**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 2, 7. I 23. NOVEMBRA 2018. GODINE**

**NËNTOR - NOVEMBAR
2018**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për referendum,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë,
10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare,
11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte të ndërtimit,
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e kompensimit për një (1) anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona,
14. Emërimi i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë,
15. Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë për vitin 2017,
16. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare,
17. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi,
18. Shqyrtimi i raportit vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017,
19. Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017,
20. Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala,
21. Kërkesa e GP të PSD për caktimin e kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë,
22. Kërkesa e GP të PSD për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o zaštiti vazduha od zagađenja,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o peticijama,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-064 o službenim praznicima u Republici Kosovo,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o referendumu,
7. Prvo razmatranje Nacrta zakona o međunarodnom privatnom pravu ,
8. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 02/L-31 o verskoj slobodi na Kosovu,
9. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 06/L-079 o efikasnosti energije,
10. Drugo razmatranje Nacrta zakona o slobodi pristupanja u nevladine organizacije;
11. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 05/L-132 o vozilima,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o građevinskim produktima,
13. Razmatranje Predloga-odluke za određivanje naknade za jednog (1) člana Komisije za imovinske zahteve i dva (2) člana Komisije za proveru i odlučivanju o imovini,
14. Imenovanje predsedavajućeg Odbora Kancelarije regulatora energije,
15. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o reviziji godišnjih finansijskih pregleda Autobuske stanice u Prištini za 2017. godinu,
16. Razmatranje Izveštaja Komisije za budžet i finansije u vezi nadgledanja primene Zakona o bankama, mikro-finansijskim institucijama i nebankarskim finansijskim institucijama,
17. Razmatranje Izveštaja Komisije za ljudska prava, polnu ravnopravnost, nestala lica i peticije u vezi nadgledanja primene Zakona o zaštiti od diskriminacije,
18. Razmatranje Godišnjeg finansijskog izveštaja Nezavisne Komisije za medije za 2017. godinu,
19. Razmatranje preporuka Komisije za nadgledanje javnih finansija u vezi Godišnjeg izveštaja revizije za 2017.godinu.
20. Formiranje Parlamentarne anketne komisije o stanju u PTK i Vala,
21. Zahtev PG SDS-a o određivanju prededavajućeg u Komisiji za nadgledanje Kosovske agencije za intelegenciju, i
22. Zahtev PG SDS-a o zamenu člana u Komisiji za nadgledanje javnih finansija.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë!

Të nderuar ministra,

I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 29 tetor 2018.

Procedojmë me pikat e rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Keni 30 minuta kush dëshiron të flasë. Ata që janë në emër të Grupit Parlamentar, le ta thonë vetë që janë në emër të grupit parlamentar, të mos i pyes unë dy herë.

Janë paraqitur për të diskutuar zonja Blerta Deliu.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit i nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Xhavit Haliti!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ky Kuvend tash e sa kohë është në përpjekje që të gjejë konsensusin e munguar për dialog dhe kjo temë, ndonëse është njëra prej temave më të rëndësishme në vend, ka përfshirë agjendën kryesore të Republikës së Kosovës, duke na bërë jo rrallë që të kalojmë në heshtje edhe çështje të tjera të rëndësishme për vendin. Para një viti në këtë foltore me kërkesë të komunitetit artistik kanë ngritur shqetësimin e pagave të ulëta dhe jodinjitoze të aktorëve dhe punëtorëve të tjerë të trashëgimisë kulturore të cilët paguheshin më së paku në rajon.

Ndonëse amendamenti im që do t'u siguronte pagë në rritje aktorëve nuk kishte kaluar në Komisionin për Buxhet dhe Financa, ministri i Kulturës Kujtim Gashi asokohe ishte zotuar se do ta rregullojë këtë çështje.

Ministri i Kulturës dëshmoi vendosmërinë dhe përkushtimin e tij për t'i dalë zot fjalës së dhënë. Performuesit e kulturës si dhe punonjësit profesionalë të trashëgimisë kulturore dje kanë nënshkruar kontratat e reja me rritje 50 për qind të pagave. Kjo rritje e pagave do të thotë më shumë dinjitet për punëtorët e Teatrit Kombëtar dhe jo vetëm. Krahas kësaj qytetarët dhe dashamirët e artit dhe të kulturës tashmë presin që të punohet më shumë dhe me më shumë kreativitet dhe mundësi më të mëdha që skena e pavarur kulturore në Kosovë të zhvillohet edhe më tej.

Po ashtu, si deputete e këtij Kuvendi, por edhe në emër të komunitetit artistik, unë dua të përgëzoj vendimin e fundit të ministrit të Kulturës, zotit Shala, për themelimin e Teatrit në Komunën e Kaçanikut. Ka qenë një kërkesë e përhershme e qytetarëve e veçanërisht e

artdashësve atje që të themelohet ky teatër dhe besoj shumë që ministri me këtë vendim ka përmbushur njërin prej obligimeve që ne i kemi për të punuar për kulturës dhe artin në përgjithësi.

Vetëm me qasje dinjitoze dhe të përgjegjshme karshi investimeve në art dhe në kulturë, ne do të arrijmë që të investojmë në art në të ardhmen e gjeneratave të Republikës së Kosovës.

Si deputete e këtij Kuvendi dua të përgëzoj edhe një herë ministrin Shala për gatishmërinë që t'i dalë zot fjalës së dhënë. Faleminderit, ministër!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka zonja Teuta Haxhiu.

TEUTA HAXHIU: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

Sot është hera e dytë, por do ta trajtoj një temë më në detaje për mësimdhënësit në Kosovë të cilët po maltretohen me thirrjet për trajnime duke paguar nga 250 euro.

Unë kam mbledhur të gjitha të dhënat që në Republikën e Kosovës kemi numër të shkollave, çerdhe gjithsej 42, shkolla fillore të mesme të ulëta 948, shkolla të mesme të larta 122 dhe shkolla speciale gjithsej 6. Tani nga të dhënat që kam marrë nga Ministria e Arsimit që janë të trajnuar vetëm në programin udhëheqje arsimore ku po bëhet gjithë plaçka nga disa trajnues. Në mesin e tyre është deputetja Arbërie Nagavci e cila e ka edhe një organizatë OJQ e që udhëhiqet nga Krenare Lleshi e që unë gjatë hulumtimit pash që ajo është pikërisht motra e zonjës Nagavci. Pra shqetësimin e të gjithë mësimdhënësve që mua më shkruajnë vazhdimisht pse paguajnë 250 euro për ta marrë një trajnim. Përderisa në vitin 2016 janë certifikuar 386 drejtorë dhe mësimdhënës për këtë program. Në vitin 2017 janë certifikuar 124 pjesëmarrës, mësimdhënës apo drejtorë të shkollave fillore apo të mesme të larta, nga MASHT, nga GIZ apo nga OJQ. Në vitin 2018, 210. Në total, nga të dhënat nga Ministria që unë kam marrë, janë edhe 80 mësimdhënës nga komunitetet. Del pra që të jenë 891 të akredituar, të certifikuar pra në programin udhëheqje arsimore. Gjithë kjo që bëhet, në total shkolla kemi bashkë me çerdhe me të gjitha institucionet 1118 gjithsej. Nëse të gjithë drejtorët që aktualisht udhëheqin këto institucione, po t'i heqim që të gjithë, del që këta kandidatë, këta mësimdhënës apo drejtorë që janë certifikuar në këtë program udhëheqje arsimore, po t'i ndërrojmë të gjithë, atëherë do të mbulohen me këta që janë të trajnuar.

Me një fjalë gjatë konkurseve për drejtorë të shkollave, pra ky program, ky trajnim është obligativ për t'u bërë drejtor. Por, shqetësimi im edhe një herë është ngase Ministria e Arsimit vite me radhë, po e përmend vetëm në vitin 2018 ka ndarë për trajnime për mësimdhënës 382.291 euro. Në vitin 2019.

(ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: A në emër të grupit a? E keni edhe dy minuta fjalën.

TEUTA HAXHIU: Unë kërkoj falje, por në emër të grupit e kisha.

Në vitin 2019 janë 605.209 euro. Në vitin 2020, të planifikuara kanë qenë 989.065 euro. Pra rreth një milion për vjet, përderisa ministria pra ndan buxhet për trajnime e në anën tjetër bëhen ftesa publike.

Qe unë e kam materialin këtu që edhe zonja Nagavci u çon pra ftesa kandidatëve, mësimdhënësve, publikisht i fton të paraqiten sa më parë për shkak të numrit të kufizuar për këto trajnime. Pra, organizata që udhëhiqet nga zonja Krenare Lleshi që është pikërisht motra e zonjës Nagavci. Thirrjet publike të zonjës Nagavci dhe këtu i kemi kontratat kur zonja në fjalë që udhëheq një organizatë pra i tregon detajet që mund t'i paguajnë edhe me këste ato 250 euro.

Pra unë shoh një plaçkë. Unë kam edhe një proceverbal ku ministri i Arsimit në takimin e fundit me Komisionin na tha që nuk guxojmë të bëjmë ftesa publike për trajnime, ngase do t'i trajnojmë përmes Fakultetit të Edukimit apo stafit të MASHT-it.

Unë i kam faktet që zonja Nagavci para tri dite pra u dërgon ftesë publike qoftë përmes rrjeteve sociale apo në forma të tjera, duke iu thënë që të vijnë sa më parë për shkak se numri është i kufizuar. Pra, me një fjalë mësimdhënësit po plaçkiten dhe po detyrohen të kryejnë numër të trajnimeve pa ditur mirë se për çka po i bëjnë ato trajnime. Pra unë thërras që t'i lënë të lirë mësimdhënësit që të punojnë në punën e tyre për çka janë të thirrur, brenda 40 minutave pra ta japin maksimumin, por mos t'i maltretojnë edhe me trajnime të cilat pra edhe një herë po them po bëhen me pagesë të tyre individuale. Ky është një shqetësim i cili duhet të merret shumë seriozisht nga Ministria e Arsimit. Unë kam parë edhe zyrtarë të Ministrisë së Arsimit që janë të involvuar duke nënshkruar.

KRYESUESI: Faleminderit! Enver Hoti e ka fjalën, Dardan Sejdiu, më fal. Në rregull, zoti Hoti pastaj Dardan Sejdiu.

ENVER HOTI: Faleminderit kryesues!

Besoj se me Dardanin jemi të mirëkuptuar.

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë dola të ngre edhe një herë një shqetësim për gjendjen në sektorin e bujqësisë meqë jemi në një fazë kur duhet të fillojnë të mbjellat vjeshtore. Unë edhe një herë po e deklaroj këtu në takime që kemi pasur me shumë fermerë dhe bujq anekënd vendit, gjendja nuk po përmirësohet dhe mendoj që politikat aktuale, detyrimet të cilat shpeshherë është zotuar Ministria e Bujqësisë dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, po hasin vetëm në masa administrative të cilat po përsëriten vit pas viti, ndërsa gjendja e rëndë e fermerëve po vazhdon.

Unë do të potencoj këtu se bujqit janë në një situatë të vështirë edhe për shkak të çmimeve të derivateve, edhe për shkak të çmimeve për farërat, edhe për shkak të masave të sigurisë për prodhim e veçmas në aspektin e përpunimit.

Po bëj thirrje që për vitin 2019, Qeveria të marrë masa shtesë, masa adekuate dhe të dëgjohet më shumë zëri i të gjithë fermerëve në të gjithë sektorin, edhe në sektorin e perimkulturës, edhe në sektorin e fermerëve të cilët merren me kultivimin e kafshëve dhe produkteve të qumështit dhe në të gjitha sferat.

Po dua të ndaj dhe po bëj apel ndoshta edhe për nivelin lokal vlen se, masat të cilat i mbështesin qeveritë komunale po tregohen që janë masa të dështuara dhe është një para e cila po derdhet në sektorin e bujqësisë dhe nuk po luan rolin dhe efektin për të cilin duhet dhënë, qoftë në aspektin e punësimeve, qoftë në aspektin e ndërtimit të një bujqësie të qëndrueshme dhe për pasojë po shkon numri duke rënë dhe po rritet numri i djerrinave vazhdimisht dhe nuk po kemi një konkurrueshmëri jo vetëm për të garantuar tregun e brendshëm, po nuk po mundën të përballojnë duke marrë parasysh edhe një import i cili është i subvencionuar apo i monopolizuar nga akterë të ndryshëm dhe po shihet që industria e bujqësisë është e sulmuar dhe e atakuar nga importet të cilat tregtarët janë duke i sjellë ndoshta me kritere krejtësisht jashtë masës.

Unë po bëj thirrje edhe një herë që të ngrihet niveli i Qeverisë, të ngrihet niveli i masave administrative të cilat do të ndikonin drejtpërdrejt që qëndrueshmërinë dhe forcimin e këtij sektori sepse ky është sektor i cili jo vetëm që neve po na kushton me cilësinë dhe me atë çka po ushqehemi, por edhe do të ngrinte masën e punësimit dhe do të ishte në një gjendje krejtësisht ndryshe, nëse tani Qeveria përgatit masa adekuate për vitin 2019.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Dardan Sejdiu e ka fjalën.

DARDAN SEJDIU: I nderuari kryesues!

Të nderuar deputetë që jeni në sallë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Unë sot dua të trajtoj çështjen e reformës pensionale duke pasur parasysh që një numër i madh i ligjeve e skemave dhe iniciativave për pensione po na pret e për to po diksutohet, mendoj se është tepër me rëndësi t'i rikthehemi sistemit pensional dhe ta tajtojmë atë me seriozitetin e duhur.

E para e punës, sa për informacionin tuaj, sot në Republikën e Kosovës sistemin pensional e kemi trishtyllësh: shtylla e parë janë pensionet që paguhen nga buxheti i Kosovës e që për neve si Parti Socialdemokrate nuk është rruga më e mirë përpara. Pra kemi nevojë që këtë sistem trishtyllësh ta riorganizojmë në mënyrë të duhur ku shtylla e parë bëhet shtyllë në të cilën

ndërtohet fondi pensional dhe invalidor i Republikës së Kosovës dhe prej këtij fondi pensional dhe invalidor të Republikës së Kosovës, i cili mbushet me kontribute të qytetarëve të Republikës së Kosovës, pra ku gjenerata paguan për gjenerata, të ndërtojmë fondin e duhur për të trajtuar pensionistët në këtë republikë.

Pra financimi i shtyllës së parë nuk duhet të jetë i bazuar kryekëput në buxhet sepse duke e pasur parasysh të nderuar qytetarë që çdo vit po shtojmë skema pensionale, çdo vit po mundohemi të trajtojmë grupe të interesit, do të përfundojmë me buxhet shtetëror i cili përfundon vetëm në financim të këtyre skemave.

Ajo çka duhet bërë është që me kod pensional të definojmë edhe benifitet minimale edhe kontributet minimale. Kjo nënkupton që komplet shtylla e parë duhet rishikuar. Pra shtylla e parë ku paguhen pensionistët ekzistues duhet të trajtohet në mënyrë të barabartë për të gjithë. Jo në bazë të interesit, jo në bazë të presioneve, jo në bazë të grupeve, por që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës mbi moshën 65-vjeçare të gëzojnë një pension të dinjitetshëm dhe këtë pension të dinjitetshëm ta organizojmë me anë të një kontributi të definuar dhe me anë të një benifiti minimal të definuar. Por ky benifit gjithashtu nuk duhet të tejkalojë një tavan të caktuar. Pra pensioni minimal në Republikën e Kosovës, duke e bërë këtë lloj të financimit çfarë po e sugjerojmë ne si Parti Socialdemokrate bëhet i mundshëm, pra një pension minimal i cili është i barabartë me pagën minimale, derisa pensioni assesi mos të jetë diçka që e kalon një pagë mesatare.

Mënyrën se si jemi duke e organizuar shtyllën e parë do të përfundojmë.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Në rregull, në emër të grupit.

DARDAN SEJDIU: Pra, në këtë mënyrë të sigurohemi se e kemi një benifit i cili për pensionistët është i mjaftueshëm për të pasur një jetë të dinjitetshme. Pse po e them këtë kështu?

Të nderuar qytetarë,

Sot në Republikën e Kosovës numri i skemave pensionale në shtyllën e parë tejkalon numrin 10, pra kemi mbi 10 skema pensionale dhe duke pasur mbi 10 skema pensionale, kostoja buxhetore për të financuar këto në vitin 2019 e tejkalon shumë prej 400 milionë eurove. Pra vetëm në skema pensionale paguhet mbi 400 milionë euro në një buxhet të propozuar prej 2.2 miliardëve.

Të nderuar qytetarë, kjo është gati 20 për qind e buxhetit të vendit dhe nëse ne futemi në financimin e gjenerata për gjenerata, ku kontributi do të ishte 3+3 për qind, 3 për qind punëmarrësi, 3 për qind punëdhënësi, shuma e gjeneruar prej forcës aktive punëtore do të ishte afër 100 milionë euro dhe kështu do të kishim një periudhë transitore në mënyrë që barrën

buxhetore ta zvogëlojmë e këto mjete t'i orientojmë në tema të cilat për ne si Parti Socialdemokrate janë tepër të rëndësishme.

Kapërcimi i madh që duhet të ndodhë në arsim, pra kështu ndërtojmë mendim ekonomik, politika ekonomike që çështjet sociale i trajton edhe me logjikë financiare ekonomike të qëndrueshme, përderisa pensionistëve, të gjithë pensionistëve pa përjashim u garanton një pension të dinjitetshëm, pra të barabartë me pagën minimale apo pension të dinjitetshëm, i cili nuk e tejkalon një përqindje të pagës mesatare.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Skemat pensionale në mënyrën si po shtyhen përpara garantojnë vetëm një gjë bankrotim buxhetor. Ajo çka propozon PSD-ja është ecje në mënyrë të duhur sociale.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Daut Haradinaj e ka fjalën.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit kryesues!

Të nderuar deputetë,

Para disa ditësh bashkë me disa kolegë kemi dashur të iniciojmë një debat parlamentar për një mikun tim Sylejman Selimin mbi të gjeturat apo supozimet të cilat i ka mbrojtja se a po i shkelen të drejtat e njeriut këtij personi. Në konsultim e sipër u konstatua se mund të konsiderohet ndërhyrje në drejtësi dhe për ta anuluar këtë supozim unë e kam një thirrje publike për Avokatin e Popullit që të shkojë dhe ta trajtojë këtë rast, sepse në fund të ditës Avokati i Popullit është i përzgjedhur pikërisht nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe të shkojë të shohë a ka apo s'ka shkelje

E dyta që e mendova ta ngre si shqetësim publik është rasti i Komisionit Qeveritar për vlerësimin e invalidëve të luftës. Më saktësisht edhe nëpër media dje e kemi parë një rast, një ushtar i plagosur pikërisht në kufirin shqiptaro-shqiptar ku e ka plumbin anë përtej dhe i refuzohet invaliditeti.

Pra thirrja ime është edhe për ministrin edhe për Qeverinë dhe komisionin të cilin e kanë përzgjedhur që t'i trajtojnë me kujdes këto kategori sepse janë shumë të ndjeshme. E kemi parë dje nëpër rrjete sociale, e kemi parë nëpër media dhe nuk kisha pasur dëshirë që ky komision të na japë lajme të tilla po t'i trajtojë me seriozitet maksimal.

Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Veselaj-Gutaj e ka fjalën.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Çështja të cilën dua ta ngre sot janë ngjarjet e fundit të cilat ngjarje jo të zakonshme ndodhën në qytetin e Prizrenit. Pikërisht në ditën kur në Kuvendin e Republikës së Kosovës debatohej dhe synohej të arrihet të një konsensus për dialog, pra pikërisht para dy ditësh ndodhi një ngjarje jo e zakonshme në qytetin e Prizrenit.

Ashtu siç u njoftuam dhe u ballafaquam me pamje jo të mira aspak të pëlqyeshme lidhur me mundësinë e punësimit nga një kompani gjermane, disi pa paragjykuar konsideroj se një zhvillim ishte aspak normal, e më pak i duhur për rrethanat në të cilat po kalojmë si shtet. Por përtej kësaj shoh edhe qëllime të caktuara në këtë ngjarje.

Ditë më parë kjo kompani gjermane e ashtuquajtur BBC-Aviation ka lëshuar një njoftim për mundësi punësimi për në Aeroportin e Hamburgut. Këtij konkursi i janë përgjigjur me interesim të lartë mijëra qytetarë ashtu edhe siç u pa, për çka është krejt normale dhe e drejtë fundamentale e secilit për interesim për punë që lidhet drejtpërdrejt me mirëqenien personale e familjare, duke marrë për bazë edhe gjendjen jo të mirë të papunësisë në vend që e kemi.

Ajo çka më intereson dhe më shqetëson dua të ngre se dua të dijë nga udhëheqësit e nivelit qendror dhe po ashtu edhe të të nivelit lokal, a janë në dijeni për një organizim të tillë. Në çfarë cilësie është organizuar një mobilizim i tillë për punë jashtë vendit, a kanë leje këta persona apo kjo kompani për këto organizime dhe nga kush e kanë marrë këtë leje? A duhet organet shtetërore të analizojnë cilësinë e organizimeve të tilla, duke pasur parasysh se këto lloj organizimesh e sfidojnë edhe aparatit shtetëror të vendit.

Gjithashtu më duket shumë paradoksale kur në të njëjtën kohë dhe në të njëjtën ditë në Prizren është mbajtur panairi i punës i organizuar në bashkëpunim mes Komunës së Prizrenit, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Agjencisë së Punësimit të Republikës dhe Zyrës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar, GIZ. Pra, dy organizime paralelisht në të njëjtën kohë për mundësinë e punësimit, njëra zyrtarisht në kuadër të institucioneve ku përfshihet edhe një organizatë shumë serioze gjermane siç është GIZ dhe tjetra që nuk dihet se nga rrjedhe origjina e saj dhe cilat janë qëllimet e saj.

E fundit, konsideroj se shteti gjerman është një ndër shtetet më aleate të shtetndërtimit tonë, me një demokraci të zhvilluar institucionale dhe që njeh mirë rrugët e bashkëpunimit institucional për të organizuar kërkesat të tilla për punësimin për plotësimin e nevojave vetjake, për ka ne nuk kemi njohur...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Milaim Zeka e ka fjalën.

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryetare!

E para protestoj ndaj teje kryesues që po ma ndal fjalën mua e disa të tjerëve nuk po ua ndal. Unë mendoj që fyerja është shumë më e rëndë kur kolegu i thotë kolegut hajn sesa i sëmurë mental, sepse pa qenë i sëmurë mental në foltore këtu edhe në vend nuk e akuzon dikë pa fakte.

Për t'ju bashkëngjitur shqetësimit të koleges time Veseli, ka fakte dhe na kanë ardhur informacione se janë pikërisht njerëzit e Lëvizjes “Vetëvendosje!” të cilët po i organizojnë këto gjëra në Prizren. Dhe ata duhet ta marrin përgjegjësinë. Janë këta njerëz të cilët duan që ta ulin në zero imazhin e Kosovës përpara ndërkombëtarëve, për mos liberalizimin e vizave, sepse këta jetojnë vetëm në skandale, kaos edhe në turbullira.

Lëvizja “Vetëvendosje!” jeton vetëm kur qytetarët i nxitë padrejtësisht për gjërat që nuk kanë fare të bëjnë me realitetin. Prandaj, mbi bazën e kësaj dola në foltore të them publikisht, se ka informacione dhe është shumë mirë që Policia e Kosovës dhe hetuesit dhe prokurorët po merren me ngjarje shumë të rënda në Prizren prapa të cilave po them ka dyshime që janë pikërisht njerëzit e “Vetëvendosjes!”.

Në fund zoti kryesues dola që ta ngriti edhe një shqetësim për të burgosurit që qëndrojnë në burgjet e Republikës së Kosovës. Kërkoj nga ministri i Drejtësisë edhe nga deputetët që të angazhohemi fuqishëm që çdo të burgosuri t'i rikthehet e drejta për paketa, e drejta për ushqim, e drejta elementare njerëzore që ekziston në çdo vend perëndimor.

Nuk guxojmë ne që të shkojmë përmes linjës së EULEX-it, pse janë gjendur dy telefona në Burgun e Dubravës, t'ia ndalojmë të gjithë të burgosurve, ndoshta ju deputetë kolegë të nderuar nuk e dini këtë fakt shqetësues, asnjë i burgosur në Kosovë nuk ka të drejtë që të pranojë paketë nga familja e vet. Nuk ka të drejtë që të pranojë ushqim nga familja e vet. Kjo është shkelje e të drejtave të njeriut. Një gjë të tillë ne duhet ta kundërshtojmë dhe t'ia kthejmë përmes drejtorisë së përgjithshme të burgjeve, ministrit tonë të Drejtësisë, të drejtën elementare që të burgosurit t'i gëzojnë të drejtat që i kanë pasur para këtij vendimi.

Dhe në fund do të kërkojë që përmes Ligjit për nivelimin e pagave që çdo gardian i burgut në Republikën e Kosovës të trajtohet në kategorinë e policëve. Nuk mund ne t'i injorojmë gardianët, të cilët e rrezikojnë jetën e tyre shumë më shumë sesa policët që t'i kenë pagat më të vogla sesa një polic i Republikës së Kosovës. Faleminderit kryesues që nuk ma ndale fjalën!

KRYESUESI: Mirë që i paske mësuar këto gjëra Milaim. Dua të të tregoj edhe diçka, ka njeri që përmes paketave i ka ndërtuar dy-tri shtëpia nga burgu. Kështu që edhe policia edhe Ministria e Drejtësisë i kanë argumentet e veta. Unë nuk e besoj që çdo burg në botë ka të drejtë në paketa e veçanërisht në Evropë.

Ka të drejtë t'i dërgojë të holla dhe e kanë kantinën që mund të blejnë çfarë të duan. Kështu që në rregull është. Jo nuk ka replika. Tani Islam Pacolli e ka fjalën.

ISLAM PACOLLI: Faleminderit nënkryetar,

Përshëndetje ministra të nderuar,

Kolegë,

Qytetarë të nderuar,

Sigurisht që më herët nuk munda që ta marr fjalën, por nuk ishte diçka që ta pengoj procesin për arsye se ne i kemi përkrahur shtesat e fëmijëve, por natyrisht që edhe herën e parë kam qenë kategorik kundër shumës që është propozuar do të thotë kërkohet që ajo shumë të rritet të harmonizohet dhe të propozohet një shumë e dinjitetshme për këtë çështje.

Desha të lidhem me një temë tjetër, u kërkoi kryeministrit dhe ministrave që ta shqyrtojnë dhe t'i zvogëlojnë të ardhurat e dyfishta të pushtetarëve. Unë e kuptoj që i takojnë ministrave po të zëvendësministrat e zyrtarët e tjerë është mirë që të dihet që janë vetura zyrtare dhe kështu që ta kemi një kontroll më të mirë që të mos jenë edhe për pushime vjetore apo diçka tjetër. Dhe natyrisht t'i jepet një mundësi e madhe e reduktimit të shpenzimeve të mëditjeve të paarsyeshme, jo veç sa për ta gjetur një ftesë që të fiton dikush atje, dhe patjetër përpos që do të shkosh ti atje duhet t'i mbulojë shpenzimet dhe mëditjet ekstra.

Sigurisht që këto mëditje që mbulohen janë taksa të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Këtu duhet të fillojmë nga reduktimet dhe tutje. Sigurisht që ne kemi njerëz jashtëzakonisht të mirë që udhëheqin këtë Qeveri, por ne sigurisht që na jepet mundësia për reduktimin apo për korrigjimin e mundshëm që të mos kemi shpenzime të panevojshme.

Prandaj, ne siç e tha edhe një koleg më herët në një shtet social, po të shndërrohemi në një shtet funksional të cilin ne mund ta bëjmë të tillë, për arsye se kemi një gjeneratë jashtëzakonisht të mirë e cila mund të punojë mirë dhe i kemi të gjitha trajnimet më të avancuara domethënë i ka ky vend dhe ky popull. Prandaj është mirë që secili që ta japim një kritikë nuk është çështje personale po është çështje e cila ne mund të korrigjohemi çdo ditë e më shumë siç edhe është duke ecur ky shtet me hapa jashtëzakonisht të fuqishëm që është duke ecur përpara. Mirëpo brenda nesh ndonjëherë ka nevojë edhe për ndonjë kritikë është çështje normale. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! E fundit është zonja Time Kadrijaj.

TIME KADRIJAJ: Faleminderit nënkryetar i Kuvendit!

E kemi mirëpritur Ligjin e Pagave që ka ardhur në Kuvendin e Kosovës, sepse ky ligj i trajton shumë kategori edhe në njëfarë forme po i trajton në mënyrë të dinjitetshme sepse të gjithë punëtorët që kanë punuar në sektorin publik vërtetë nuk kanë pasur paga aq të dinjitetshme.

Meqenëse ligji është në Kuvendin e Kosovës dhe po trajtohet në komisionin e caktuar parlamentar duke e hartuar këtë ligj nuk është mirë ose duhet të fokusohemi që t'i ikim ndonjë ndëshkimi që mund të kalojë pa dashje, në mënyrë që ligji të jetë më mirë.

Unë dua ta ngiti një shqetësim të Inspektoratit Shëndetësor sepse Inspektorati Shëndetësor po trajtohet si shërbyes civil. Kur hapet konkursi në Ministrinë e Shëndetësisë për pranimin e inspektorëve kërkohen mjekë të profileve të ndryshme dhe është shumë padrejtë që më pas ata të trajtohen si shërbyes civil.

Gjatë harmonizimit të këtij ligji dhe amendementimit të Ligjit të Pagave, kërkoj nga komisioni i caktuar parlamentar që ta ketë parasysh, sepse nuk mundet një mjek i cili punon në Ministrinë e Shëndetësisë të trajtohet si shërbyes civil me koeficient 2 dhe është i vetmi institucion që mbikëqyrë të gjithë shëndetësinë. Dhe çfarë logjike ka institucioni që mbikëqyr shëndetësinë ta ketë koeficientin 2 ndërsa ata që ai i mbikëqyr ta kenë koeficientin 5 ose 6 që është një absurditet i kohës.

Ne i dimë të gjithë problemet që i kemi në shëndetësi dhe po mundohemi që ta bëjmë më të mirën që të gjitha ato probleme të shuhen. Por, nëse i klasifikojmë ose i poentojmë me këtë kategori inspektorët shëndetësor nuk mund të presim që do të kemi shëndetësi të mirë dhe të mirëfilltë dhe nuk do të respektohet aq sa duhet as ligji, as normat etike dhe as profesionale. Andaj, kërkoj edhe njëherë, bëj apel që inspektorët shëndetësor ta kenë koeficientin ashtu siç e kanë përgatitjen profesionale, por edhe ta kenë një koeficient të dinjitetshëm në mënyrë që ta kryejnë punën ashtu siç duhet. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë kjo pikë e rendit të ditës është shteruar nga folësit. Kemi kaluar disa minuta më shumë.

2. Koha për pyetje parlamentare

Unë po u jap mundësinë deputetëve që kanë pyetje për ministrat që janë të pranishëm, që t'i bëjnë sepse i kemi 12 pyetje parlamentare për këtë seancë dhe meqenëse nuk janë të gjithë po fillojmë me pyetjet për ministrat që janë këtu pastaj në qoftë se ju dëshironi t'i lexoni pyetjet që i keni kërkuar përgjigjet nga ministrat mund të vazhdojmë derisa të përfundojë si pikë e rendit të ditës.

Pyetja e shtatë është e zonjës Aida Dërguti për ministrin Ekrem Mustafa. Zonja Dërguti e keni fjalën. Nëse doni ta lexoni në rregull. Atëherë zonja Evgjeni Thaçi për ministrin Endrit Shala.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit i nderuar nënkryetar!

I nderuar ministër,

Konsumimi i pijeve energjike nga fëmijët në Kosovë ka marrë përmasa shqetësuese. Moskufizimi i moshës me normal ligjore për blerjen e këtyre pijeve dhe shitja e tyre në ambientet afër shkollave është një çështje e ngritur si nga prindërit, mësimmshënësist, mjekët, shoqëria civile etj.

Ndërkohë që dëmet shëndetësore për fëmijët që i konsumojnë këto pije energjike llogariten të jenë të mëdha. Ato përmbajnë tri deri në pesë herë kafeinë sesa pijet e gazuara dhe përdorimi i tyre në dozë të tepruar shkakton çrregullime në zemër, hipertension, pagjumësi, stres dhe nervozë të lartë.

Pyetja për ministrin është: Çfarë po bënë ministria që ai drejton lidhur me këtë problem?

KRYESUSI: Zoti ministër Shala, e keni fjalën.

MINISTRI ENDRIT SHALA: I nderuar kryesues,

deputetë,

Ministra,

E nderuara deputete zonja Thaçi-Dragusha, faleminderit shumë për pyetjen tuaj!

Sa i përket çështjes së ngritur nga ana juaj, respektivisht konsumimit të pijeve energjike nga ana e fëmijëve, edhe unë pajtohem me juve se kjo është një çështje jashtëzakonisht shumë shqetësuese dhe kërkon vëmendje të shtuar nga të gjithë ne, dhe po ashtu kërkon trajtimin e duhur nga organet kompetente.

E nderuar deputete,

Momentalisht nuk ka bazë ligjore që e rregullon këtë çështje. Ne si Ministri e Tregtisë dhe Industrisë kemi filluar me hartimin e projektligjit për tregti të brendshme dhe jemi në konsultim me Ministrinë e Bujqësisë, me Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë, me Ministrinë e Shëndetësisë që si organe kompetente për produktet ushqimore të diskutojmë së bashku me ta për mënyrën e rregullimit dhe ndalimit të konsumimit dhe shitjes së pijeve energjike te të miturit nën moshën 18 vjet. Dhe këtë ta bëjmë apo ta rregullojmë në harmoni me praktikën e Bashkimit Evropian. Faleminderit!

KYESUESI: Pyetje shtesë, zonja Thaçi?

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Po, i nderuar nënkryetar!

Në fakt nuk kam pyetje shtesë. Thjesht dua ta falënderoj ministrin për përgjigjen dhe gatishmërinë e tij që të ecet përpara lidhur me këtë çështje, dhe sa për informacion dua të theksoj se edhe në Shqipëri kjo çështje po diskutohet në tanimë në komisionet e Kuvendit të Shqipërisë, ndërsa në Britani të Madhe gjatë verës së këtij viti nuk jam e sigurt në korrik apo gusht veç është ndaluar me ligj shitja e pijeve energjike dhe atyre me nivel shumë të lartë të sheqerit për fëmijët dhe të rinjtë nën moshën 18 vjeç.

Mendoj që është një çështje mjaft shqetësuese dhe shumë e rëndësishme duke e marrë parasysh ndikimin që mund të ketë ky lloj i pijeve në shëndetin e fëmijëve dhe të rinjve tanë. Prandaj...

KYESUESI: Zoti Shala. Në rregull! Zonja Evgjeni Thaçi-Dragusha prapë pyetje për ministrin Fatmir Matoshi.

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Në radhë të parë mua më vjen mirë që pikërisht ministrave që u kam bërë pyetje parlamentare gjenden në sallë të Kuvendit. Këtë herë kemi të bëjmë me një pyetje tjetër, pra që i përket Ministrisë së Ambientit.

Në kuadër të Ligjit për Buxhetin e Kosovës të vitit 2018 është paraparë projekti për kyçje në ujësjellës të 12 fshatrave të Skenderajt, i cili projekt do duhet të implementohet nga ministria që zoti Matoshi drejton.

I nderuar ministër, të lutem na tregoni se çfarë hapash keni ndërmarrë lidhur me zbatimin e këtij projekti?

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI FATMIR MATOSHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Të nderuar deputetë,

Ministra,

E nderuar deputete Thaçi-Dragusha,

Lidhur me pyetjen tuaj dëshiroj t'ju njoftoj se Ministria e Mjedisit dhe e Planifikimit Hapësinor tashmë ka nënshkruar kontratën me operatorin ekonomik me datën 7 shtator të vitit 2018 dhe në bazë të kontratës me numër identifikues 210, 18, 59, 83, 5,2,1 dhe planit për menaxhim të kontratës për projektin kyçjet individuale në ujësjellës për 12 fshatra të Skenderajt.

Projekti është në fazën e zhvillimit edhe pritet që të përfundojë gjatë vitit 2018. Unë ju falënderoj për kontributin tuaj personal për këtë projekt dhe pres që bashkë me ju ditëve të ardhshme të jemi në përfundim të këtij projekti të rëndësishëm për banorët e Skenderajt.

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Thaçi-Dragusha?

EVGJENI THAÇI-DRAGUSHA: Faleminderit!

I nderuar ministre ky është një lajm mjaft i mirë edhe për mua personalisht si iniciuese e këtij projekti dhe sidomos për qytetarët e atyre fshatrave të Skenderajt. Mendoj që edhe pse ju jeni ministër i ri, po keni qenë zëvendësministër në atë ministri, ka qenë pak e vonshme edhe lidhja e kontratës, por shpresoj shumë që të përmbillet projekti dhe të implementohet brenda këtij viti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë po i lexoj ata që kanë bërë pyetje dhe ata që mungojnë këtu. Kështu që ata që mungojnë deputetëve u shlyhet pyetja edhe ministrave. Deputeti Haxhi Avdyli, pyetje për ministrin Kujtim Gashi. As njëri nuk janë këtu. Deputetja Valentina Bunjaku-Rexhepi, pyetje për ministrin Shyqyri Bytyqi, asnjëri nuk janë këtu. Deputeti Naser Rugova, pyetje për kryeministrin Haradinaj, asnjëri nuk janë këtu. Deputeti Naser Rugova, pyetje për ministrin Bytyqi, asnjëri nuk janë në sallë. Deputetja, nënkryetarja e Kuvendit Aida Dërguti është këtu, ndërsa ministri nuk është. E kemi lënë për seancën e radhës.

Gjithashtu edhe në këtë pyetjen e tetë të zonjës Aida Dërguti për ministrin Shyqyri Bytyqi e kemi lënë për seancën e radhës. Deputetja Shqipe Pantina pyetje për ministrin Pal Lekaj. Pali nuk është këtu, besoj që nuk dëshiron që ta lexojë. E lëmë për seancën e radhës. Deputeti Driton Çausi pyetje për ministrin Shyqyri Bytyqi është e njëjta gjë. Në qoftë se nuk do Dritoni që ta lexojë pyetjen.

Atëherë e dini sipas rregullave që kemi, pyetjet e deputetëve që nuk marrin përgjigje në dy seanca plenare do të publikohen në revistën e Kuvendit dhe në faqen zyrtare elektronike të Kuvendit.

Me kaq unë i mbyll punimet dhe Administrata do t'ju thërrasë kur do ta mbajmë vazhdimin e seancës. Mirupafshim!

* * *

E mërkurë, 7 nëntor 2018

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 2 nëntor 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikat e papërfunduara nga seancat plenare të mbajtura më 13 shtator, 18, 31 tetor dhe 2 nëntor 2018.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për pikat e papërfunduara të rendit të ditës 1, 2, 3, 4, 5, 11, 26, 27, 28, 29, 30, 32 dhe 33 kanë përfunduar, po nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Ne po procedojmë në bazë të marrëveshjes me votimet.

- Votim i propozim-rezolutës nga debati parlamentar sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj Bujupi, mbështetur edhe nga shtatë deputetë nënshkrues nga Grupi Parlamentar i AAK-së në lidhje me shtesat e fëmijëve

Ftoj deputeten Donika Kadaj Bujupi që ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-rezolutën e harmonizuar me grupet parlamentare sipas dakordimit në seancën plenare, të mbajtur më 2 nëntor 2018.

Zonja deputete, a ka mundësi, paska një nga deputetët diçka sigurisht për rendin e ditës. Urdhëro, zoti Zyba!

SALIH ZYBA: Përshëndetje të pranishëm,

Fillimisht do të duhej të bëhej e qartë ndryshimi i pikave të rendit të ditës, ose shifat e grupeve ose ju me specifik të veçantë, cila është marrëveshja, cila është ndryshimi, se u fut në ndryshim, pa e arsyetuar vetë ndryshimin ose shkuat në pikën tjetër, jo me renditje.

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, unë mendova se keni qenë të gjithë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, edhe i Vetëvendosjes, në Kryesi. Sido që të jetë, për publikun do ta bëj të qartë.

Propozim-rezoluta nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e presidentit të Republikës së Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territoreve apo korrigjimit të kufijve në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë ka mbetur të harmonizohet bashkërisht. Ky ishte një qëndrim i përbashkët,

të harmonizohemi bashkërisht që mos të krijojmë debat përçarës mes veti, ky ishte qëndrimi i të gjitha grupeve parlamentare.

Në të njëjtën kohë, harmonizim i votimi në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-88 për trashëgiminë kulturore.

Të tjerat janë të gjitha, do të shkojmë në votim.

Zonja deputete, fjala për ju!

DONIKA KADAJ BUJUPI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Më lejoni që fillimisht t'ju falënderoj të gjithëve për përkrahjen dhe vullnetin që ta harmonizojmë së bashku këtë rezolutë për shtesat e fëmijëve në Republikën e Kosovës.

Më lejoni që para jush të paraqes edhe një herë tekstin e harmonizuar të rezolutës.

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës i kërkon Qeverisë së Republikës së Kosovës të hartojë dhe të zbatojë sa më parë legjislacionin për ndarje të shtesave për fëmijë në Republikën e Kosovës.

2. Ndarja e shtesave për fëmijë të fillojë gjatë vitit 2019.

3. Shuma mujore e shtesave për fëmijë duhet të kategorizohet, duke marrë parasysh kriteret përkatëse, duke përfshirë të hyrat familjare, punësimin e prindërve dhe moshën e fëmijëve.

Edhe një herë, i ftoj deputetët veç e veç, meqë në grupet parlamentare jemi harmonizuar që t'i japim përkrahje kësaj rezolute. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Zonja deputete, a të shkojmë në votim. Zoti Zemaj, paska kërkuar diçka dhe po shkojmë në votim. Urdhëro!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar!

Kolegë deputetë,

Po ashtu edhe kolegja që e prezantoi rezolutën.

Ju e dini që zakonisht kërkohet harmonizimi i qëndrimeve, pavarësisht që parimisht jemi për, edhe pse nuk kem qenë pjesë e debatit në seancën kur është diskutuar rezoluta.

E kisha lutur propozuesen që bashkërisht edhe me deputetët që janë më kompetentë në këtë fushë, sidomos tash që ndërliken edhe me pjesën buxhetore që t'i harmonizojnë këto qëndrime, është mirë që është kërkuar kategorizim. Është diçka që është debatuar edhe si pjesë e punës

sonë dhe kërkesave që në këto të hyra familjare të ketë kategorizim, mbi të gjitha t'u jepet mundësi prindërve dhe moshës së fëmijëve të tyre në çështjen e ndihmës financiare.

Andaj, kërkojmë mirëkuptimin e grupeve politike që kjo rezolutë të harmonizohet, të merren qëndrimet nga të gjithë përfaqësuesit, mbi të gjitha edhe komisionet që janë funksionale, që ndërlidhen direkt me implementimin, qoftë të Komisionit për Buxhet, qoftë të Komisionit për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe kjo të saktësohet që në implementim të mos kemi problem qysh nga viti 2019.

Parimisht jemi për, të mirëkuptohemi, por kërkojmë një harmonizim, një saktësim që në procedurë të mos kemi ndonjë problematik eventualisht që mund të paraqitet.

KRYETARI: Faleminderit!

Ne jemi në draft-rezolutë, sido që të jetë, kjo është vetëm draft-rezolutë, pastaj e shqyrton Qeveria dhe mund të futen aty të gjitha shqetësimet e grupeve parlamentare. Në qoftë se jemi në parim për, t'i japim rrugë, kjo është vetëm rezolutë, ideja është të shkohet në atë drejtim.

Po e vë në votim, regjia dhe deputetët të përgatiten për votim, 81 deputetë janë. Votojmë tash!

Zonja Vlora Brovina, cila është vota juaj? Administrata e vërteton në s'ka punuar te Flora Brovina, në qoftë është votë e vlefshme e Flora Brovinës, atëherë janë 61 deputetë që kanë votuar 57 për në mënyrë elektronike, një me dorë 58, një kundër dhe 2 abstenime. Unë konstatoj përkohësisht, pasi që ta vërtetojë administrata, në qoftë se çdo gjë është në rregull, atëherë miratohet rezoluta e harmonizuar nga grupet parlamentar në lidhje me shtesat e fëmijëve, edhe një me dorë. Atëherë administrata janë dy vota me dorë. 62 deputetë sipas kësaj, tre me dorë. Janë tre me dorë, i vërtetoni. 63 deputetë, katër me dorë u bënë. Atëherë, katër me dorë janë dhe miratohet kjo rezolutë.

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 13 amendamente. Në seancën e mbajtur më 2 nëntor janë miratuar amendamenti 1 dhe 6, andaj sot vazhdojmë me votimin e amendamenteve 7 dhe 13 sipas radhitjes të paraqitur në raport nga Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media.

Amendamenti 7.

Janë dy propozime.

Propozimi i Komisionit FunkSIONAL.

Kush është kundër?
A ka abstenim? Nuk ka.
Janë 81 vota për.

Propozimi b. Është i Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit Funksional.
Lista Serbe, vëmendje.
Kush është për? Për Lista serbe, vëmendje, të mos krijohet konfuzion.
Administrata, ju lutem.
Abstenim janë të gjithë, në qoftë se nuk ka ngritje dore,
Kundër janë të gjithë. A janë të gjithë kundër?

Për arsye se në qoftë se nuk ngrihet dora, vota e mbetur është kundër, në bazë të praktikës.

Atëherë, 7 vota janë për, 81 kundër.
Kalon amendamenti 7, propozim i Komisionit Funksional.

Amendamenti 8.
Komisioni Funksional, a ka kush kundër? Nuk ka.
Abstenim nuk ka?
Kalon me 81 vota.

Amendamenti 9.
Janë dy propozime
Të Komisionit Funksional.
Kush është kundër? Nuk ka kundër.
Abstenim?
Të gjithë janë për, do të thotë.

Propozimi i Listës serbe.
Lista serbe, koncentrohuni, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.
Kush është për Lista serbe?

Atëherë, shumica janë kundër.
Kalon amendamenti 9, propozimi a, i Komisionit Funksional.

Amendamenti 10.
A ka kundër? Komisioni Funksional.
Abstenim?
Të gjithë janë për. Kalon.

Amendamenti 11.

Propozimi i Komisionit Funksional.

A ka kundër?

Abstenim. Kalon.

Propozimi i Listës serbe, pa përkrahje të Komisionit Funksional.

Lista serbe, vëmendje.

Kush është për?

Abstenim?

Janë kundër.

Do të thotë kalon propozimi i Komisionit Funksional.

Amendamenti 12.

Kush është kundër?

Abstenim?

Kalon amendamenti 12.

Për aq sa amendamenti 11, propozimi a, me 72 deputetë.

Amendamenti 13.

Kush është kundër?

Abstenim?

Për?

Kalon amendamenti 13, me deputetët të cilët janë.

Kuvendi tani do ta votojë projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

A janë 61 deputetë?

Jemi te votimi i tekstit të projektligjit në tërësi.

62 deputetë të pranishëm. Votojmë tash!

Me amendamentet e miratuara.

Nuk ka kuorum të mjaftueshëm, do të mbetet për votim në momentin kur janë 61 deputetë në sallë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Komisioni Funksional për Administratë Publike e ka rekomanduar për miratim këtë projektligj.

Zoti Igor Simiq, në cilësinë e propozuesit, a dëshiron ta paraqitësh dhe ta arsyetosh projektligjin?

IGOR SIMIĆ: Hvala vam uvaženi kolege,

Kao što dobro znate od kada je usvojen Zakon o službenim praznicima predviđeno je da dva praznika predlaže Srpska zajednica, do sada to nije učinjeno i u skladu sa ovlašćenjima koje dato odboru za prava i interese zajednica i povratak odbor je pokrenuo proceduru izmene i dopune Zakona sa predlozima dva praznika sa Srpsku i jednu praznika za Egipćansku zajednicu.

Ja ću vam sada pročitati obrazloženju ovih predloga.

Prvi predlog Srpske zajednice jeste da se 28. jun, Vidovdan, računa kao praznik koje se obeležava u Srpskoj zajednici.

Vidovdan je za Srbe najveći praznik koji ima istorijski verski karakter. Tog dana se 1389. godine odigrala Kosovska bitka, na koje se sukobile otomanska imperije i srpske kneževina.

Ovaj praznik slavi svi Srbi gde kod se nalazu u svetu već stotinama godina, i kako je istorijski dokazani od strane nekih Albanskih naučnika utvrđeno je da su u ovoj bici protiv otomanski imperije na Srpskoj strane učestvovali i Albanci.

S toga može se reći da bi podrškom ovom datumu bilo podržano jedinstvo svih naroda na Kosovu.

Drugi datum koji je predložen od strane Srpske zajednice je 15. februar, Sretenje u Srpskom narodu, drugi po redu najznačajniji praznik.

Na taj dan 1804. godine podignuti ustanak protiv otomanskih imperije koji je na kraju dovodi oslobođenje ne samo srpsku naroda od Turske okupacije, već i svih naroda na Balkanu.

Ovaj datum se tradicionalno proslavlja u Srpskom narodu gde god se nalazi.

Tiče se isključivo borbe za oslobođenje srpsku i ostalih naroda i nema nikakvih negativnih konotacija za bilu koju drugi narod, jer je neupitne istorijska činjenica.

Što se tiče dana Egipćanske zajednice, kolega Veton Beriša je predložio 24. jun dan Egipćana, jer i Egipćanska zajednica poznata kao zajednica koja tradicionalno živi na ovoj prostorijama, ima svoj identitet i etničko poreklo.

Odluka zašto je odabran ovaj dan jeste za to što je na sastanku koji je održan u Peći 22. 12. 2012. godine kojim se prisustvovali i regionalni predstavnici i Egipćanske zajednice jedno glasno odlučeno da 24. jun bude memorijalni dan Egipćanske zajednice.

Ovaj datum s uzima kao datum prvog sastanka na kome uspostavljeno prvo egipćansku udruženje u gradu Ohrid u Makedoniji 24. juna 1990. godine.

Stoga ovaj navedeni dan se obeležava na osnovu volje svih političkih mehanizama i inicijative civilnog društva na Balkanskom nivou.

Takođe u okviru izmene i dopune Zakona predložene izmena datuma koje do sada predstavio pravoslavni Božić, greškom u trenutnu važećim Zakonu stoji da je pravoslavni Božić 6. januara, do sada to niko nije primetio, niko nije želeo da to ispravlja. Mi smo dali predlog da stoji izmeni bude onako kakav jeste 7. januara.

Poštovani kolege,

Bez potrebe da bilo šta politizujemo ovo je jedan crkveni verski praznik i smatramo da treba da bude podržan od svih.

Nemojte da mislite do ima bilo kakvu negativnu konotaciju jer sam Zakon je definisao da se ovih datumi izbira od strane manjinskih predstavnika. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Kryetari i Komisionit Funksional, zoti Nait Hasani,
Jemi në pikën e tetë, të keni parasysh, të rendit të ditës.

NAIT HASANI: Faleminderit!

Komisioni për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media ka mbajtur mbledhjen më 17. 10. 2018, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës dhe kërkuar që ky projektligj të miratohet në parim. Po në komision ka pasur edhe debate, të cilat janë reflektuar për shkak të kërkesës për festat.

Festa zyrtare që e kanë kërkuar Lista serbe për komunitetin serb në Kosovë, 6 shkurtin, është një ditë që duhet t'i takojë, ndërsa për 28 qershorin nuk ka pasur një dakordim në komision, për shkak se është një përbërje e kësaj feste jo e drejtë e shtruar, është një kërkesë që ngjall ndjenjat nacionaliste.

Prandaj, me këtë kërkesë nuk është pajtuar komisioni, me këtë kërkesë ose këtë pikë që kjo festë, 28 qershori, të jetë festë zyrtare e serbëve në Kosovë është në kundërshtim me ndjenjat dhe rregullimin shtetëror të Kosovës, prandaj ajo është një çështje që duhet t'u takojë akademikëve

në shqyrtim të tërësishëm kësaj çështjeje, për shkak se 28 qershori është një luftë ballkanike e vitit 1389 që është bërë në koalicion, ku kanë marrë pjesë të gjitha kombet në atë kohë. Aty kanë marrë pjesë shqiptarët, serbët, bullgarët, polakët, hungarezët, rumunët dhe në atë betejë të gjithë kanë marrë pjesë, kështu që është një koalicion i përbashkët, gjithë koalicioni ballkanik ka humbur, do të thotë është vrarë Princ Lazari, po ashtu edhe Sulltan Murati 2 dhe një betejë e humbur, e sot të kërkohet të festohet një betejë e humbur është një çështje ndoshta e një mentalitetit të kaluar të mesjetës, por megjithatë, ne duhet ta shqyrtojmë.

Komisioni i ka shqyrtuar dhe kërkon që kjo pikë 28 qershori t'i mbetet historisë edhe akademikët ta shqyrtojnë, ata na japin propozimet, tani ne kemi mundësi të bëjmë miratim. Ndërsa, te kërkesa e egjiptianëve si festë zyrtare dita e tyre është miratuar në parim, bashkë me 6 shkurtin si festë zyrtare po ashtu e komunitetit serb në Kosovë.

Prandaj, kërkojmë që në parim ta procedojmë, me vërejtjet e komisionit që 28 qershori nuk është pajtuar të kalojë dhe besoj që duhet t'i mbetet pjesës së historisë, akademikëve, shkencës që ata ta shpjegojnë këtë çështje dhe jo të merremi ne festa zyrtare që do të ngjallin ndjenja nacionaliste në Kosovë, që do të na ripërtërijë edhe një herë kujtesën e luftës në Kosovë, edhe bisedat, edhe takimet e Milosheviqit në Gazimestan, kjo është një ndjenjë që ngjall urrejtje, prandaj po kërkojmë që kjo të largohet dhe të procedojmë me festën zyrtare të serbëve, të cilët e kanë 6 shkurtin të vitit 1835, që e kanë harruar tamam datën për shkak se është 6 shkurti i 1805, beteja e parë ose lufta, kryengritja e parë e serbëve që është bërë në atë kohë dhe betejën e Gazimestanit ta lëmë anash. Ndërsa për egjiptianët po ashtu të njëjtat kërkojmë të miratohet në parim dhe ta ketë secili të drejtën e festës së tyre zyrtare.

KRYETARI: Faleminderit! Igor Simiq ka kërkuar fjalën, sigurisht për replikë apo për shtesë diçka, s'e kuptova, por reagim pati.

IGOR SIMIČ: Vrlo kratko, ne znam sad da li je stvar prevoda, ali mislim da Hasani je rekao, neki 6. februar, mi taj datum nismo tražili, ko rođeni Srbin ne znam koji je dan 6. februara, uopšte znači srpskoj istoriji, tako da se mi sa tim ne slažemo. Zakon je vrlo jasan i kaže da predlozi za memorijalne dane svih etničkih zajednica na Kosovu dolazi od predstavnika tih zajednica, i mi ne možemo da menjamo nešto što se desilo pre 600 i više godina, to je bio taj dan, i ono što mogu da kažem ja bih voleo da podržite jer nema nikakvu političku konotaciju, niti imamo nameru da bilo koga vredi od bilo koje etničke zajednice na Kosovu, mi imali mi taj datum u ovom zakonu ili ne, dve stvari će ostati zapisane, jedno da Srbi i dalje slaviti taj datum, a drugi, je to istorijska činjenica koju ne može da promeni da li postoji kao deo zakona ili ne. Hvala vam!

KRYETARI: Zoti Igor, do të ishte mirë këta në shqyrtimin e dytë të shikojnë, ne të shkojmë në leximin e parë, e në lexim të dytë të bisedoni në komision parlamentar, për arsye se tash duke e

diskutuar në Kuvend, vetëm mund të zgjatet, por në të dytin lexim pastaj mundësisht të arrihet një kompromis dhe të tejkalohet diçka çka është ndjenjë, respekt, do të mundohemi të gjithë bashkërisht t'i festojmë, të gjitha datat janë tonat, krejt bashkë.

Naiti prapë ka reagim, pastaj Veton bëhesh gati.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Ne nuk jemi kundër festave zyrtare të askujt, të asnjë kombi, asnjë pakice që jeton në Kosovë. Edhe ne jemi për festën zyrtare që ta ketë komuniteti serb në Kosovë, 6 shkurtin që ata e kanë prezantuar, por nuk jemi për që festë zyrtare të jetë 28 qershori, si festë e serbëve, se ajo është një betejë ballkanike. Prandaj, nuk u takon serbëve ta kenë ata festë zyrtare. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Berisha e ka fjalën!

VETON BERISHA: Faleminderit, i nderuar kryetar, nënkryetar!

Kolegë deputetë,

Të gjithë ju të pranishëm,

Pikërisht e mora fjalën për të kërkuar mbështetjen e të gjithë juve në përkrahjen në parim të projektligjit dhe për shkak se unë kam qenë propozues fillestar për amendamentimin e këtij projektligji, me ç'rast kam nisur procedurën për të amendamentuar dhe të shtuar ditën 24 Qershorin, ditën nacionale të komunitetit egjiptian, si ditë e cila ka munguar që nga ekzistimi i këtij ligji dhe çuditërisht ka munguar kjo datë.

Ne nuk dëshirojmë të shënojmë këtë ditë edhe të interpretohet që po shënojmë ditë në formë ilegale. Kërkojmë mbështetje, është një ditë e cila vërtet na takon. Pse po kërkojmë mbështetje dhe po kërkoj sqarim dhe zgjidhje të kësaj çështje, sepse për të tretën herë vjen dita nacionale e komunitetit egjiptian dhe zakonisht nuk kalon jo për shkaqe të ditës nacionale të komunitetit egjiptian, por për shkaqe të cilat janë të lidhura me ditë dhe datë të tjerë. Normalisht që e përkrah secilën ditë të secilit, por vërtet duhet të kemi mirëkuptim dhe të harmonizojmë dhe në këtë rast të përkrah në parim, sepse ka tre vjet që ky propozim imi nuk kalon për arsye dhe shkaqe të të tjerëve dhe pikërisht kërkoj që të mbështetet dita nacionale e komunitetit egjiptian. Faleminderit, kryetar!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, nuk ka deputetë të paraqitur, as përfaqësues të grupeve parlamentare. Për këtë projektligj procedurat dihen si janë, duhen të paktën 61 vota për dhe këtu duhet të paktën të jenë 11 votat e komuniteteve. Në momentin kur e kemi shumicën 61, shumë

shpejt do të bëhemi 61, për arsye se 6+ është duke ardhur dhe gjashtë deputetë, pastaj shkojmë edhe në votimin, se kemi edhe pika të tjera të rendit të ditës.

Nuk po e vë tash në votim fare, për të paktën se s'janë 61 deputetë aktualisht.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për referendum

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj Faton Topallin, në cilësinë e propozuesit, ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

FATON TOPALLI: Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Të nderuara deputete,

Të nderuar deputetë,

Sot kam kënaqësinë e veçantë që para jush të paraqes, respektivisht para Kuvendit të Kosovës Projektligjin për referendum.

Ashtu siç e dini të gjithë, referendumi paraqet nivelin më të lartë të demokracisë në një shoqëri përparimtare. Ligji për referendum është një instrument, i cili bën të mundshëm implementimin e vullnetit të qytetarëve të vetëdijshëm, e aktivë, qytetarëve, të cilët me nënshkrimin dhe votën e tyre insistojnë, angazhohen për ta bërë vullnetin e tyre realitet. Referendumi është gjithashtu një instrument i mirë jo vetëm për demokracitë e zhvilluara, por edhe për demokracitë më pak të zhvilluara, siç është jona, për shoqëritë me politikanët dhe grupe politike të korruptuara, për parti politike me tendenca autoritare, për grupe interesash që posa kapin pushtetin, i harrojnë të gjitha premtimet që i kanë bërë, për grupet që ndjekin vetëm interesa të ngushta grupore dhe në këtë mënyrë menjëherë pas zgjedhjeve eliminojnë për katër vjet me radhë qytetarët e Kosovës duke i përjashtuar nga vendimmarrja politike.

Referendumi sigurisht që është një instrument kundër kapjes së shtetit, referendumi është gjithashtu një instrument kundër monopoleve politike, ekonomike. Është një instrument kundër shkeljes së të drejtave të njeriut, i cili fuqizon qytetarin. Ligji për referendum është gjithashtu një përgjigje kundër demagogëve, cilët do qofshin ata, demokratë, social-demokratë, nacionalistë, shovinistë e kështu me radhë që të mos manipulojnë me tema të caktuara dhe të mos flasin në emër të popullit pa e pyetur asnjëherë popullin. Me Ligjin për referendum kushdo që do të dijë se çfarë mendojnë qytetarët, se çfarë mendon populli, kanë mundësinë ta pyesin atë, ta marrin mendimin e tij dhe tek atëherë të flasim për tema të caktuara në emër të tij. Pra, referendumi është përgjigjja dhe instrumenti kryesor kundër demagogëve. Referendumi është instrument i shkëlqyer edhe për partitë opozitare, të cilat mund të kenë ide të shkëlqyera, por në mungesë të numrave, si pakicë, nuk mund të implementojnë idetë e tyre. Pra, referendumi, thënë shkurt, është A-ja e demokracisë.

Tani më lejoni që me pak fjalë të shpjegoj Projektligjin për referendum. Në pjesën e parë të shpjegimit tim u përpoqa të them disa nga arsyet pse referendumi është i rëndësishëm. Së pari, më lejoni të shpjegoj që e drejta e referendumit është e drejtë e paraparë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 65, pika 3, ne kemi Ligjin për referendum në nivelin lokal, por nuk kemi Ligj për referendum në nivelin nacional. Projektligji për referendum, të cilin Partia Socialdemokrate ia paraqiti Kuvendit sot, është përpiluar nga një grup ekspertësh të pavarur, të cilët kanë dashur të mbeten anonimë, por thjesht t'u bëjnë një shërbim atyre grupimeve politike që konsiderojnë si vlerë të drejtën e referendumit. Ligji për referendum ka qenë i përpiluar në gjuhën angleze dhe është përkthyer në gjuhën shqipe.

Projektligji për referendum ka gjithsej 22 nene, ky projektligj parasheh tri mundësi të referendumeve: referendumi shfuqizues, i cili mundëson shfuqizimin e një ligji ose një pjese të një ligji; referendumi konsultativ, i cili mund të iniciohet nga Kuvendi ose presidenti, në këtë rast iniciuesit e një referendumi të tillë kërkojnë mendimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës për një çështje të caktuar. Referendumi konsultativ nuk është obligues për Kuvendin.

Pastaj, kemi edhe referendumin kushtetues, i cili mundëson që Kuvendi i Kosovës me 2/3 e votave të organizojë një referendum për ndryshime kushtetuese, duke përfshirë këtu edhe 2/3 e minoriteteve dhe vendeve të rezervuara. Qytetarët e Kosovës, 12 iniciues do të mbledhin 100 mijë nënshkrime të votuesve të regjistruar në listën zgjedhore për të organizuar një referendum. Unë nuk po ndalem në detajet e ligjit, sepse ligjin e keni para jush. Për fund, dua të shtroj edhe tri çështje: projektligji që kemi shtruar para jush është në formën që është përpiluar, pra pa ndryshime. Jemi përcaktuar të mos bëjmë ndonjë ndryshim, për shkak që ligji në formën që është përpiluar mbështetet deri në fund në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ndryshimet kualitative mund të bëhen vetëm nëse do të kemi një shumicë parlamentare.

Pra, për të gjitha temat delikate duam të vendosim bashkërisht dhe plotësimi dhe ndryshimi i ligjit vjen si kompromis i përbashkët i të gjitha grupeve parlamentare. Edhe unë, edhe PSD-ja, jemi të vetëdijshëm për problemet që dalin nga neni 81 i Kushtetutës, i cili për çështje të caktuara pretendon t'i mbyllë gojën sovranit. Kjo problematik shprehet pak më shumë tek neni 13 i Projektligjit që keni para jush, këtë çështje, pra këto dilema kemi menduar që duhet t'i zgjedhim bashkërisht me njëri-tjetrin. Në fund të fundit, edhe nëse arrijmë t'i zgjedhim problemet që dalin nga neni 81 i Kushtetutës së Kosovës, të cilat përdoren në Kushtetutën e Ahtisarit, të miratuara nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, projektligji duhet të aprovohet dhe Ligji për referendum duhet të implementohet. Kostoja e referendumit është 5.1 milionë euro, ndoshta kjo mund të duket shumë, që është një kosto shumë e lartë, por kur merret parasysh që me referendume të caktuara mund të kursehet pesëfish, dhjetëfish buxheti i Republikës së Kosovës, atëherë duhet thënë që kjo kosto nuk është fare e lartë. Në fund, më lejoni edhe një herë t'ju ftoj të gjithëve që ta votoni në parim Projektligjin për referendum dhe pastaj bashkërisht të gjitha grupet

parlamentare t'i paraqesim propozimet për ndryshimin e ligjit, sepse është një prej ligjeve bazike të demokracisë.

Jam shumë i vetëdijshëm që ka edhe vende, të cilat nuk e praktikojnë të drejtën e referendumit, për shkak që mendojnë se qytetarët nuk janë në nivelin e detyrës për të votuar për çështje të caktuara. Unë këtë e konsideroj demagogji, sepse nëse qytetarët e Kosovës votojnë një Kuvend, i cili sjell këto vendime çfarë i sjell, atëherë ata janë shumë të vetëdijshëm dhe mund të vendosin edhe për çështje të komplikuar dhe, në fund të fundit, sido që të jetë, vendimi i tyre është vendim i shumicës, pra është vendim demokratik. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Komisionit Funkcional, zoti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16.10.2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-096 për referendum dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji për referendum.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion e ka shqyrtuar, por edhe pse kemi pasur një debat që ligji të jetë më përmbajtjesor, si nga aspekti teknik, ashtu edhe përmbajtjesor, ne e kemi përkrahur dhe i rekomandojmë Kuvendit që në këtë fazë ta përkrahin ligjin e propozuar nga Partia Socialdemokrate.

Nëse më lejohet, kryetar, edhe në emër të Partisë Demokratike, e kisha vazhduar.

Atëherë, të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar Ligjin për referendum. Është për t'u vlerësuar ideja e sponsoruesit, por e thashë edhe më herët, ky ligj ka probleme në aspektin teknik dhe në aspektin përmbajtjesor. Besoj që edhe sponsorizuesi pajtohet. Kur them probleme në aspektin teknik, nga ajo pjesa e propozimit të ligjit që duhet të jetë në formë tabelore, është vetëm si një draft i propozuar, por konsideroj që edhe grupi parlamentar në mes të dy leximeve do ta japë kontributin e vet, po edhe si Komision për Legjislacion jemi zotuar që pasi të kalojë në seancë plenare, ta bëjmë një grup punues gjithëpërfshirës, nga të gjitha subjektet politike, pasi që ky ligj është me rëndësi të veçantë dhe

është i domosdoshëm për Republikën e Kosovës dhe qytetarët. Do ta japim kontributin në mes dy leximesh.

Në emër të Partisë Demokratike, i ftoj kolegët deputetë që ta përkrahin në parim.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, në emër të grupeve parlamentare. Frashër Krasniqi nga Partia Socialdemokrate.

FRASHËR KRASNIQI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,
Partia Socialdemokrate, si iniciuese e këtij projektligji, normalisht që e mbështet fuqishëm dhe u kërkon të gjithë deputetëve ta votojnë, po ashtu ne kërkojmë në mënyrën më të sinqertë dhe me respekt nga partitë opozitare që të kthehen ta votojnë së paku këtë ligj.

Kemi raste kur partitë opozitare janë kthyer për të votuar ligje të caktuara, që i kanë konsideruar se janë më të rëndësishme se ligjet e tjera, ne konsiderojmë që Ligji për referendum është më i rëndësishëm se të gjitha ato ligje për të cilat partitë opozitare janë kthyer në Kuvend për t'i votuar, pra më i rëndësishëm edhe se ligjet e tjera, po edhe se ato që ata i kanë vlerësuar më të rëndësishme.

Ligji për referendum është realizim konkret i idesë që disa prej nesh e kemi në politikë tash e trembëdhjetë vjet, pra i realizimit të së drejtës për vetëvendosje të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Është paradoksale që në këtë moment të mos jemi bashkë të gjithë deputetët, edhe të pozitës, edhe të opozitës, që ta votojmë një ligj, i cili politikën, ose vendimmarrjen në politikë, e kalon edhe te qytetarët e Republikës së Kosovës.

Kosova ka pasur shumë problem deri sot me vendimmarrje jodemokratike, duke qenë se parti të caktuara politike kanë marrë vendime përkundër vullnetit të qytetarëve dhe elektoratit të vet atyre partive, shpeshherë dhe ky ligj e ndërron këtë praktikë, duke e faktorizuar vetë qytetarin e Republikës së Kosovës. Prandaj, është ligj shumë i rëndësishëm. Ftoj edhe një herë partitë opozitare, po edhe deputetët e tjerë që po mungojnë, që të kthehen në seancë për ta votuar këtë ligj dhe të mos e lëmë peng për shkak të inateve partiake realizimin konkret të së drejtës për vetëvendosje të qytetarëve të Kosovës.

Prandaj, normalisht që ne do ta mbështesim dhe po them sërish, po i ftoj, po i lus, partitë opozitare të kthehen, sepse përndryshe, kjo do të përbënte një lloj hipokrizie politike nëse nuk kthehen për ta votuar këtë ligj. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Demalijaj e ka fjalën.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit!

Përpos problemeve teknike që i ka projektligji, edhe në komision jemi zotuar se do të punojmë bashkërisht dhe e mbështesim projektligjin. Do ta japim kontributin tonë brenda dy leximeve. Faleminderit!

KRYESUESI: Bilall Sherifi e ka fjalën.

BILALL SHERIFI: Faleminderit, zoti kryesues!

Po, edhe Nisma në komision i ka dhënë mbështetjen në parim ligjit. I kemi dhënë disa vërejtje, të cilat konsiderojmë se duhet të merren parasysh dhe besoj që në mes të dy leximeve do të arrijmë të gjejmë një pajtueshmëri mes grupeve parlamentare, që në lexim të dytë ta votojmë. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, edhe kjo pjesë mbetet për votim në momentin kur i kemi 61 deputetë. Shumë shpejt do të jemi 61 deputetë. Lus deputetët të qëndrojnë në sallë, për arsye se do të hyjmë në proces të votimit. Janë një pjesë e madhe në bufe, një pjesë janë në zyrë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private

Komisioni Funkcional për Legjislacion e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ministri nuk është prezent. Në emër të ministrit Abelard Tahiri, ministri Kujtim Gashi e ka fjalën. Është praktikë kur kanë të drejtë ministrat t'ia bartin ministrit tjetër propozimin e projektligjit për ta paraqitur para Kuvendit.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli!

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kam kënaqësinë që të paraqes për shqyrtim dhe miratim Projektligjin për të drejtën ndërkombëtare private, i cili do të zëvendësojë ligjin aktual për zgjedhjen e konflikteve të ligjeve me dispozitat e shteteve të tjera, ligj ky i cili ka mbetur trashëgimi juridike e sistemit të kaluar.

Rregullimi i marrëdhënieve private me elementë ndërkombëtarë nuk ka qenë kurrë detyrë e lehtë, e mbi të gjitha paraqet fushën në të cilën nuk është kushtuar vëmendje mjaftueshme. Sido që të jetë, shoqëritë moderne nuk mund të lejojnë mungesë interesimi në këtë segment, gjë që është evidente nga debate të shumta, sidomos në nivelin e Bashkimit Evropian. Hartimi i Projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private paraqet nevojë imediate, e kjo për hir të rregullimit të

marrëdhënieve civile, qoftë atyre familjare, trashëgimore, pronësore, sendore apo tregtare, të cilat në vete përmbajnë elementë të huaj, qoftë në subjekt, objekt apo në të drejtën dhe detyrimet.

Gjatë hartimit të këtij projektligji, Ministria e Drejtësisë është nisur nga nevoja e harmonizimit të normave ligjore me zgjidhjen e miratuar brenda Bashkimit Evropian. Në vijim ju njoftojmë me çështjet kryesore që parashihen me këtë projektligj, e që janë si në vijim:

- përcaktimi i së drejtës së aplikueshme, e cila do të aplikohet në marrëdhënie të caktuara civile me elementë ndërkombëtarë, kështu ky projektligj përcakton rregullimin se cili ligj do të aplikohet në marrëdhëniet e caktuara civile, atëherë kur ekziston elementi ndërkombëtar;

- projektligji trajton çështjet familjare dhe përcakton një bilanc ndërmjet aplikimit të së drejtës së caktuar në bazë të shtetësisë dhe të drejtës së vendbanimit të zakonshëm;

- po ashtu, projektligji në mënyrë të konsiderueshme zgjeron fushëveprimin e autonomisë së vullnetit të palëve, duke garantuar këtë të drejtë në shkallë të ndryshme edhe në rast të divorcit, pronës së përbashkët të bashkëshortëve, ushqimit dhe marrëdhënieve jokontraktore dhe është në pajtim me konceptin e së drejtës ndërkombëtare private evropiane dhe Konventës së Hagës;

- projektligji rregullon po ashtu pikat e lidhjes në bazë të të cilave vendoset aplikimi i të drejtës së caktuar për kontrata të veçanta, siç është ajo e transportit të mallrave, transportit të udhëtarëve, kontrata e konsumatorëve, kontrata individuale për punësim dhe është në pajtim me Rregulloren e Bashkimit Evropian për marrëdhënie kontraktuale.

Të nderuar deputetë,

Bazuar në rëndësinë dhe nevojën për avancimin e legjislacionit në fushën e marrëdhënieve private me elementë të huaj, ju ftoj që ta miratoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Hajdar Beqa, në emër të Komisionit FunkSIONAL.

HAJDAR BEQA: Kryetar!

Po flas se opozita apo kryetarja e komisionit dhe partia e saj janë më shumë me korrespondencë në Parlament, se sa të rregullt. Kështu sot e kanë pushim. Faleminderit!

Komisioni për Legjislacion, duke u bazuar në nenin 56, paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 23.10.2018 e shqyrtoi Projektligjin nr. 6/L-101 për të drejtat ndërkombëtare private dhe vendosi që Kuvendit t'i paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligjit nr. 6/L-101 për të drejtat ndërkombëtare private.

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion para shqyrtimit të parë të projektligjit në mbledhjen plenare, duke vepruar në pajtim me nenin 56, paragrafi 2 i Rregullores së Kuvendit, e shqyrtoi në parim projektligjin e theksuar dhe konstatoi se projektligji i plotëson kushtet që t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim në parim.

Për këtë arsye, i rekomandoj Kuvendit shqyrtimin dhe miratimin e projektligjit në pajtim me Rregulloren e Kuvendit.

Nëse më lejohet, kryetar, edhe në emër të Partisë Demokratike do të flisja.

Grupi parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar projektligjin. Sa i përket Projektligjit për të drejtat ndërkombëtare private ju njoftoj se Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar këtë projektligj, të cilin e vlerësojmë si të nevojshëm, madje të domosdoshëm, nga se rregullimi i marrëdhënieve private me elementë të huaja konsiderohet çështje me shumë rëndësi, andaj duhet përgëzuar Ministrinë e Drejtësisë, respektivisht ministrin e Drejtësisë për këtë çështje që i është qasur në mënyrë meritore. Për më tepër, vlerësojmë se Projektligji për të drejtën ndërkombëtare private meriton të përkrahet për të paktën dy arsye themelore.

Arsyeja e parë është rregullimi i kësaj çështjeje, konsiderojmë se korrespondon me nevojat e shoqërisë kosovare dhe njëkohësisht mundëson përqafimin e vlerave evropian brenda legjislacionit vendor, që është edhe interes i përgjithshëm i institucioneve tona.

Aspekti i dytë është se si të tilla, rregullat e inkorporuara qartësojnë aplikimin e të së drejtës meritore, por edhe të juridiksionit në të gjitha fushat civile, andaj Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e përkrah në parim këtë projektligj dhe do të angazhohet që kontributin e vet ta japë në mes dy leximesh. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shkumbin Demaliaj, në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

SHKUMBIN DEMALIAJ: Faleminderit, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet në parim Projektligjin për të drejtën ndërkombëtare private dhe kontributin do ta japim mes dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, s'ka të paraqitur për diskutim, në momentin kur të bëhen 61 deputetë, ka mbaruar debati, do ta vëmë në votim.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

Komisioni Funkcional për Bujqësi e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Në emër të Ministrisë së Mjedisit ftoj ministrin e Kulturës që ta paraqesë projektligjin.

MINISTRI KUJTIM GASHI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Të nderuar deputetë,

Duke pasur parasysh rëndësinë e këtij ligji dhe natyrisht harmonizimin e këtij ligji edhe me ligjet e Bashkimit Evropian, i cili ka për qëllim mbrojtjen e ajrit nga ndotja, duke pasur gjithmonë parasysh ndotjen e madhe që ka ndodhur edhe vitin e kaluar, por edhe viteve të kaluara, ju ftoj që ta votoni këtë projektligj për faktin se ka një rëndësi të veçantë edhe për mbrojtjen e ajrit nga ndotja. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të Komisionit Funkcional, fjalën e ka zoti Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar projektligjin në lexim të parë dhe e ka kaluar, kështu që ky projektligj i ka plotësuar të gjitha parakushtet që të silltet në seancë plenare. Ftoj kolegët deputetë që në rastin e parë të mundshëm, kur të jenë numrat, ta votojmë. Faleminderit!

KRYETARI: Tash është radha e deputetëve. Sali Salihu, në emër të Partisë Socialdemokrate.

SALI SALIHU: Partia Socialdemokrate e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe aty është parë se projektligji tani përmban të gjitha dokumentet që duhet t'i ketë një dokument për shqyrtim në lexim të parë. Është edhe dokumenti nga ministria përkatëse për implikime buxhetore, mandej është komplet memorandumit shpjegues që tregon qartë për nevojën e ndryshimit të këtij projektligji, sepse që nga bërja e këtij ligji nuk ka pasur ndonjë ndryshim, ndërkaq shumë direktiva të BE-së në raport me ndotjen e ajrit kanë ndryshuar dhe ne konsiderojmë se është mirë që ky projektligj po plotësohet, por ndryshohet, për arsye mbase kemi një ambient mjaft të ndotur.

Pra, Partia Socialdemokrate do ta përkrahë në parim këtë projektligj dhe në mes të dy leximeve do të japim kontributin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani është radha e deputetëve. Anin Hoti. A e ke kërkuar fjalën se këtu të ka dalë emri? Urdhëro, në emër të Grupit Parlamentar.

ANDIN HOTI: Po, kryetar! Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar.

Për ndotjen e ajrit, në emër të Grupit Parlamentar.

Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Edhe Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj në Komisionin për Bujqësi, mirëpo ne e kemi shqyrtuar dhe kemi ngritur zërin edhe herë të tjera, sepse mbrojtja e ndotjes nga ajri nuk është temë e sotme, është temë që na shqetëson një kohë të gjatë. Kjo është një temë që fatkeqësisht e ngremë zërin në këtë kohë, në muajt dhjetor, janar, shkurt, kur veç ajri bëhet i papranueshëm në Kosovë e sidomos në Prishtinë, prandaj ne e kemi dhënë kontributin tonë në komision, do të vazhdojë ta japim kontributin tonë në Komisionin për Bujqësi, aty ku jam edhe unë.

Ftoj kolegët deputetë që të mos vonohemi me këtë projektligj, i ftoj që ta votojmë sa më parë, i ftoj që ta harmonizojmë, ta kryejmë sa më parë dhe të marrim masat e duhura për mbrojtjen e ajrit që po e shqetëson të gjithë qytetarët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit zoti Hoti. Në emër të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Muharrem Nitaj.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar, nuk ka ndryshim. Edhe Aleanca e ka shqyrtuar Projektligjin, por ajo që dua të them është se është një prej projektligjeve ndoshta më të rëndësishme.

Ju i dëgjuat edhe kolegët Salihu dhe Hoti. Unë dua të njoftoj Kuvendin se Komisioni ynë do të krijojë një grup punues dhe do ta harmonizojë tekstin e këtij Projektligji dhe do të provojmë që ta bëjmë më të mirën të mundshme dhe do të përfillim edhe kërkesat e kolegëve të tjerë deputetë nga grupet e tjera parlamentare që do të mbërrijnë në komision, në mënyrë që ta hartojmë ose ta prodhojmë një ligj që i përshtatet nevojave të Kosovës. Kjo duke pasur parasysh edhe situatën aspak të favorshme me ndotjen e ajrit në Republikën e Kosovës.

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës do t'i japë mbështetje në lexim të parë këtij Projektligji dhe vërejtjet do t'i paraqesë midis dy leximeve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë nuk ka deputetë më të paraqitur. Edhe kjo pikë e rendit të ditës pritet për momentin kur të bëhen 61.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për peticione

Komisioni FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për mosmiratim.

Zonja Albulena Haxhiu si propozuese, në cilësinë e propozueses nuk është dhe e kemi rregull që kur nuk është propozuesi, ose s'e autorizon dikë, atëherë në atë moment e tërheqim nga rendi i ditës për sot.

Po e largojmë. Kjo është. Jemi në proces të votimit. I kisha ftuar grupet parlamentare t'i thërrasin deputetët, të kemi votim, se më nuk kemi pika në shqyrtim, janë të gjitha në votim.

Ziles, ju lutem! Në qoftë se ka mundësi administrata dhe në të njëjtën kohë t'i thërrasim edhe nga bufeja, kolegë dhe kryetarë të grupeve parlamentare. Ose në qoftë se momentalisht mendoni, varet kjo nga kryetarët e grupeve parlamentare konsultim, mundemi ta bëjmë edhe pauzën pastaj të vijmë në një kohë të caktuar. Tash po e shohim. Thirrini deputetët, ju lutem!

Kryetarë të grupeve parlamentare, mundësisht janë 60 deputetë, edhe dy deputetë na duhen.

I kisha lutur deputetët të cilët janë aktualisht afër, Nait Hasani kthehet për tre minuta, sepse e pati një takim institucional, vetëm merr leje edhe kthehet.

Të nderuar kolegë deputetë, 63 deputetë janë në sallë. Ju kisha lutur vëmendje. Unë do të lëviz nëpër pika të rendit të ditës. Vetëm vëmendje, kur shkoj nga to s'do të thotë për arsye se në radhitje e kam të imponuar të lëviz në bazë të pikave të rendit të ditës, një radhitje të cilën e kam bërë unë.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetaren e Komisionit FunkSIONAL, zonjën Sala Shala, ta arsyetojë rekomandimin. E ka arsyetuar. Janë 39 amendamente, të gjitha janë me përkrahjen e komisionit funksional.

I hedh përnjëherë në votim.

A ka dikush kundër 39 amendamenteve? Abstenim?

Kalojnë 39 amendamente.

Regjia dhe deputetët përgatiten për votim në mënyrë elektronike. Votojmë tash!

62 deputetë kanë votuar, 54 për, 8 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjit nr. 06/L-079 për efikasitet të energjisë.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni Funkcional është në rregull. Janë 37 amendamente. I votojmë të gjitha bashkërisht.

Ju kisha lutur. Në emër të Komisionit Funkcional nuk kemi kërkim të fjalës, jemi në votim të 37 amendamenteve.

Më fal zonja Shqipe, kemi të bëjmë me projektligj. Në emër të Komisionit Funkcional mund të flasë. Jemi në leximin e dytë. Nuk mund ta fusë debat, veç nëse insistoni shumë.

Cilin amendament dhe pse më herët nuk e keni diskutuar? Jo ne marrim veç materialin që e kemi këtu, por urdhëro zonja deputete, pastaj e kemi edhe kryetarin e Komisionit Funkcional.

Urdhëron zonja deputete njëherë, pastaj kryetari i Komisionit Funkcional. Shqipe Pantina!

SHQIPE PANTINA: Në fakt ndoshta është radha që kryetari i Komisionit ta lexojë raportin, por janë të paktën dy nene të cilat edhe në komision kemi pasur votim. Ndonëse i ka kaluar komisioni, ka pasur edhe votë kundër. Prandaj edhe këtu, të paktën për një nen, kërkoj të mos votohet. Është fjala për amendamentin nr.12 i cili kërkon që.

KRYETARI: Zonja deputete vetëm e specifikon, sepse mund ta ndajë. Edhe kështu ashtu çdoherë mund t'i ndani edhe kur po i vendosim në votim, cilindo e ndani ju.

SHQIPE PANTINA: Ok! Atëherë unë kërkoj që amendamenti nr.12 të hidhet në votim edhe për edhe kundër, sepse edhe dua të arsyetoj pse unë mendoj se ky amendament duhet të votohet kundër.

Është fjala për t'i gjobitur organizatat joqeveritare të cilat nuk dorëzojnë me kohë raportin te zyra e regjistrimit të OJQ-ve.

Qeveria e ka propozuar një gjobë, por komisioni e ka dyfishuar shumën e kësaj gjobe. Tani ndonëse në dukje të parë, kjo duket krejt një çështje teknike, unë mendoj se nuk i sjell asnjë dobi

as zhvillimit të demokracisë e as vënies në funksion dhe në kontroll nëse mendojmë se kemi kaos brenda OJQ-ve. Por, mund të japë shenja negative.

KRYETARI: Më fal zonja deputete. A ka mundësi të ndërhyj për hir të korrektësisë. Pasi ju e keni vërejtje një amendament të caktuar, në momentin kur shkojmë në votim të atij, unë pra i vendosi të gjithë, pastaj arsyetoji ti dhe unë e vë prapë në votim. Është më mirë se tash.

SHQIPE PANTINA: Ok! Edhe ashtu bën, por unë doja ta arsyetoja tani, pasi e mora fjalën. Por në rregull, për mua s'ka problem.

KRYETARI: Është më mirë për ju, e kam për ju, se për mua do të ishte ndoshta më mirë edhe tash, por më mirë është për ju, i vetëdijeson deputetët dhe pastaj ata votojnë pas fjalës suaj.

Atëherë 1 deri 37, pa amendamentin 12.

Do t'i vë në votim të gjithë bashkërisht, janë me përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL.
A ka kundër? Abstenim?

36 amendamente votohen përnjëherë me shumicën e votave. Për, 63 deputetë.

Tani te amendamenti 12, Komisioni FunkSIONAL e ka sjellë amendamentin, por ka reagim të deputetëve.

Dëshiron pse për ta votuar kundër, zonja Shqipe Pantina. Urdhëro!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit!

Pra siç fillova ta arsyetoj, ndonëse në dukje të parë duket një çështje teknike, por gjobitja vetëm e OJQ-ve sepse ato nuk po i dorëzojnë me kohë raportet, mund të merret edhe zakonisht vlerësohet si tendencë për t'i disiplinuar dhe kontrolluar sektorin joqeveritar. Një nga arsyetimet që është përmendur në Komision, është numri i madh i OJQ-ve të regjistruara e të cilat në praktikë nuk janë funksionale.

Numri i madh i organizatave joqeveritare në secilin shtet konsiderohet si vlerë. Tani, a janë funksionale në baza të përditshme apo jo, është çështje e vetë organizatave dhe arsyes pse ato ekzistojnë. Një gjobitje e tillë në dukje të parë mund të duket që nuk ka asnjë ndikim, por siç thashë tregon një tendencë të shtetit të organeve të shtetit për t'i kontrolluar ato.

Qeveria edhe në bashkëpunim me organizatat joqeveritare që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij ligji, kanë rënë dakord që të ketë një lloj ndëshkimi, por dyfishimi i shumës, do të thotë rritja nga 150 në 250 dhe 40 në 80 mendoj vetëm se shprehë një tendencë për t'i kontrolluar ato.

Prandaj, ndonëse unë jam parti opozitare po kërkoj që të mbetet në fuqi propozimi i Qeverisë i cili në dukje do të ishte absurde se zakonisht duhet të jenë partitë e koalicionit qeverisës ato që e mbrojnë qëndrimin e Qeverisë, po në këtë rast ne jemi dakord me propozimin e Qeverisë e jo me propozimin e komisionit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Do të shkojmë në votim për arsye se edhe kështu nuk mund të ndërhyjmë. A dëshironi të flisni? Megjithëse kjo në princip ne nuk mund të amendamentojmë asgjë që e ka sjellë Komisioni Funkcional. Kjo vetëm shkon formalisht në votim. Pasi që po doni publikisht, urdhëroni. Memli Krasniqi, urdhëro!

MEMLI KRASNIQI: E mbështetim propozimin. Do ta votojmë kundër amendamentin, në mënyrë që të mbetet ashtu siç ka ardhur propozimi i Qeverisë. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetar i komisionit në fund do t'ua jap fjalën. Daut Haradinaj, në emër të AAK-së.

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryetar!

Plotësisht pajtohem me deputeten Pantina, vetëm se duhet ta kemi të qartë pse është duke u kërkuar raportimi? Sepse nuk duhet të keqinterpretohet. Ne kemi me qindra raste, organizatat joqeveritare në Kosovë të cilat financohen me financa të dyshimta. Dhe nuk bëhet fjalë për ata që kanë transparencë se ata nuk rrezikohen në raportim.

Kemi dyshime kur ka pasur edhe financim në elemente terroriste. Kemi ndikim po ashtu fetar. Nuk e dimë kush i jep ato të holla. Dhe kjo nuk duhet parë si ndërhyrje në OJQ ose në shoqëri civile, por kjo duhet parë si transparencë financiare e atyre organizatave. Unë jam dakord për vlerën dhe do a votojmë kundër, por gjithsesi mos harroni domethënë, duhet të futen brendapërbrenda ligjit dhe të disiplinohen ata zotërinjtë. Kemi me miliona që ju vijnë këtu, i hapin organizatat na i çojnë djemtë në Siri e në drejt të mallkuar atje na i humbin njerëzit. Na e dëmtojnë imazhin dhe ne nuk e kemi një raport financiar se kush i financon ato, kah ju vijnë mjetet, cili është qëllimi i tyre etj., etj.

Do ta votojmë për, por mos harroni se qëllimi i kësaj ka qenë diçka krejt tjetër. Do ta votojmë propozimin e deputetes Pantina.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Funkcional, Nait Hasani në fund shkojmë në votim. Vota për-kundër, tash po e shoh jeni ndarë. Po votoni edhe në bazë të asaj mbetet si është vendimmarrja juaj.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

E kemi vlerësuar ne vendimin e Qeverisë, nenin 29 pikën 3 OJQ, e cila nuk përmbush detyrimin. Në Kosovë kemi mbi 10 mijë organizata joqeveritare të regjistruara. Ato që i tha Dauti, qëndrojnë të gjitha. Ne kemi kërkuar për organizatat të cilat janë të papërgjegjshme t'ju rritet gjoba. Dhe nuk e kemi rritur gjobën ashtu siç po thotë, por megjithatë kemi thënë që 150 zëvendësohet me 250 dhe 40 me 80.

Kjo nuk është që të kontrollohen organizatat joqeveritare, por kjo është që të detyrohen organizatat joqeveritare që ta prezantojnë raportin edhe të hyrat financiare ka i marrin. Mbi 10 mijë organizata joqeveritare në Kosovë nuk kanë deklarime. Kemi organizata joqeveritare që kanë krijuar të hyra me miliona euro. I kemi 70 milionë euro që i kanë krijuar këto organizata në kurriz të qytetarëve që kanë marrë para me kamata deri në 38%.

Askush nuk reagon në këto forma. Reagojnë që një bankë që është organizatë joqeveritare si: FINCA, ProCredit, ose të tjera e të tjera që janë shumë e që kanë të hyra me miliona e miliona. 70 milionë i kanë para të gatshme që AMIK-u është i krijuar nga ta edhe i kanë 150 milionë kredit, edhe tash kërkojnë me 250 euro nuk po mund t'i paguajmë ne edhe po na kontrolloni neve. Ky është absurditet i kohës. Absurd i deputetëve të cilët kërkojnë të kthehen në organizata joqeveritare.

KRYETARI: Shkojmë në votim. Faleminderit! Qëndrimet janë tuajat. Amendamenti i dymbëdhjetë, Projektligji për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare. Votojmë në mënyrë elektronike. Regjia deputetët le të përgatiten. Dardan, pasi që po shkojmë në mënyrë elektronike se po shoh që mund të ketë dallim për një votë. Përgatitemi për votim, votojmë tash. Ndaleni edhe njëherë edhe votimin ju lutem. Vetëm pak! Kisha pasur dëshirë për korrektësi. Unë po mundohem që 20 minuta jemi këtë pikë edhe në fund pyetet se çka po votohet. Nuk është korrekte. Po votohet amendamenti i 12-të të cilin e ngriti Shqipe Pantina si problematikë. Po votohet përkrahja e Komisionit FunkSIONAL ose kundër Komisionit FunkSIONAL.

Shqipe Pantina foli, Daut Haradinaj foli amendamenti i 12-të. Nait Hasani foli. Votimi është i juaji. Kisha pasur dëshirë koncentrim. Atëherë prej komisionit foli Nait Hasani. Votojmë tash! Atëherë, 63 deputetë kanë votuar, 5 për, 44 kundër, 14 abstenime. Do të thotë nuk kalon. I bie kështu, nuk kalon. Nuk kaloi. Ose është kjo gjendja e cila është. Vetëm pak një konsultim. Shkojmë në votimin e ligjit në tërësi. Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Regjia dhe deputetët le të përgatiten për votim. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar. 60 për 1 kundër, 2 abstenime.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr. 06L-43 për lirinë e asociimit në organizata joqeveritare.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për automjete

Komisionet e kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka përkrahur amendamentin nr.1, propozuar nga Komisioni FunkSIONAL dhe ka rekomanduar që i njëjti të hiqet.

Komisioni për Integritim Evropian nuk e ka mbështetur projektligjin dhe amendamentet e propozuar nga Komisioni FunkSIONAL. Zonja Sala Berisha-Shala e ftoj për arsytim e raportit me rekomandime.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputetë,

Zoti ministre dhe ju të pranishëm,

Komisioni ka vlerësuar se projektligji nr.06/L-64 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-132 për Automjete në bazë të raportit të vet amendamentues të datës 2 dhjetor 2018 dhe në bazë të raporteve të komisioneve të përhershme, më 16 dhjetor 2018 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime; janë gjithsej 4 amendamente.

Ky ndryshim plotësim i këtij projektligji ka ardhur si iniciativë e deputetit, zotit Mërgim Lushtaku të cilin e falënderoj, ka qenë pjesë e grupit punues dhe i kemi gjithsej 4 amendamente. Unë kërkoj zoti kryetar që amendamentet të vihen në votim një për një. Dhe të shohim le të vendosë seanca sesi do të votojë për këto amendamente. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Janë 4 amendamente të propozuara. Amendamenti numër 1, komisioni me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro zotëri Dardan Sejdiu. Vetëm pak Dardan pasi po flet për amendamentin. Unë po shkoj një nga një po i votoj se po e shoh se ka probleme.

DARDAN SEJDIU: Për ligjin në përgjithësi po flas.

KRYETARI: Për ligjin në përgjithësi, atëherë urdhëro!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Qëndrimin e Partisë Socialdemokrate e kemi shprehur në dy seanca të Kuvendit në komision dhe jemi kundër amendamentit i cili e heq kufizimin e vjetërsisë apo si të thuash e rrit kufizimin e vjetërsisë për importin e veturave. Rrjedhimisht po ju informoj që në këtë ligj nuk marrim pjesë në votim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Nuk merrni pjesë në votim. Nuk ka kuorum nëse nuk merrni pjesë në votim. Atëherë më vjen keq, po e shtyj.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për produkte të ndërtimit

Jam duke i kryer shqyrtimet e dy projektligjeve në qoftë se e keni vërejtur, pika 15.

Komisioni Parlamentar e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve për kthim nuk e ka shqyrtuar raportin me amendamente brenda afatit të paraparë me Rregullore të Kuvendit. I kemi amendamentet 1 deri në 32. Në qoftë se nuk ka reagime unë po shkoj po i votoj të gjitha përnjëherë.

Amendamenti 1 deri 32 bashkërisht, kush është kundër? A ka abstenim? Votohen të gjitha amendamentet 1 deri në 32. 63 deputetë janë sallë. Votojmë në mënyrë elektronike tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash! Po shkojmë edhe një votim se nuk ka edhe kështu, nuk mund të konstatojmë.

Të nderuar kolegë deputetë, përgatitemi për votim projektligji në tërësi me amendamente të miratuara. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar. 55 për, 8 abstenime, asnjë kundër.

Kuvendi e miratoi Ligjin nr.06/L-033 për produkte të ndërtimit.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Debati ka përfunduar. Keni parasysh sqarim procedural; duhen të paktën 61 vota për dhe 11 vota nga komunitetet. A shkojmë të votojmë me dorë për t'i dalluar komunitetet. Për arsye se duhet të dallohen. 11 vota duhet të jenë nga komunitetet. Kemi edhe në listë të votimit. Edhe në listë të votimit pastaj e marrim saktësisht.

Po shkojmë në listë të votimit në mënyrë elektronike, pastaj konstatimin e bëj pasi Administrata të ma sjellë listën e votimit.

Përgatitemi për votim, shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës pika 8. Votojmë tash!

Kanë votuar 48 deputetë, 45 janë për, 3 abstenime. Por, është ajo që nuk e plotëson kuotën. Po, urdhëro zoti Veton!

VETON BERISHA: Kryetar!

Edhe një herë ka nevojë shumë për sqarim për këtë projektligj, për shkak se Grupi Parlamentar 6+ nuk ishte në kohën e sqarimit nga kryetari i Komisionit FunkSIONAL se për çka po votojmë. Domethënë, çështja është kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Nait Hasani e sqaroi që është propozim, përkrahen dy data: njëra datë e komunitetit serb dhe njëra datë e komunitetit egjiptian. Dhe, mbetet diskutabile njëra prej datave që ka propozuar komuniteti serb. Kështu që ne u dakorduam që ndërmjet dy leximeve të dakordohemi prapë që të jetë një datë që mund të jetë kompromis. Ndërsa 6+ nuk po e kupton që domethënë është mirë të sqarohet edhe një herë kryetari i komisionit se për çfarë po bëjmë fjalë.

Problemi është që nuk ishim të pranishëm dhe tani ndoshta ka nevojë për një sqarim shtesë edhe kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj që të mos humbet kjo mundësi, e cila gati tre vjet është në përpjekje për t'u bërë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, kryetari i Komisionit FunkSIONAL, ju lutem zoti Nait!

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Ne e kemi kalua ligjin në parim, kemi kërkuar që seanca ta miratojë në parim Projektligjin për festat zyrtare edhe pastaj do të kemi mundësinë plotësim-ndryshimin edhe amendamentimin e projektligjit.

Çështja është edhe nëse nuk duam ta kalojmë ne nuk mund ta heqim në këtë kohë asnjë datë, asnjë festë, por ne duhet të amendamentojmë më tutje datat, të cilat janë propozuar. Prandaj, festa zyrtare që është kërkuar nga komuniteti egjiptian dhe nga komuniteti serb, duhet të kalojnë që të kemi mundësitë t'i amendamentojmë dhe të plotësojmë-ndryshojmë më tutje. Prandaj, kërkoj nga deputetët ta votojnë në parim që të kemi mundësi plotësim ndryshimin e mëtejshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Ne jemi në leximin e parë, të jemi korrekt me të gjithë ju. Deri te leximi i dytë duhet të bëhen shumë debate, në mënyrë që të arrihet një pajtueshmëri e votimit, kjo është.

Votojmë edhe një herë Projektligjin në leximin e parë. Regjia dhe deputetët të përgatitemi për votim, votojmë tash! Ky është numri i deputetëve që kanë votuar, e lë do ta provoj edhe një herë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për referendum

Debati për këtë pikë parlamentare ka përfunduar. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! Ky është rezultati i votimit, do t'i kthehem edhe një herë. Po vazhdojmë me votime, s'ka pas kuorum të mjaftueshëm. 52 deputetë kanë marrë pjesë në votim.

Po, po do t'i sjelli të gjitha edhe një herë. Edhe një herë po i fus në votim, po a ka mundësi veç vëmendjen tuaj!

Përgatitemi në pikën e rendit të ditës për festat zyrtare.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash! 58 deputetë, prapë nuk është kuorumi.

Votojmë pikën e 9 të rendit të ditës. Votojmë tash! Prapë e kemi një situatë të tillë të njëjtë, 53 deputetë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për të drejtën ndërkombëtare private

Diskutimet kanë përfunduar. Jemi në votim në parim. Bëhemi bashkë. Votojmë tash!

Ky e pati fatin të kalojë. 61 deputetë kanë votuar. 53 për, 8 kundër.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-101 për të drejtën ndërkombëtare private.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga ndotja e ajrit

Diskutimet kanë përfunduar. Jemi në proces të votimit. Pika e 6-të. Votojmë tash!

63 deputetë kanë votuar. 60 për, 3 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-100 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Ngarkohen Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

- Votimi për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Procedojmë me votimin për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore në këtë përbërje:

1. Zanita Halimi,
2. Premtim Alaj,
3. Arjeta Miftari,
4. Arsim Mehmeti,
5. Muhamet Qerimi,
6. Bego Kululleri,
7. Filjko Jovanoviq.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tani!

Regjia ka problem në votim, në proces të votimit. A mund të shkojmë me dorë?

Votimi për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, regjia a mund të votojmë? Prisni vetëm pak, ju lutem. Përgatitemi për votim. Pika e 4-t, votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit, 38 deputetë. Nuk ka kuorum.

- Votimi për shkarkimin e zotit Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Votojmë rekomandimet e Komisionit Funkcional. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Po ashtu, edhe ky votim është...

I kthejmë edhe një herë të gjitha. Edhe një herë, vetëm të shkojmë me rend.

- Shqyrtimi i propozim-vendimit për caktimin e kompensimit për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për caktimin e kompensimit për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona dhe Kuvendit i

ka paraqitur propozim-vendimin në emër të Komisionit. Nuk është për Buxhet dhe Financa. Grupet parlamentare apo shkojmë drejt... ah, zonja Safete Hadërgjonaj, po urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ligji nr. 05/L-010 për Agjencinë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës përcakton se Kuvendi emëron një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarë të Komisionit për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, të cilat më datë 30. 3. 2018 janë emëruar nga Kuvendi.

Lidhur me pagesën e tyre ligji i lartpërmendur ka rregulluar se të njëjtit aktivizohen në punë sipas nevojës dhe paguhen për sesionet e mbajtura. Mbi këtë bazë meqë Ligji për paga ende nuk është miratuar, Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës i ka dërguar një shkresë Kuvendit, ku kërkohet që të caktohet pagesa për një anëtar të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe për dy anëtarë të tjerë të Komisionit për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, të cilët i ka emëruar Kuvendi.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në cilësinë e Komisionit FunkSIONAL është ngarkuar të shqyrtojë kërkesën e Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës dhe komisioni e ka caktuar një grup punues, i cili ka analizuar kërkesën, ka bërë krahasimet me nivelin e kompensimeve të agjencive të tjera të pavarura dhe duke pasur parasysh nivelin e punës dhe përgjegjësinë me qëllim të aktivizimit të tyre në punë dhe deri në miratim të Ligjit për paga, Komisioni i ka propozuar Kuvendit që me vendim të caktojë nivelin e kompensimeve për anëtarin e Komisionit për kërkesa pronësore dhe dy (2) anëtarëve të Komisionit për krahasim dhe verifikim të pronës si në vijim: anëtarët e Komisionit për kërkesa pronësore të emëruara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës t'i caktohet kompensimi prej 700 euro bruto në muaj për një sesion të mbajtur, dy anëtarëve të Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona, të emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës u caktohet kompensimi në shumën prej 700 euro bruto në muaj për secilin anëtar për një sesion të mbajtur. Kompensimet për anëtarin e Komisionit për kërkesa pronësore dhe dy anëtarët e Komisionit për verifikim dhe vendosje për prona, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij rekomandimi paguhen në shumën më së shumti për pjesëmarrje në dhjetë sesione brenda një viti.

Niveli i kompensimit për anëtarin e Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe dy anëtarët e Komisionit për Verifikim dhe Vendosije për Prona sipas pikës 1 dhe 3 të këtij rekomandimi bëhet nga buxheti i Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës, dhe zbatohet deri në miratimin e Ligjit përkatës për paga.

Ftojme deputetët të bëjnë miratimin e këtij propozimi të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E kemi një rekomandim. A shkojmë drejt në votim se nuk ka të lajmëruar? Përgatitemi për votim.

Regjia, deputetët, përgatiten për votim. Komisioni e dha fjalën e vet për të votuar në bazë të propozimit të Komisionit. Votojmë tash!

Me 62 vota, 54 për, 8 kundër, Kuvendi e miratoi vendimin për caktimin e kompensimit për një anëtar të Komisionit për kërkesa pronësore dhe dy anëtarëve të Komisionit për verifikim dhe vendosje për prona.

Kështu. Do t'ju pyes: a shkojmë në votim të fshehtë? Edhe një herë po futemi në votim këto, pastaj jemi në votimin e fshehtë.

OK! Shkojmë edhe një herë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

Është e treta herë që e vendosim në votim. Votoni tash!

63 deputetë kanë votuar, 55 për, 3 kundër, 5 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr. 06/L-083 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës. Kjo me një kusht. Administrata e shikon kushtin 11 vetë, a kanë votuar komunitetet.

Ngarkohen Komisioni Funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojmë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime. Momenti që është plotësuar ai kusht, ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit për referendum

Votojmë tash!

Shkojmë edhe një herë në votim 56 deputetë. A shkojmë edhe një herë në votim?

Vetëm kisha pasur dëshirë të mos maltretohemi. Në qoftë se është vendim për të mos e votuar, të paktën mos të shkojmë me maltretim. Ka të bëjë me referendum. Të gjitha çështjet janë të thjeshta, nuk ka asgjë të komplikuar në këtë, as politike. Votojmë tash!

Ky është fati i këtij projektligji, 55 deputetë, nuk po mund të bëhen 61.

Votimi për emërimin e 7 anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi kulturore. I përmenda emrat më herët, janë 7 anëtarë. Votojmë tash! Po ashtu numri i deputetëve është shumë i vogël në votim. Shkojmë edhe në pikën:

- Shkarkimi i zotit Shqipërim Bula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronik dhe Postare

Regjia, deputetë të votojmë rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Edhe kjo nuk ka arritur që të marrë numrin e nevojshëm të votave. A dëshironi të nderuar kolegë deputetë, a dëshironi të futemi në votim? Vetëm pak, i kemi edhe disa raporte. A janë 61 deputetë? Shqyrtimi i raporteve. A ka mundësi që ta kem vëmendjen tuaj? A jeni të gjithë bashkë? Atëherë referendumin edhe një herë.

Përgatitemi për pikën e 9-të të votimit. Kërkesë e deputetëve e keni parasysh në seancë. Votojmë tash! Pika e 9-të.

61 deputetë kanë votuar, 49 për 6 kundër, 6 abstenime.

Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin nr.06/L-096 për referendum.

Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportet me rekomandime. Dhe, jo nuk keni fare përqendrim. A dëshironi pauzë? A dëshironi që ta shtyjme? Atëherë në orën 15:00, po e shoh të gjitha grupet parlamentare kështu ma thanë. E vazhdojmë seancën parlamentare sot në orën 15:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar kolegë deputetë,

Sot kemi pasur një zhvillim të pritshëm të seancës. Kemi kaluar disa nga projektligjet. Në të njëjtën kohë i kemi trajtuar disa projektligje. Kanë mbetur edhe disa vendime të cilat janë po ashtu shumë me rëndësi si: Emërimi i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit, shqyrtimi i disa raporteve financiare, rekomandimet e komisioneve, në të njëjtën kohë disa kërkesa të grupeve parlamentare. Për aq sa i kemi edhe disa votime, janë 6 projektligje të cilat që një kohë të gjatë, siç është ai për noterinë e shumë projektligje të tjera, të cilat është mirë që bashkërisht të mendojmë që t'i kalojmë.

Ne sot me aq sa po e shoh, nuk janë 62 deputetë në sallë. Kjo nuk na pengon që t'i trajtojmë disa gjëra. Por, në qoftë se grupet parlamentare dëshirojnë që ta thërrasim seancën një ditë tjetër, kjo mund të jetë gjatë kësaj jave. Atëherë, ne sot mund ta përfundojmë në këtë moment, por seanca nuk përfundon. Ka mundësi që e thërras seancën edhe gjatë kësaj diku kah dita e premte, por do t'ju lajmërojmë edhe një herë më saktësisht.

Atëherë po shkojmë për sot, po e përfundojmë me kaq pastaj vazhdimin e seancës e bëjmë një ditë, ka mundësi edhe gjatë kësaj jave. Do t'ju njoftojmë paraprakisht. Faleminderit shumë për kontributin dhe angazhimin!

* * *

E premte, 23 nëntor 2018

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 2 nëntor 2018

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

I hap punimet për vazhdimin e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës me pikat e papërfunduara të seancave plenare, të mbajtura më 13 shtator, 18, 31 tetor, 2 dhe 7 nëntor 2018.

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për pikat e rendit të ditës nga 1 deri 9 dhe nga pika 11 deri 15 kanë përfunduar në seancat e mëparshme, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Andaj sot do të procedojmë me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

- Votimi në parim i Projektligjit për transmetuesin publik të Kosovës

Votojmë projektligjin në tërësi.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim! Votojmë tash!

Kjo është vendimmarrja, nuk ka kuorum. Unë do të vazhdoj, pastaj kthehem, kthehemi prapë, por të vazhdojmë.

- Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-88 për trashëgiminë kulturore

Edhe kjo pikë e rendit të ditës do të evitohet sot nga dhënia në votim, për faktin se duhen të jenë 11 deputetët e komuniteteve. Aktualisht nuk di a janë 5 a 6, ta keni parasysh, kjo është arsyeja pse po e evitojmë.

- Votimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare në Republikën e Kosovës

E njëjta është edhe për festat zyrtare.

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-036 për statistikat zyrtare të Republikës së Kosovës

Në seancën parlamentare të mbajtur 2 dhe 7 nëntor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Vendimmarrja është e pamjaftueshme si kuorum, do të thotë nuk e ka plotësuar kushtin e vendimmarrjes.

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 05/L-132 për automjete

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 4 amendamente, procedojmë me votimin e amendamenteve:

Dy amendamente janë me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, 3 dhe 4 i vendosim ndaras në votim.

Votojmë një herë amendamentet 1 dhe 2.

77 deputetë janë në sallë.

A ka dikush kundër? Nuk ka kundër.

A ka abstenim? Nuk ka. Të gjithë janë për. Një kundër.

77 deputetë janë në sallë, 76 janë...

Vetëm pak, ta sqarojmë këtë situatë, nuk është hera e parë.

Amendamentin 1 dhe 2, a dëshironi t'i votoni me elektronik a me dorë?

Urdhëro, zoti Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: I nderuar kryesues,

Meqë këto amendamente kanë kaluar nëpër Komisionin për Zhvillim Ekonomik, po e shoh edhe kryetaren e komisionit këtu, unë kisha propozuar që amendamentet të lexohen një për një dhe të votohet në mënyrë elektronike për to.

KRYETARI: Secili i ka amendamentet para vetes.

Amendamenti 1.

Në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL, votojmë tash, në mënyrë elektronike.

Kjo është vendimmarrja.

Amendamenti 2.

Votojmë menjëherë, në mënyrë elektronike, votojmë tash, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Faleminderit!

Kjo është po ashtu vendimmarrja.

Amendamenti 3.

Propozimi i deputetit Lutfi Zharku, me përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Kjo është situata e votimit.

Amendamenti 4.

Dy propozime:

a) një herë vetëm të Komisionit FunkSIONAL, pastaj edhe b.

Një herë e votojmë vetëm a. Votoni për amendamentin 4, varianti a, në përkrahje të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash! Faleminderit!

Kjo është vendimmarrja, nuk ka kuorum.

Votojmë variantin b, propozimi i Lutfi Zharkut, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Kjo është gjendja.

E votojmë tekstin e projektligjit pa amendamentet e miratuara, votojmë tash, në tërësi projektligjin. S'u miratua, s'kemi çka i bëjmë, shkojmë veç projektligjin, votoni tash, kush dëshironi.

Faleminderit! S'ka kuorum.

Po vazhdojmë tutje.

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/ L-010 për noterinë

Më seancën plenare të mbajtur më 13 shtator 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Andaj, sot ne e votojmë tekstin e projektligjin në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Deputetët, të cilët nuk kanë arritur të votojnë me dorë, kush dëshiron, le të tregojë. Votojmë tash! Faleminderit!

Kuvendi e miratoi Ligjin numër 06/ L-010 për noterinë, me 66 vota të votuara.

Edhe një herë, a ka mundësi ta konstatoj, se ma larguat.

66 deputetë kanë votuar, 65 për, një, abstenim ose kundër, po ka kaluar, është miratua, ta kemi parasysh, të mos ngutet regjia shumë. Faleminderit!

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit numër 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit numër 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

Në seancën plenare të mbajtur më 14 shtator 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit.

Do të thotë, një abstenim ishte te votimi i Projektligjit numër 06/L-010 për noterinë, vetëm për konstatim. 65 ishin për.

Do të thotë, aktualisht Projektligji për Hekurudhat, në mungesë të kuorunit, nuk mund ta konstatoj votimin e mirëqenë.

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit numër 06/L-038 për shërbimet postare

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Po e shihni edhe vetë, nuk kua kuorum të mjaftueshëm për të konstatuar votimin.

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara për këtë projektligj.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Votojmë tash!

Edhe ky projektligj nuk ka kuorumin e mjaftueshëm.

- Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 02/L-31 për lirinë fetare në Kosovë

Largohet për shkak të mungesës së 11 votave të komuniteteve, 2/3, në fakt.

- Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017

Komisioni ka rekomanduar miratimin formal të raportit, e votojmë raportin në tërësi, tash!

Ky është votimi, nuk ka kuorum.

- Votimi për emërimin e 7 (shtatë) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Procedojmë me votimin për emërimin e shtatë anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore. Përbërjen e keni, a ka nevojë të lexohen? Jo. I keni krejt emrat.

Regjia dhe deputetët, votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit, nuk ka kuorum.

- Votimi për shkarkimin e zotit Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

Procedojmë me votimin e rekomandimit të Komisionit FunkSIONAL. Votojmë tash!

Do të thotë, numri i deputetëve nuk lë hapësirë për ta konstatuar si të mirëqenë votimin, se nuk pati kuorum.

- Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar për dialogun me Serbinë, propozuar nga GP i PSD-së

Zoti Dardan Sejdiu e ka fjalën, është e bartur nga seanca plenare 15 tetor 2018. Urdhëro, në emër të PSD-së.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesues!

Ne si grup parlamentar ende shpresojmë që mund të dakordohemi rreth një teksti të rezolutës, e cila mund të na përbashkojë në trajtimin e temës së dialogut me Serbinë. Rrjedhimisht si Grup Parlamentare po shpresojmë që mund të flasim edhe një herë me shefat e grupeve edhe dakordohemi me tekstin e rezolutës, në këtë frymë kërkoj të tërhiqet nga rendi i ditës.

KRYETARI: Faleminderit! Propozuesi i Partia Socialdemokrate ka kërkuar të tërhiqet për nevojë të konsensusit të përbashkët, e tërheqim nga rendi i ditës.

- Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territoreve apo korigjimit të kufijve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Procedojmë me votimin e propozim-rezolutës. Votojmë tash!

Ky është votimi, nuk ka kuorum të mjaftueshëm.

Për hir të opinionit publik, kam shumë mësues, edhe një herë krejt i kthejmë. Edhe një herë do t'u kthehemi të gjithave, çka janë votuar, transparente ishte, të gjitha edhe nga një herë, pastaj sa të dëshironi vendosim.

Në qoftë se ka mundësi pak për vëmendje.

Unë po shkoj edhe një herë rend, votimin e këtyre që nuk patën kuorum. Në qoftë se keni reagime, reagoni, e kthej sa herë të doni.

Ka një zotim nga deputetja...

Shkojmë me:

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-036 për statistikën zyrtare të Republikës së Kosovës

S'qenka politik diçka, në seancat plenare të mbajtura më 2 dhe 7 nëntor 2018 janë miratuar të gjitha amendamentet e propozuara në këtë projektligj. Tani votohet projektligji në tërësi. Votojmë tash!

Kjo është gjendja e votimit, nuk ka kuorum, po vazhdojmë me pikën e radhës:

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit nr. 06/L-067 për plotësimin edhe ndryshimin e Ligjit nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës

Janë miratuar amendamentet e propozuara më 14 shtator. Votojmë në tërësi projektligjin. Votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit, nuk ka kuorum!

- Votimi në lexim të dytë i Projektligjit për miniera dhe minerale

Minierat janë shumë me rëndësi për Kosovën, në seancën plenare të mbajtur më 15 tetor 2018 janë miratuar amendamentet e propozuara në këtë projektligj. I votojmë në tërësi. Votojmë tash!

Ky është rezultati i votimit, nuk kam çfarë të konstatoj, pasi nuk ka kuorum.

- Votimi i raportit vjetor të Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memorialë të Kosovës për vitin 2017

Komisioni Funkcional ka rekomanduar miratimin e këtij raporti. Votojmë tash!

Po ashtu, edhe kjo pikë e rendit të ditës nuk ka kuorum.

- Votimi për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

I kemi shtatë emrat secili. Votojmë tash!

41 deputetë kanë votuar, nuk ka kuorum të mjaftueshëm as kjo pikë e rendit të ditës.

- Votimi për shkarkimin e z. Shqipërim Pula nga pozita e anëtarit të Bordit të Autoritetit Rregullator të komunikimeve elektronike dhe postare

Votojmë tash! Ky është rezultati i votimit, nuk ka kuorum.

- Votimi i Propozim-rezolutës nga debati parlamentar lidhur me angazhimet e Presidentit të Kosovës për përfshirjen e shkëmbimit të territoreve apo korigjimit të kufijve në dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë

Votojmë tash! Nuk ka kuorum për votim.

- Emërimi i kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Komisioni për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar listën e kandidatëve për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë ZRE, të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar të zgjedhë kryesuesin e këtij Bordi nga katër kandidatët e propozuar.

Kryetare e komisionit, zonja Sala Berisha-Shala, a po na jep një raport për arsyetimin e rekomandimit dhe a po hyjmë në votim. Në qoftë se votohet, ta dimë të mos i maltretojmë deputetët, nëse nuk janë 61, bile të mos maltretohemi.

Zonja Sala pres me entuziazëm të na raportosh për komision.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!

Komisioni Parlamentar për Zhvillim Ekonomik e ka shqyrtuar rekomandimin e Qeverisë në propozimin për të zgjedhur me votim të fshehtë një nga katër propozimet për kryesues të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Kandidatët në bazë të pikave ose poenëve të vlerësuar nga implementuesi i projektit në bashkëpunim me panelin tjetër përgjegjës nga Qeveria, ka dalë këta kandidatë: Bekim Jakupi, Petrit Pepaj, Fadil Ismajli, Përparim Kabashi.

Kështu, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbështetje të Ligjit nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë i ka propozuar Kuvendit për kryesues të Bordit, njëri nga këta duhet të zgjidhet me votim të fshehtë. Ju ftoj të gjithë kolegë deputetë të merrni pjesë në votim dhe të zgjidhni më të mirin, ne e dimë që është në bazë të poenëve, e kemi edhe listën, se cili është vlerësuar më i miri në këtë konkurrim. Faleminderit!

KRYETARI: Zonja kryetare, cili ke më i miri ta dimë! Përgatitemi për votim, grupet parlamentare, teknika, kisha pasur dëshirë të fillojë procesin e përgatitjes së votimit. Ndërkohë, nga Lidhja Demokratike e Kosovës ftoj përfaqësuesin e LDK-së ta propozojë një anëtar për komision.

AVDULLAH HOTI: Kryetar!

Ne sot jemi në proces të votimit për rezolutën më të rëndësishme, duke pasur parasysh zhvillimet e fundit. Nuk ka kuorum për asnjë pikë në veçanti, nuk ka dakordim mes forcave politike për të vendosur një pikë të kuqe në procesin e dialogut, nuk ka kuptim as të vazhdojë më tutje seanca, lëre më të propozojmë anëtarë nëpër komisione të tilla. Ne nuk propozojmë anëtar për këtë komision.

KRYETARI: Është e drejtë legjitime juaja. Shkojmë te Partia Demokratike e Kosovës, Memli Krasniqi e ka fjalën.

MEMLI KRASNIQI: Faleminderit! Ne propozojmë në komision deputetin Mërgim Lushtaku.

KRYETARI: Faleminderit! Lëvizja Vetëvendosje!

FATMIRE KOLLÇAKU: Tashmë është e qartë që Kuvendi është jofunksional, asnjë çështje nuk po mund të shtyhet përpara. Pikërisht edhe mosgatishmëria për votimin e rezolutës aq të rëndësishme, ne këtu po jua bëjmë me dije që ne nuk do të përfaqësohemi fare dhe nuk do të marrim pjesë në këtë votim.

KRYETARI: Tash mbase ka ndikuar kjo embargoja që e kemi bërë 100% Serbisë pak, po s'paska... Partia Socialdemokrate, zoti Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate propozojmë deputetin Frashër Krasniqi.

KRYETARI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zoti Nitaj.

MUHARREM NITAJ: I nderuar kryetar, nuk është problem, ne do ta propozojmë një kandidat, por meqenëse situatën e kemi çfarë e kemi dhe gjasat që të sigurohet kuorumi i nevojshëm janë pothuajse kurrfarë, unë ju propozoj që votimin për këtë pikë ta shtyjmë për një mbledhje tjetër. Nëse ju nuk doni që ta shtyjmë këtë pikë të rendit të ditës për një ditë tjetër e të humbim edhe, ku di unë, 40 minuta kohë këtu duke votuar dhe të mos prodhojnë rezultat, në një situatë të tillë atëherë e propozoj veten për këtë farë komisioni.

KRYETARI: Zoti Nitaj e dha një propozim të mençur, do ta konsideroja, në fund do ta them prapë, por ne po e marrim të mirëqenë propozimin. Zonja Flora, reagim, mos ka të bëjë edhe kjo me konsensusin.

FLORA BROVINA: Faleminderit! Vetëm një minutë. Desha t'i pyes kolegët e mi opozitarë, Parlamenti i Kosovës a është Parlament legjislativ apo kryesoren e ka të nxjerrë rezoluta, të cilat qenkan aq të rëndësishme mbi ligjet. E, kjo është vërtet për të ardhur turp.

KRYETARI: Faleminderit, zonja Brovina! Jemi në pikë të rendit të ditës, atëherë shkojmë, Lista serbe nuk qenka këtu. Zonja Albulena Halimaj, fjala për ju.

ALBULENA HALIMAJ: Ndajmë të njëjtin mendim me zotin Nitaj, kjo pikë duhet të shtyhet, përndryshe nëse vazhdoni, është Veton Berisha që Nisma Socialdemokrate e jep.

KRYETARI: Ne po i marrim emrat, 6+, pastaj edhe një herë do ta bisedojmë, do t'i pyes kolegët, ja ku i keni, në qoftë se nuk votojmë, të paktën të mos na maltretojnë të futemi në votim, për të mos arritur 61, por nëse votojnë, pastaj shkojnë më të mirin e votojmë. 6+!

ALBERT KINOLLI: Faleminderit, i nderuar kryetar!
Grupi Parlamentar 6+ propozon deputetin Danush Ademi.

KRYETARI: Faleminderit! Për pozitën e kryesuesit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë Qeveria ka propozuar katër kandidatë, si në vijim: Bekim Jakupi, Petrit Pepaj, Fadil Ismajli, Përparim Gashi.

Kështu, tash a ka mundësi, a ka dikush kundër këtij grupi të komisionit votues, pa hyrë në proces të votimit, pa e konstatuar. Sa deputetë janë në sallë? 60. S'kemi mundësi, kur të kemi mundësi votimi, pastaj kthehemi prapë, po vazhdojmë se veç 60 deputetë qenkan.

- Shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve në Prishtinë për vitin 2017, sh. a.

Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për pasqyrat vjetore financiare të Stacionit të Autobusëve të Prishtinës për vitin 2017, dhe Kuvendit i kanë rekomanduar shqyrtimin e tij, si dhe t'i miratojë rekomandimet.

Kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zotin Driton Selmanaj, e ftoj për arsyetimin e raportit me rekomandime.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit! Të nderuar kolegë deputetë,

Në fakt, pas të gjitha këtyre temave të rëndësishme, ne po i harrojmë krejt ato dhe po i kthehemi Stacionit të Autobusëve, por megjithatë jam i detyruar, meqenëse jam kryetar i komisionit, po flas në emër të komisionit, përndryshe si deputet as që isha marrë me këtë temë, për shkak që i kemi lënë temat e rëndësishme, po flas gjithmonë për Kosovën.

Në fakt, ajo çka është pozitive është që zyra e auditorit ka filluar që tashmë t'i auditojë një numër të madh të ndërmarrjeve publike në Kosovë dhe ne si komision kemi vlerësuar për shkak të keqmenaxhimit, për shkak të sjelljeve të papërgjegjshme të organeve udhëheqëse të këtyre institucioneve t'i rekomandojmë seancës që t'i trajtojë në mënyrë që niveli i përgjegjësisë, ose kërkesa për llogaridhënie të rritet edhe më shumë. Unë po i arsyetoj disa të dhëna, të cilat Zyra Kombëtare e Auditorit i ka gjetur për këtë institucion: ka gjetur planifikim të dobët të të hyrave dhe shpenzimeve në planin e biznesit për vitet 2017-2019, përmbajtja e planit të biznesit për shpenzimet administrative, shpenzimet e mirëmbajtjes dhe shpenzimeve operative nuk reflekton mundësi dhe nevojat reale të ndërmarrjes.

Stacioni i Autobusëve ka planifikuar shpenzime të ndërmarrjes më të larta sa të hyrat e saj, Zyra Kombëtare e Auditimit ka deklaruar se planifikimi i buxhetit që ndërmarrja të shpenzojë më shumë se sa të realizojë të hyra rrezikon qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e ndërmarrjes, nga ana tjetër ka gjetur një numër të madh të kontratave që kjo kompani i ka bërë në kundërshtim me Ligjin e prokurimit publik më Kosovë, nuk ka respektuar procedura të rekrutimit dhe nga ana tjetër, më skandalozja është që kjo kompani, edhe pse dy vjetët e fundit ka punuar me humbje, në maj të vitit 2017 merr një vendim Bordi për t'i kompensuar ose për t'i dhënë të ardhura shtesë Bordit për stimulim dhe madje në këto vlera: kryeshefin ekzekutiv e shpërblen me 6 300 euro, anëtarët e tjerë të Bordit të drejtorëve i shpërblen në shuma prej 3 570 euro, 3 mijë e 420 euro, 3 300 euro dhe e fundit përsëri është 3 300 euro.

Po e them edhe një herë, përkundër që kjo kompani në dy vjetët e fundit punon, operon me humbje, këta e kompensojnë veten ose, po them i japin shpërblim vetes në shifra të tilla, të cilat i përmenda. Në këtë kontekst, ne kemi përgatitur si komision dy rekomandime dhe ju rekomandojmë juve si seancë më pas t'i votoni. Rekomandimi i parë është që Stacioni i Autobusëve të raportojë në afat prej tre muajve pranë Kuvendit të Kosovës për nivelin e implementimit të rekomandimeve që dalin nga raporti i auditimit për pasqyrat vjetore financiare të vitit 2017 në përgjithësi dhe, në veçanti të marrë masat e nevojshme për të përmirësuar të gjitha çështjet që kanë ndikuar në kualifikimin e këtij opinioni. Dhe, rekomandimi i dytë është që Kuvendi i Kosovës i rekomandon Komunës së Prishtinës, si aksionar i vetëm i ndërmarrjes publike lokale Stacioni i Autobusëve, që të ushtrojë një mbikëqyrje më efektive për të siguruar që kjo ndërmarrje të qeveriset në mënyrë efektive dhe efikase.

Me theks të veçantë, Komuna e Prishtinës duhet të kalojë praktikat joadekuate të kësaj ndërmarrje që në vitet kur ndërmarrja ka vështirësi financiare, si ai i vitit 2016, Bordi i drejtorëve i shpërndanë për vete 50% të vlerës si honorare vjetore, si stimulim për efektshmërinë, duke vështirësuar edhe më tutje gjendjen financiare të ndërmarrjes. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetarja e Kuvendit, znj. Myfera Shinik.)

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalë e ka përfaqësuesi i LDK-së, nuk është paraqitur, e ka kryer. Përfaqësuesi i PDK-së. Urdhëro, deputeti Mërgim Lushtaku!

MËRGIM LUSHTAKU: Faleminderit! Ne si grup parlamentar i kemi shqyrtuar këto rekomandime të komisionit, meqenëse edhe vetë jam në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe me kujdes e kemi shikuar këtë raport të auditimit, por edhe në komision e kemi shprehur se nuk është dashur të vihet në këtë seancë, për arsye se ky nivel, ose Stacioni i Autobusëve të Prishtinës i takon nivelit komunal. Ne e kemi shqyrtuar si raport të Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës këto të gjetura dhe i kemi rekomanduar edhe Komunës, por s'kemi nevojë që temë diskutimi të bëjmë një ndërmarrje të tillë, qysh është ajo lokale e një komune, por megjithëse ne e përgëzojmë Auditorin e Përgjithshëm që ka marrë masa dhe me iniciativën e vetë Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike që të auditojë ndërmarrjet publike, për arsye se kemi një ngecje në këtë aspekt dhe kemi nevojë që të dimë pasqyrat financiare të tyre dhe të gjeturat e tyre. Por, besoj që ky nivel i debatit do të duhej të jetë në Asamblenë Komunale të Prishtinës. Andaj besoj që nuk është e nevojshme të votojmë këto rekomandime. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Tani ftoj përfaqësuesin e Grupit Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje. Ali Lajçi, urdhëroni!

ALI LAJÇI: Pasi edhe isha anëtar i këtij komisioni, të gjeturat që janë edhe u shprehën nga kryetari i komisionit dhe anëtari tjetër janë shumë të sakta dhe një trajtim i tillë i kësaj teme

faktikisht ka gjetur në shesh mënyrën e menaxhimit të kësaj kompanie dhe e cila faktikisht është orientuar në drejtime jo edhe të ligjshme ndoshta, mund të themi, të disa vendime, të cilat i kanë marrë siç është rasti i caktimit të mëditjeve për takimet e Bordit e të tjera, që faktikisht edhe janë të evidentuara atje. Kemi pasur pasqyra financiare jo në nivel, diku-diku edhe mbivlerësime, ka pasur një shpërputhje me menaxhim dhe nevojat e përgjithshme të kësaj kompanie për synime për të qenë një trend i saj pozitiv. Ne kemi bërë edhe disa rekomandime që u thanë atje dhe kanë gëzuar përkrahjen e plotë të Komisionit dhe pritet që të gjitha to çështje të adresohen, të përmirësohen dhe kështu edhe kjo kompani në fjalë të mund të hyjë në trendin, i cili faktikisht nuk është askund në rregull. Prandaj, edhe përkrahen të gjitha këto rekomandime dhe trajtohet problemi edhe më tej i kësaj ndërmarrjeje.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Pra, Stacioni i Autobusëve në Prishtinë është ndërmarrje e cila për një periudhë kohore ka qenë e menaxhuar si të them kështu me një nënpetk partiak, pra kanë qenë emëtime partiake. Fatkeqësisht, kjo periudhë ka zgjatur tre-katër vjet. Situata ka ndërruar sivjet dhe besoj shumë që gjetjet në raportin vjetor të Auditorit do të adresohen dhe do të trajtohen në mënyrë të duhur. Gjithashtu besoj shumë që me ligjin për ndërmarrjet publike, i cili na vjen në Kuvend së shpejti, shumë prej këtyre sfidave që i kanë komunitat me trajtimin e ndërmarrjeve publike lokale do të adresohen, e rrjedhimisht edhe raportet financiare të këtyre ndërmarrjeve, por edhe proceset e punës dhe procedurat e punës do të trajtohen si duhet në mënyrën më të mirë të mundshme.

Po e ripërsëris, të gjeturat e shpërfaqin pak a shumë një situatë e cila ka qenë komplet e shtyrë si të them nga një trajtim komplet partiak i njërit prej subjekteve që është sot në pushtet, e është shumë vite në pushtet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar AAK, zonja Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Zahvaljujem se predsedavajuća!

Poslanici Parlamentarne grupe AAK su u potpunosti razmotrili ovoj jednogodišnjih izveštaj za 2017 godine o javnom preduzeću Autobusko Stanici u Prištini i slažem su potpunosti sa predsednikom komisije zbog mnogih neregularnosti oko finansijskog izveštavanja, oko poštovanja ljudskih resursa i mnogih neregularnosti koje ovaj izveštaj ima.

Međutim državnih Auditorijum je pokazao da ove godine postoji pozitivan korak prema unutrašnjoj kontroli to institucije, prema načinu menadžiranja i rukovodstvo te institucije, tako da AAK grupa u načelu podržava ovaj izveštaj za 2017 godine. Zahvaljujem!

KRYESUESJA: Hvala Emilija! Lista serbe nuk është e pranishme. Nga Grupi Parlamentar Nisma, deputetja Albulena Balaj-Halimaj.

ALBULENA BALAJ-HALIMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Ngaqë në këtë raport, ose në fakt auditorët kanë gjetur shumë parregullsi në këtë ndërmarrje, pra në Stacionin e Autobusëve, Nisma paksa rezervohet ta mbështesë për shkak pikërisht këtyre të gjeturave që i ka parë Auditori.

Por, përveç shqyrtimit të këtij raporti, ne tash e kemi një gjendje krejt tjetër në Stacionin e Autobusëve. Unë çdo ditë, po besoj edhe ju kolegë, keni pasur rastin që shumë qytetarët t'u ankohen për menaxhimin e Stacionit të Autobusëve në Prishtinë, e sidomos për ato pagesat prej 10 centësh që janë bërë, që duhet paguar secili qytetar që hyn në stacion. Nuk mendoj që është një ide e mirë kjo. Ata duhet ta shqyrtojnë mundësinë e heqjes së kësaj, sepse shpeshherë bëhet një kategorizim i qytetarëve. Ata që s'i kanë 10 centë plus për të shkuar për të hipur në autobus presin rrugëve, për ç'gjë pastaj autobusët detyrohen të ndalen vend e pavend për t'i marrë qytetarët.

Hiç më larg se dje në Kuvend këtu ishin disa qytetare të Shtimes, të cilat pikërisht këtë temë e trajtuan në grupin tonë parlamentar. Pra, propozojmë që këtë ta shqyrtojë mirë Stacioni i Autobusëve dhe t'i ketë parasysh sidomos studentët, sepse një herë u patën thënë që janë të liruar nga kjo pagesë, por që më pas kanë filluar edhe studentët të paguajnë për këtë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Prej Grupit 6+ nuk ka paraqitur. Shkojmë me rend. Fjalën e ka Islam Pacolli. Urdhëroni!

ISLAM PACOLLI: Përshëndetje, kryesuese!

Kolegë të nderuar,

Kor diplomatik, media,

Sigurisht që ndërmarrjet publike e kanë një rëndësi të veçantë, duke marrë parasysh që këto janë pronë shoqërore dhe pastaj natyrisht është e logjikshme dhe e rëndësishme që ato të menaxhohen mirë. Deri pak kohë më herët nuk ka pasur një menaxhim të mirë dhe besoj që edhe opinionin deri diku ka qenë i njoftuar se s'ka pasur menaxhim të mirë. Ka filluar ndryshimi dhe besoj që tani është një përmirësim më i mirë. Sigurisht që ne si deputetë do të kërkojmë që vazhdimisht do ta vëzhgojmë këtë çështje, por ne e përgëzojmë përmirësimin apo fillimin e përmirësimit të menaxhimit. Shpresoj që edhe menaxherin e ri do ta emërojnë dhe natyrisht çdo herë që ka nevojë ne do të kërkojmë llogaridhënie, duke marrë parasysh që këto janë taksa të qytetarëve dhe është pronë publike.

Por, unë e kam një thirrje të ndërmarrjet e tjera publike që të mos i trajtojnë ato prona si prona private që ka shumë, e lënë për të dëshiruar, por le ta kuptojnë njëherë e përgjithmonë që janë

prona të qytetarëve dhe prona publike që nuk i kanë pronat e veta. Prandaj, unë shpresoj dhe i uroj menaxhmentit të ri që do të vijë që ta përmirësojë këtë gjendje, dhe natyrisht nëse ata janë në përmirësim në duke, ne do t'i përkrahim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit kryesuese e Kuvendit!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Realisht kam qenë i befasuar kur e kam parë këtë pikë të rendit të ditës. Konsideroj që Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike në momentin që e ka parë raportin e Auditorit të Përgjithshëm për Stacionin e Autobusëve është dashur të komunikojë me zyrtarët përkatës atje, me kryetarin e Komunës, me Auditorin e Komunës dhe të mbajnë mbledhje të rregullt, që është edhe në kompetencën edhe të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike. Konsideroj se ia ka huq me adresim, sepse këto çështje të Auditorit duhet të adresohen në Kuvendin Komunal dhe jo në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

U tha edhe nga kolegët e tjerë që Stacioni i Autobusëve e ka aksionar 100 për qind Kuvendin Komunal dhe prej se jam deputet është mandati i dytë dhe nuk kemi pasur rast të shqyrtojmë raporte të tilla në seanca. Ose i ka kryer krejt punën Komisioni për Mbikëqyrje të Financave dhe kanë dalë deri në stacion, atëherë nëse këta i kanë kryer këto punët e tjera i përgëzoj. Por, mendoj që ia kanë huq me adresim dhe nuk do ta përkrah këtë pikë të rendit të ditës për arsye se është kompetencë e Kuvendit Komunal. Edhe ashtu me ligj, Kuvendi Komunal nën afat të caktuar e ka për t'i shqyrtuar në Asamblenë Komunale këto të gjetura të Auditorit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka si deputet zoti Dardan Sejdiu. Urdhëro, Dardan!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Unë e shpreha qëndrimin në emër të Grupit Parlamentar, tash e kërkova fjalën si ish-nënkryetar i Komunës së Prishtinës për tre vjet e gjysmë dhe si person i cili ka qenë drejtpërdrejt i involvuar në menaxhimin e ndërmarrjeve publike lokale në Komunën e Prishtinës.

E para e punës duhet të qartësojmë për të gjithë qytetarët që Kuvendi Komunal është aksionari i ndërmarrjes, pra thënë thjesht Komuna e Prishtinës është pronar 100 për qind i ndërmarrjes dhe menaxhimi i kësaj ndërmarrjeje duke zgjedhur aksionarët, tre aksionarë nga Kuvendi Komunal dhe këta aksionarë e zgjedhin Bordin, kurse Bordi e zgjedh drejtorin dhe menaxhmentin.

Në mandatin e kaluar, pra deri më tani, këtë ndërmarrje e kanë menaxhuar subjektet opozitare në Prishtinë, e të cilat kanë emëruar edhe bord, edhe kryeshef ekzekutiv. Raporti pra e trajton gjendjen në Stacionin e Autobusëve në periudhën kohore për vitin 2017.

Unë e mora fjalën për t'i informuar qytetarët edhe në lidhje me çështjen të cilën e ngrehu kolegia nga Nisma. Pra, Bordi i Drejtorëve të Stacionit të Autobusëve, i emëruar rishtazi nga komisioni i aksionarëve, i zgjedhur rishtazi në Komunën e Prishtinës, merr vendim javën e ardhshme që të hiqet taksa 10 centë për qytetarët dhe fillojmë me implementimin, zbatimin e rekomandimeve, të cilat i ka Auditori i Përgjithshëm për Stacionin e Autobusëve.

Në anën tjetër, dua gjithashtu t'i bashkëngjitëm fjalës së deputetit Beqaj, duke thënë që ndërmarrjet publike lokale, ndonëse me ligj këtë mund ta trajtojmë edhe në Kuvend pra si një raport i Auditorit të Përgjithshëm, ndërmarrjet publike lokale, në këtë rast ndërmarrja publike lokale Stacioni i Autobusëve e ka pronar 100 për qind Komunën e Prishtinës dhe me anë të Komunës së Prishtinës, aksionarëve në Komunë të Prishtinës, mund t'i trajtojë dhe duhet t'i trajtojë edhe këto tema.

Rrjedhimisht, ne si Grup Parlamentar i Partisë Socialdemokrate do të aprovojmë apo do të votojmë për këtë raport vjetor, meqë besoj e shpërfaq në mënyrë të drejtë mënyrën sesi është menaxhuar Stacioni i Autobusëve në vitin 2017. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Driton Selmanaj.

DRITON SELMANAJ: Faleminderit, kryesuese!

Sa për t'ua sqaruar atyre që as nuk e kanë lexuar ligjin dhe as s'e kuptojnë në fakt çka domethënë paraja publike dhe çka në fakt bie në kompetencë të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike në Kosovë, ne e trajtojmë secilin raport të cilin Zyra Kombëtare e Auditimit e auditon. Fati i mirë për Kosovën po ndodh që Zyra Kombëtare e Auditimit tashmë ka filluar që edhe ndërmarrjet publike, qofshin lokale, qofshin rajonale t'i trajtojë dhe ata menaxhojnë me paranë publike, a janë të komunave, a janë prej Kuvendit, mos harroni që edhe paratë për komunitat ky Kuvend i miraton dhe tash, duke e parë nivelin shqetësues të mënyrës sesi menaxhohen këto ndërmarrje, ne kemi dashur që t'i japim rëndësi edhe më të madhe për të ardhur në seancë dhe për t'i trajtuar këto. Kush është fajtori? A është Komuna e Prishtinës, a është komuna tjetër, ne politikisht duhet t'i japim adresim në kontekstin e asaj që paraja publike po keqmenaxhohet. Nuk po flasim për të ardhura private, po flasim për të ardhura publike. Në atë institucion ne kemi parë se ka telashe të të gjitha shkallëve, duke filluar prej rekrutimit, mënyra si merren njerëzit në punë, mënyra sesi menaxhojnë financat e tyre, mënyra sesi i auditojnë financa e tyre, mënyra se si funksionojnë me humbje.

Nuk është çështja vetëm te ajo çfarë ka ndodhur në 2007-ën. Ne edhe për vitin 2018, mënyra se çfarë na e prezantonte Bordi aktual, ne do t'i trajtojmë në vitin e ardhshëm dhe më pas do t'i shohim nëse ka kesi pozitiviteti që zoti Sejdiu po e thotë. Por, ne edhe sot kur i dëgjonim ata, aq dekurajuese informatat e tyre për gjendjen në atë ndërmarrje, saqë ne vërtet duhet të mendojmë seriozisht si t'i qasemi kësaj problematike.

Nëse mendon dikush, sepse tash kur po i shoh që po tentojnë që nuk ishte dashur kjo të vijë, atëherë e kam përshtypjen sikur kjo parti politike paska pasur qasje të madhe aty, ose vërtet ndihet përgjegjëse për gjendjen në atë institucion, pavarësisht kush e ka menaxhuar Komunën e Prishtinës.

Unë po them, secili institucion që menaxhon me paranë publike në Kosovë duhet të jetë objekt shqetësimi dhe trajtimi edhe nga seanca plenare. E kemi menduar ne si Komision, a është Stacioni i Autobusëve një prej temave që duhet të vijë, por duke e parë nivelin shqetësues të keqmenaxhimit, kemi thënë “secili raport i cili është i keq i secilës ndërmarrje në Kosovë, edhe i komunave madje”, sepse me këtë logjikë çfarë po thotë zoti Beqaj i bie që as raporti për menaxhimin e financave publike nga komunat s’ka nevojë, sepse janë komuna ato, “s’kemi nevojë t’i sjellim këtu, le t’i trajtojnë asambltetë komunale”. Nuk është ashtu. Është buxheti i shtetit, është buxheti që ne e ndajmë për komuna, e që në fakt ne si Kuvend, si Komision për Buxhet mund që Komunës së Prishtinës të mos i japim para të mjaftueshme, sepse po keqmenaxhon me ndërmarrjet e saj.

Kjo është mënyra sesi do të funksiononte llogaridhënia dhe unë mendoj që ju kërkoj prej juve që ju t’i jepni votë kësaj, sepse ideja jonë është të kujdesemi maksimalisht për secilin send çfarë po ndodh në secilin institucion për paranë publike. Po e them për të satën herë, jo për të ardhurat e tjera.

KRYESUESJA: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesuese!

Zoti Selmani ndoshta e ka problem ta kuptojë. Ne të gjithë thamë që me ligj, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave ka të drejtë t’i trajtojë të gjeturat edhe në nivele komunale, por adresimi thamë është gabim. Edhe e pyes zotin Selmani si hap të parë, unë kam qenë anëtar i Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike në mandatin e kaluar, kemi mbajtur takime të rregullta edhe me kryetarët e komunave, edhe me kryesuesit e asambltesë, kemi mbajtur kontakte edhe me auditorët që janë atje, a e kanë pyetur këta, a kanë thirrur si Komision më së pari Komunën e Prishtinë që ta ngrejë këtë çështje. Nëse ata kanë problem, Kuvendi Komunal me ligj ka të drejtë, Asambleja Komunale atëherë të na drejtohet edhe neve.

Unë mendoj se ka problem zoti Selmani ta kuptojë ligjin, apo do që këtë gabim apo këtë huqje që e ka bërë për adresim për ta arsyetuar, apo ndoshta ka edhe probleme të tjera. Ne nuk e arsyetuam raportin e Auditorit, as nuk e shqyrtuam raportin e Auditorit, por po them që juridikisht raporti i Auditorit i ka do rrugë të tjera që të vijë deri në Kuvend, sepse është dashur të komunikohet me kryetarin e Komunës së Prishtinës, me Asamblenë e Prishtinës dhe me Auditorin e Prishtinës. Në bazë të informatave që i kam as që kanë tentuar të komunikojnë me Komunën e Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Për kundër-replikë, fjalën e ka deputeti Driton Selmanaj, një minutë. Urdhëroni!

DRITON SELMANAJ: E para, Dritoni nuk e ka sjellë këtë dokument si Driton. Unë e kam sjellë në emër të Komisionit. Komisioni ka votuar për të ardhur këtu. E dyta, ne e kemi trajtuar edhe raportin e KRU Prishtinës. Edhe ai është po ashtu negativ. Ne duke i parë këto të dyja, në mbledhjen e ardhshme të Komisionit shumë shpejt do ta ftojme kryetarin e Komunës së Prishtinës, por po dua t' i them zotit Beqaj, a e di ku është shqetësimi zotit Beqaj, sepse shumë shpejt kemi për ta trajtuar edhe raportin ku zoti Beqaj ka qenë anëtar i Bordit dhe këtij nuk po i intereson që të trajtohen këto kompani rajonale ose lokale me të cilat këta kanë keqmenaxhuar. Prandaj, po i them kemi për t' i trajtuar edhe ato raporte, edhe ato ku ka qenë ky. Në rregull jemi.

KRYESUESJA: Faleminderit! E dini që nuk keni të drejtë. Hajt, urdhëro Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Prapë zoti Selmani e ka problem të bëjë kategorizimin siç e bën ligji. Ndërmarrja publike Ujësjiellësi i Prishtinës është ndërmarrje regjionale, edhe aty Bordin e emëron Qeveria e Republikës së Kosovës, e jo Komuna. Prapë këtu ia ka huq, sepse 100 për qind dallon raporti apo ndërmarrja regjionale Prishtina, Ujësjiellësi Prishtina me Stacionin e Autobusëve, por i kisha propozuar ta lexojë ligjin ose t' i kryejë punët që i kanë atje në Komision, e jo të na ngarkojë, se edhe ashtu e kemi rendin e ditës të ngarkuar si Kuvend i Republikës së Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit për replikë! Fjalën e ka deputeti Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Unë jam mirënjohës për Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike që e trajton temën e parasë publike dhe besoj që secili deputet këtu ndihet po aq mirë kur trajtohen tema të tilla.

Për mua sa për sqarim, nuk po replikoj me zotin Selmanaj, mendoj se e ka një çik një ngarkesë në drejtim me Prishtinën, besoj që e kalojnë edhe garën e ardhshme.

Ajo çka është me rëndësi të thuhet është që me ligj kërkohet konsolidimi i pasqyrave financiare të ndërmarrjeve publike lokale me komunat dhe jo veç në Prishtinë, por në secilën komunë në Kosovë. Besoj që kjo është një prej detyrave tuaja që të siguroheni që konsolidimi i pasqyrave financiare të ndodhë për krejt ndërmarrjet publike lokale me komunën përkatëse. Vetëm kështu keni pasqyra të qarta financiare për shpenzimin e parasë publike dhe mënyrës sesi menaxhohen ato para publike.

E dyta, aksionari qind për qind i ndërmarrjes publike lokale Stacioni i Autobusëve është Komuna e Prishtinës. Qeverisja e kësaj ndërmarrjeje publike lokale definohet me ligj. Aksionarë janë të

deleguar nga Kuvendi Komunal, këta aksionarë e zgjedhin Bordin, Bordi e zgjedh menaxhmentin dhe prapa shkon raportimi deri në Asamblenë Komunale. Nëse Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike e sheh një raport të Auditorit për të cilin është i zemëruar, unë jam plotësisht dakord që ju ta trajtoni. Në rregull jemi. Por, jam gjithashtu i interesuar që i njëjti komision të bëjë kërkesë te secila komunë gjithandej Republikës së Kosovës që të bëhet konsolidimi i pasqyrave financiare të Komunës me ndërmarrjet publike lokale dhe, e dyta, të kërkohet listë e saktë dhe e qartë e aseteve të secilës komunë, pra edhe pronat, pa marrë parasysh kush e menaxhon me ato komuna. Hajde t'i shohim pra cila është pasuria. Si po menaxhohen këto para publike dhe a po konsolidohen në një pasqyrë financiare. E kështu, atëherë përnjëmend sigurohemi që paraja publike po shkon ku duhet.

KRYESUESJA: Faleminderit, Dardan! Për kundër-replikë, fjalën e ka Driton Selmanaj. Urdhëroni!

DRITON SELMANAJ: Jo, në fakt më tepër e kam për informatë. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i trajton raportet i auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Kaq!

E mira e kësaj është, jam duke e thënë për të disatën herë, që Zyra Kombëtare e Auditimit ka filluar t'i trajtojë pothuajse shumicën e ndërmarrjeve publike në të gjithë Kosovën. Kemi filluar me Stacionin e Autobusëve në Prishtinë. Kemi për t'i sjellë edhe ndërmarrjet tjera të komunave tjera, sepse po flasim për nivel abuziv të madh.

Nuk e kam problem me ngarkesa, zoti Sejdiu. Po më vjen keq për këtë qasje, sepse prej teje nuk e pres. Unë jam duke folur për keqpërdorime. Çdo gjë që ka për të pasur në raport, kam për t'i thënë në seancë. Edhe në emër të komisionit, edhe si Driton, kujt do qoftë, kurdo qoftë, prej çfarëdo institucioni.

A nëse provoni nën petkun e këtyre farë lojërave politike t'i mbuloni abuzimet, këtë s'mundem. S'mundem!

KRYESUESJA: Dardan, e di që nuk ke të drejtë, veç urdhëro, një minutë e ke!

DARDAN SEJDIU: E para, qasja ime është komplet ligjore profesionale. Pra, unë këtu nuk jam duke e mbrojtur Stacionin e Autobusëve. Sa për informacionin tëndin zoti Selmanaj, Stacioni i Autobusëve ka qenë i menaxhuar nga LDK njëherë, e pastaj nga PDK. Pra, unë po dalë këtu të flas për parti. Unë po flas për proces.

Unë çka po them, si Komision për Mbikëqyrjen e Financave Publike ti duhet të shkosh përtej raportit të Auditorit, të thuash a ka mundësi t'i sillni raportet e konsoliduara financiare të të gjitha komunave, meqë unë po kujdesem për parane publike. Pra, ti e nise fjalimin tënd, duke

thënë se unë duhet të kujdesem për publike. Unë po jap sugjerim. Ti mos e merr me siklet. Unë veç po them, kërko raportet të konsoliduara financiare dhe kërko që ta kemi saktë listën e aseteve për secilën komunë çfarë pronash ka. Ku janë obligimet? Ku janë të hyrat? Si po keqpërdoren e keq menaxhohet? Unë jam në vijë me ty. Veçse mos të jemi kështu si të themi të ngurtë e selektiv sa i përket raporteve që i trajtojmë.

KRYESUESJA: Faleminderit! Veç një minutë e ke Driton Selmanaj. Pas Dritonit, Emilija Rexhepi.

DRITON SELMANAJ: Zoti Sejdiu, veç edhe pak mos dil prej sallës!

Unë nuk mund të flas për çfarë dëshire kishim pasur që të ketë mandat ky komision. Ky komision e ka këtë mandat. Unë jam duke punuar në bazë të mandatit që e ka ky komision. S'mund tash të trajtojmë diçka tjetër për të cilën nuk është në mandatin tonë.

Çka i sugjeroj zotit Sejdiu është që të kujdeset që anëtarët e partisë së tij të mos t'i ndërrojë si anëtarë të komisionit dhe ata të tillë ta njoftojnë për mandatin e komisionit, sepse që tri herë po na i ndërrojnë anëtarët, tash së fundi kemi mbetur pa anëtarë fare nga PSD-ja.

Le ta sjellin njeriun, e ai si i tillë le ta njoftojë zotin Sejdiu për mandatin që ka komisioni. Zoti Topalli e ka udhëhequr këtë komision. Ai ka njohuri të mjaftueshme sa për ta njoftuar zotin Sejdiu për mandatin që e kemi. Do të merremi me secilin cent që ka për ta trajtuar Zyra Kombëtare e Auditimit. Është mandat. Jo që unë dua. Është mandat që ma ka dhënë Kuvendi, dhe më pas edhe partia që më ka përcaktuar që unë ta udhëheq këtë komision.

KRYESUESJA: Faleminderit! Urdhëro, Emilija Rexhepi.

EMILIJA REDŽEPI: Poštovani kolege poslanici!

Kao član Parlamentarne komisije za nadgledanje javnih financija absolutno me ne zanima koja politička partia stoji za kojeg javnog preduzeča, govorimo o zloupotrebi javnog, odnosno državnog novca. I mi smo svih kao komisija, članovi unutar komisije donoli jednoglasno odluku da ovaj izveštaj danas bude u Parlamentu na razmatranje, što će isto doći i izveštaj za Železničku stanicu zbog svih neregularnosti i zloupotrebe javnog novca.

Tako do molim kolege poslanike bez obzira koje bio gdje i kako je šta radio, dali je neko akcionar, ili i bio član borda, absolutno nas to ne interesuje, interesuje nas samo zloupotreba javnog novca i rukovodstvo menadnjenta javnih državnih institucija.

KRYESUESJA: Hvala gospođa, Emilija! Fjalën e ka deputeti Mërgim Lushtaku! Urdhëroni!

MËRGIM LUSHTAKU: Realisht, diskutimi është shumë i mirë që po bëhet për këtë çështje. E thashë edhe më herët, qasja që ne t'i diskutojmë ndërmarrjet publike komunale për mua nuk është e duhur. Nëse flasim për ndërmarrjet publike në tërësi dhe e ftojme edhe Komunën e Prishtinës, i ftojme edhe komunat tjera dhe ndërmarrjet publike të tjera, besoj që do të ishte një debat më i frytshëm dhe do t'i kishin shikuar pasojat financiare të tërat si komunë, dhe kishim bërë krahasime edhe me vitet tjera.

Pastaj do t'i kishim nxjerrë të gjeturat e duhura që ta përmirësojmë gjendjen e secilës kategori dhe secilës çështje që e ka ngrehur Auditori i Përgjithshëm në këtë rast.

Ne duhet të mësohemi edhe në të gjitha komisionet që të mos bëjmë politika vetëm për inate politike, në këtë rast ndaj Komunës së Prishtinës. E di që kanë konflikte ose kanë mendime të ndryshme për shkak se një parti e caktuar ia ka marrë një partie tjetër, në këtë rast LDK-së, Komunën e Prishtinës, por besoj që as njëra e as tjetra nuk e kanë rezultatin e duhur.

Prandaj, besoj që kërkohet që edhe në Komunën e Prishtinës të ndryshohet kjo qasje, duke i dhënë mundësinë që Prishtina të udhëhiqet nga një parti, e cila ka mundësi të bëjë ndryshime pozitive në këtë komunë, dhe të bëjë ndryshime reale, jo vetëm sa për fushatë.

Edhe një herë po them, që në këtë rast, ne si komision nuk e kemi ftuar komunën e Prishtinës që të përballemi me të dhe të shohim se çfarë ka ndërmarrë Komuna e Prishtinës që t'i ndalojë këto të gjetura ose a ka ndërmarrë, a ka kërkuar një plan të veprimit që t'i shqyrtojë të gjitha ato të gjetura dhe t'i përmirësojë ato, të kërkojë nga ndërmarrja publike e Stacionit të Autobusëve të Prishtinës.

Kështu që ne besoj kemi ngecur në këtë drejtim si komision. E kam shprehur edhe në komision, prandaj edhe nuk kemi votuar në komision që të vijë në seancë dhe ta diskutojmë këtë çështje, për arsye se na u është dukur e mangët si çështje për t'u ngrehur. Megjithëse, thashë edhe më herët, çështjet e financave publike dhe të parasë publike, çdoherë është mirë të diskutohet. Por, besoj që ka qenë e mangët për arsye se është diskutuar vetëm si ndërmarrje publike pa kontestin e Komunës së Prishtinës. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesuese!

E para, ne duhet ta bëjmë dallimin ndërmjet ndërmarrjeve lokale dhe ndërmarrjeve qendrore. S'ka status tjetër, ose është ndërmarrje lokale, ose është ndërmarrje qendrore.

Me ndërmarrjet qendrore, disi ka kuptim që të merret Kuvendi, por me ndërmarrjet lokale ne kemi humbur në hapa. E para, me këtë raport të Auditorit ose pjesë të raportit të Auditorit, që

kanë të bëjnë me ndërmarrjet lokale, duhet të merren asambljetë komunale. Derisa asambljetë komunale nuk janë marrë, atëherë e kemi një lloj prishjeje të kësaj renditjeje.

Mendimi im është se jemi duke u përzier në pushtetin lokal. Është e padrejtë kjo formë çfarë jemi duke punuar. Komisioni ka mundur t'ia bëjë një rekomandim Prokurorisë, hetuesisë dhe organeve tjera kompetente për këtë çështje, por të raportohet tash para Kuvendit, nuk e di a është në domenin e Kuvendin dhe nuk e di a është në prioritetet e Kuvendit. Ne patëm mundësi t'i votojmë shumë ligje të rëndësishme. Nuk votuam për to, nuk bëmë debat për to, tash po flasim për një ndërmarrje lokale dhe debati do të duhej të bëhej nëpër asambljetë komunale.

Asambljetë komunale duhet t'i kenë këto raporte dhe auditori i Përgjithshëm do të duhej t'ua tërhiqte vërejtjen edhe asambleve komunale që ata të merren me këto raporte.

Ne e kemi bërë një bedatë të re, diçka të re, dhe në qoftë se vazhdojmë kështu do t'i kemi 125 raporte të tilla brenda vitit. Po mendojmë që nuk është traditë e mirë. Duhet ta gjejmë mënyrën më të mirë të mundshme, por të mos merret Kuvendi i Kosovës, përveçse në raste të veçanta. Nuk e di pse është rast i veçantë, ndërmarrjet lokale përafërsisht do ta kenë auditimin e njëjtë të këtij niveli çfarë është edhe ky auditim që i është bërë kësaj ndërmarrjeje lokale. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Bekim Haxhiu! Urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Të nderuar kolegë deputetë,

Nuk e kisha në plan të kyçem në këtë pikë të rendit të ditës, edhe pse kur e kam marrë rendin e ditës e kam parë që kjo pikë nuk është për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Po befasohe me propozuesin i cili e ka sjellë në këtë seancë të Kuvendit, edhe pse komisioni parlamentar ka të drejtë t'i shikojë të gjitha raportet, e t'i analizojë të gjitha raportet e auditimit, por jo ato të sillen në Kuvend. Ato duhet të adresohen në institucionin përkatës.

Unë besoj që të gjitha asambljetë komunale në Republikën e Kosovës kanë asamblistë profesionale që dinë t'i adresojnë këto shqetësime të Auditorit. Ose kjo i bie që dikush ndoshta mendon që nuk ka asamblistë të duhur atje ku i kanë propozuar në asambljetë komunale, prandaj duhet të sillen që t'i trajtojnë vetë këtu.

Po më zhgënjën pak edhe Kryesia e Kuvendit. Për tri mandate deputet në Kuvendin e Kosovës nuk më ka rastisur që ne t'i trajtojmë auditimet e ndërmarrjeve publike komunale. Është hera e parë. Është udhëhequr edhe nga profesionistë si Aliu e të tjerë të LDK-së ky komision, por nuk kanë ardhur këtu, Driton.

Me këtë, Driton po më bind që kur ia ke filluar politikës, ambiciet i ke pasur për asamblist, por rastësisht je bërë deputet. Mënyra si po e trajton, sepse po do që ta shndërrosh Kuvendin në një vend ku trajtohen tema për gjithçka. Është vendi i debateve, i politikës, i të bërit politikë, por duhet të ruhen disa norma, e në veçanti ndarja e pushteteve. Nuk është kjo për këtu. Nuk kemi çfarë trajtojmë këtu. Kjo duhet të adresohet në asamble, e nëse keni parë elemente të veprës penale, i adresoni edhe ato në organe, nëse e keni guximin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Për replikë, fjalën e ka Driton Selmanaj. Urdhëroni!

DRITON SELMANAJ: Po tash më duket vetja më shumë si profesor i këtyre sesa si politikan, sepse po më duhet që t'i informoj prapë, sepse s'po dinë.

Çka po them unë? Nuk kanë pasur sesi të vijnë raporte të tilla sepse s'ka pasur auditime prej Zyrës Kombëtare të Auditimit për ndërmarrjet të tilla publike. Nuk ka pasur më herët. Prej para dy vjetëve ka filluar në praktikë e tillë, dhe kjo ka ardhur si rezultat i kërkesës së të gjithë deputetëve që e kanë ndërruar ligjin pak më herët, që edhe ndërmarrjet publike të jenë objekt i auditimit.

S'ka mundur të vijë përpara kur ZKA-ja nuk ka bërë punë të tillë. Në momentin kur kanë filluar që ta bëjnë një punë të tillë, ne jemi duke i trajtuar, nuk e sjellim çdo raport këtu. Ne trajtojmë me dhjetëra e dhjetëra raporte. I kemi dy mënyra; ose i dërgojmë rekomandimet e komisionit tek institucioni, ose kur e shohim nivelin shqetësues të të dhënave, të të gjeturave, i rekomandojmë seancës. Dhe, ne duke e parë që nuk është vetëm te Stacioni i Autobusëve, por është tek shumica e ndërmarrjeve publik, është fenomen abuzimi me paranë publike, ne kemi dashur që ta ngremë nivelin e përgjegjësisë dhe të diskutimit për këto institucione.

Sepse, kemi folur 17 vjet, këto ndërmarrje kanë qenë çerdhe të partive politike për të abuzuar me paranë publike në Kosovë. Dhe, tash, në momentin kur kemi filluar t'i hapim letrat, këta po fillojnë të shqetësohen, sepse pjesa dërmuese e anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike do të dalin të partisë së tyre. E di reagimin e tyre, sepse po e dinë se çfarë do t'i gjejë në raportet e institucioneve të tjera, por do të vijnë të gjitha këtu.

Për çdo institucion, qoftë lokal, qoftë qendror, që paranë publike e ka formë të menaxhimit të saj do t'i trajtojmë. Është mandat yni. E nëse ju duhet ligjëratë ekstra, ejani një ditë në mbledhje të komisionit dhe ju mbajmë edhe ligjërata. Edhe ju tregojmë edhe për ambiciet tjera.

KRYESUESJA: Faleminderit! Për kundër-replikë, fjalën e ka Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: Driton, po dua të them shqip: Përpara se të mendosh që je i mençur, je i tejngarkuar. Je një paragjykes. A mund të më tregosh një gjë, pse nuk e sjell raportin e auditimit

të Stacionit të Autobusëve të Pejës? Pse nuk e sjell të Gjakovës, të Prizrenit, por e ke sjellë të Prishtinës? A të Gjilanit, a? Pse?

Dëgjo, atje i ke anëtarët e partisë sate. Nuk duam ta mbrojmë askënd, Driton! Por, para se të mendosh që je i mençur e mund ta mësosh dikë që i ka tri mandate ose pesë mandate në Kuvend, ishalla ia arrin. Por, thirrjen time nuk do ta arrish kurrë. Larg je nga ajo. As s'do ta arrish nivelin e diskutimit, përveç ngarkesave të ulëta politike në të cilat je duke tentuar ta shndërrosh Kuvendin.

Kthjellu dhe puno! Ke ardhur me votat e qytetarëve për interesin e tyre, e jo për të bërë politikë sa për vete.

KRYESUESJA: Zoti Driton, nuk keni të drejtë. Por, që të mos bëj padrejtësi, urdhëroni!

DRITON SELMANAJ: Tash, përsëri në funksion të edukimit. Unë po them, Zyra Kombëtare e Auditimit ka filluar vonë t'i trajtojë këto institucione. Nuk i ka trajtuar të gjitha. O, kur të vijë edhe i Pejës, edhe i Prizrenit edhe i të gjithave, do t'i trajtojmë edhe me seriozitetin më të madh. Nuk e kemi telashe këtë punë.

Bile, dikush do të mund të më thoshte mua në atë kohë pse po e sjell të Prishtinës se LDK-ja e ka udhëhequr, por e kemi sjellë. Po tash po del që pesë anëtarë të Bordit paskan qenë në PDK. Problemi është këtu. Dhe ne tash, unë po them, kujdesi ynë maksimal është që ta bëjmë punën tonë. Më vjen keq nëse ju po ndiheni në faj, por këtu jemi për këtë punë.

Që ta identifikojmë fajtorin dhe t'ju bëjmë thirrje publike institucioneve ndjekëse që t'i trajtojë këta njerëz. Sepse, disa nën petkun e profesorit vazhdojnë të abuzojnë me paranë publike në çfarëdo forme. E jo, nuk shkon kjo kështu. Edhe për profesorë kishte vende në burg.

KRYESUESJA: Faleminderit! Nuk kemi... Pse bre veç prej PDK-së po bëni telashe. Urdhëro Bekim, urdhëro!

BEKIM HAXHIU: Driton, po ta sqaroj që dëshirën që të jenë krejt pjesëtarët në burg e kanë pasur edhe disa familjarë tuaj. Po, përveç asaj është duke e gëzuar populli lirinë bashkë me ne.

Po ta sqaroj këtë dëshirën tënde apasoniante që e ke që t'i shikosh profesorët edhe ushtarët e UÇK-së në vende të duhura dhe po ta heq atë dëshirë, sepse s'do ta mbërrish kurrë.

E dyta, që është shumë e rëndësishme, unë e di pse e ke sjellë këtë këtu, sepse e ke sabotuar bashkëpartiakun Arbanin, e tash po mundohesh që të nxirresh pak. Sikur t'i ndihmoje pak Arbanit, nuk do të bëhej Shpendi kryetar komune. Kjo të ka mbetur merak.

KRYESUESJA: Edhe një minutë, Driton, urdhëro!

DRITON SELMANAJ: Shiko, po ta respektonim Rregulloren, unë s'do ta kërkoja fjalën. Me replikë, kundër-replikë përfundon gjithçka. Por kur të hysh në këtë avaz, më pas nuk po kam qare pa reaguari. Për ushtarët e vërtetë të këtij vendi dhe për profesorët e vërtetë të këtij vendi, u përulëm maksimalisht, mirëpo për ata të cilët nën petkun, kinse të ushtarit, kinse të angazhimit të tyre, që të abuzojnë dhe ta shkelin këtë vend, do të jem i pamëshirshëm. Dhe, jo vetëm unë, por unë mendoj që është mision.

Është mision kombëtar i secilës gjeneratë, ata që vjedhin të mos jenë as në Kuvend, të mos jenë në institucione publike, po të jenë ose në Dyz, ose edhe në Dubravë. Ky është misioni. Unë mendoj që misioni më patriotik sot nuk është më që të thirremi në vlerat e luftës. Ato vlera do t'i ruajmë si vlera sublime, por abuzuesit nuk duhet të kenë vend në jetën publike. Diku tjetër janë vendet për ata.

KRYESUESJA: Faleminderit! Shkojmë në pauzë deri në orën 14:00.

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton nënkryetarja e Kuvendit, z. Myfera Shiniq.

KRYESUESJA: Vazhdojmë seancën.

Për votim nuk kemi kuorum, u krye debati, vazhdojmë me pikën tjetër.

Vazhdojmë me pikën e radhës të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare

Komisionit për Buxhet dhe Financa e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e raportit me rekomandime.

Ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zoti Lumir Abdixhiku, për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit me rekomandime.

Nënkryetare Safete Hadërgjonaj, urdhëro!

(Ndërhyrje)

Më fal Safete, fjalën e ka Armend Zemaj, urdhëro Armend!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Në emër të Grupit Parlamentar më duhet të shpreh një mocion përmbajtjesor edhe për shtyrjen e pikave të rendit të kësaj seance, por edhe të seancës së re. Ne jemi për gatitur për seancë e re, sidomos për ligjet që janë në paketën e ERA-s dhe kërkojmë që seanca e re mundësisht të fillojë në orën 18:00, pasi që u shtynë edhe pikat sipas rendit të ditës, edhe pauza.

Deputetët e Lidhjes Demokratike të Kosovës të gjithë do të jenë këtu në orën 18:00.

KRYESUESJA: Faleminderit! Shefat e grupeve, nga PDK-ja kush e do fjalën, Ganimete Musliu, urdhëro!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Me sa po shihet, në sallë nuk ka kuorum të mjaftueshëm për të votuar një mocion të tillë. Prandaj, nuk e shoh të arsyeshme ose nuk e di se si do të votohet një mocion, sado përmbajtjesor

qoftë, edhe pse ne nuk guxojmë të lejojmë që prioritet në Kosovë të jenë agjendat partiake dhe jo agjendat shtetërore. Ne duhet ta respektojmë Kuvendin.

KRYESUESJA: Faleminderit, deputete! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, zoti Ismajl Kurteshi, urdhëro!

ISMAJL KURTESHI: Në emër të Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes propozoj që seanca e paradites të përfundojë ashtu siç ka qenë e planifikuar dhe që tani të fillojmë me seancën e re, kurse pikat që kanë mbetur nga seanca që ishte paradite të vazhdojnë në një ditë tjetër.

KRYESUESJA: Faleminderit! Përfaqësuesi i PSD-së, urdhëro Dardan Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesuese!

Për mua kërkesa e zotit Zemaj ishte kërkesë për mirëkuptim nga të gjitha grupet parlamentare në seancë dhe unë kështu e lexova, por më pastaj më befaso i reagimi pas fjalës së deputetëve të PDK-së. Në këtë sallë ka subjekte të tjera opozitare që mund të kenë mirëkuptim për LDK-në dhe duam të kem bashkëpunim.

Rrjedhimisht ne si Parti Socialdemokrate jemi dakord sido që të vendosë seanca plenare, po ne duhet të jemi të hapur për mirëkuptim ndaj subjekteve të tjera, gjithsesi siç thonë amerikanët, duhen dy palët për të vallëzuar, nëse LDK-ja mendon të vazhdojë vetë, në rregull është.

KRYESUESJA: Faleminderit! Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar AAK, zoti Muharrem Nitaj, urdhëroni!

MUHARREM NITAJ: Zonja kryesuese,

Jo vetëm nga opozita, por edhe nga pozita ka gatishmëri për mirëkuptim, të tillë e kuptuam edhe ne kërkesën e zotit Zemaj, nuk po besojmë që ka kushte të vazhdojë seanca. Kështu që nëse mund të merremi vesh që seancën e re ta vazhdojmë në orën 18:00.

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar Nisma, zoti Bilall Sherifi, urdhëroni!

BILALL SHERIFI: Faleminderit, e nderuar nënkryetare e Kuvendit!

Mendoj se do të ishte e udhës të vazhdohen këto pika të rendit të ditës që kanë mbetur pa u trajtuar dhe derisa ne t'i trajtojmë këto, bëhet edhe ora 5 -6, pra edhe e vazhdojmë seancën, edhe plotësohet kërkesa për mirëkuptim e zotit Zemaj dhe mund të ecim përpara duke u plotësuar të dyja.

Ne mendojmë që të vazhdojmë t'i trajtojmë dhe t'i shqyrtojmë këto pika që kanë mbetur, nëse ka kuorum për të votuar, i votojmë, nëse nuk ka vazhdojmë të ndjekim të njëjtin logjikë, presim një

ditë kur kemi kuorum për t'i votuar dhe i votojmë brenda një dite të gjitha çështjet, qofshin ligje, qofshin raporte që kanë mbetur pa u votuar. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Ilir Deda, urdhëro!

ILIR DEDA: Faleminderit!

Unë ju kisha lutur, zonja kryesuese, që të vërtetohet a ka kuorum, ne sot e kemi një pako të ligjeve, të sundimit të ligjit, e cila na duhet patjetër dhe është kërkesë ndaj Kosovës që të miratohet kjo pako e ligjeve dhe duhet të miratohet sot, jo javën e ardhshme, jo kurdo që të bëhet kuorumi, por ne duhet të sigurohemi që sot të ketë kuorum dhe kjo pako e ligjeve të miratohet sot. Nëse jemi 61 deputetë tash, ne duhet të zotohemi të jemi këtu dhe të përfundojmë këtë punë, nëse nuk jemi, duhet të sigurohemi që sot gjatë ditës do të jemi 61 deputetë dhe ta votojmë këtë pako. Faleminderit!

KRYESUESJA: Të nderuar kolegë,

Nëse ka mirëkuptim, shkojmë në pauzë deri në orën 18:00, nëse nuk ka, vazhdojmë seancën. Sa shihet, nuk ka mirëkuptim, vazhdojmë seancën, vazhdojmë me pikat. Faleminderit!

Safete Hadërgjonaj, urdhëro!

(Ndërhyrje)

Urdhëro, Ganimete!

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, nënkryetare e Kuvendit!

Kisha dashur që deputetët të respektohen kur e kërkojnë fjalën, aq më tepër kur unë pata një deklaratë në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës.

E kërkoja fjalën për të sqarua opinionin e gjerë publik, por edhe kolegun nga PSD-ja, sepse kërkesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës nuk ishte për mirëkuptim, ishte për një mocion përmbajtjesor, kështu e tha dhe nëse është për mocion, kërkohet kuorum për të votuar dhe unë e potencova këtë në fjalën time të parë, ata nëse do ta kishin me sinqeritet kërkesën e tyre, do ta kishin marrë fjalën pas meje dhe do të kërkonin mirëkuptimin, por thjesht, e përsëris edhe një herë, nuk guxojmë që agjenda shtetërore të jetë në rend të dytë, ndërsa agjendat partiake që Lidhja Demokratike e Kosovës tani e ka përcaktuar mbledhjen e Këshillit dhe dëshiron të na e imponojë agjendën partiake brenda në Kuvend.

Edhe një herë, ata kërkojnë mocion përmbajtjesor dhe nuk thanë që kërkojnë mirëkuptim për shtyrje të seancës në orën 18:00.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Armend Zemaj, urdhëro Armend!

Dardan Sejdiu, replikë, urdhëro!

DARDAN SEJDIU: E nderuar kryesuese,

Unë thjesht për sqarim, meqë deputetja Musliu nga radhët e PDK-së e përmendi subjektin tim.

Po e them edhe një herë, unë kërkesën e LDK-së nuk e paragjykova dhe e lexova si kërkesë për mirëkuptim, ndërsa proceduralisht kjo u bë me mocion, kështu e lexova unë kërkesën tuaj, zoti Zemaj. Dhe, më pengoj shumë dhe po e ripërsëris sjellja ku një subjekt në pushtet thotë diçka dhe ju vlerësoni në bazë të atij diskutimi mbi sjelljen e të gjitha subjekteve të tjera, besoj që kjo nuk është në rregull dhe korrekte, sidomos karshi subjekteve që po ju mirëkuptojnë këtu sot.

Në këtë drejtim, edhe një herë po e them, nuk po e paragjykoj nëse kanë diçka të paracaktuar, e kanë me rëndësi, ne kemi pika të rendit të ditës të cilat mund të vazhdojmë. Edhe tha edhe zoti Shefi nga Nisma Socialdemokrate, ne vazhdojmë, ndërsa në orën 18:00 i trajtojmë temat të cilat lidhen me agjendën evropiane. Ky është mirëkuptim nga PSD-ja, nëse të tjerët e kanë këtë mirëkuptim, dakord jemi.

KRYESUESJA: Faleminderit! Më fal Armend, një minutë, zoti Ismajl Kurteshi, urdhëroni!

ISMAJL KURTESHI: Faleminderit, kryesuese!

Vetëm desha t'jua përkujtoj se agjendën që e ka përcaktuar Kryesia mund ta ndërrojë seanca vetëm në rastin kur ka kuorum, në këtë situatë kur nuk ka kuorum, ju duhet t'i përmbaheni vendimit të Kryesisë, e kjo do të thotë që në orën 14:00 fillon seanca e re, ata që janë, janë, ata që nuk janë, nuk janë.

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Ismajl Kurteshi. LDK-ja ka kërkuar mirëkuptim. Urdhëro, Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryesuese!

Që dikush nga kolegët thotë ata, unë jam këtu, në emër të grupit, po sigurisht që duhet të ketë edhe sqarim shtesë. Unë nuk përmenda agjendë partiake, dikush po e përcjellka agjendën partiake të subjekteve të tjera politike.

Unë tregova dhe kërkova që deputetët e LDK-së në orën 18:00 do të jenë për votimin e ligjeve, të pakove të ligjeve që janë obligim i agjendës evropiane. Kushdo që dëshiron ta interpretojë ndryshe, e ka gabim dhe për qëllime të këqija, të them, ose të prishjes së atij disponimi apo mirëkuptim që seanca të mblidhet në ora 18:00.

Seanca e re ka qenë e paraparë të mblidhet në orën 14:00, të fillojë në orën 14:00, nuk ka filluar, po ne po kërkojmë që do të jemi në orën 18:00. Nëse dëshironi, vazhdoni me të vjetrën, nuk paraqet problem, mund të vazhdoni edhe me 2-3 deputetë, po seanca e re për votim, nëse Qeveria dhe mazhoranca mendon që ta vazhdojë sot, atëherë ne do të jemi në orën 18:00 për votim. Faleminderit!

KRYESUESJA: Përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të PDK-së, urdhëroni, Ganimete Musliu.

GANIMETE MUSLIU: Singërisht nuk e di çka është e paqartë këtu dhe pse duhet 50 herë të merret fjala për të njëjtën gjë.

E tha shumë mirë edhe zoti Kurteshi, për mocion përmbajtjesor për ndryshim të seancës duhet pasur kuorum, edhe ju e di, edhe sekretari që e ke afër, që është sekretar që mbi 10 vjet, i di rregullat dhe procedurat, por nuk e di pse duhet 50 herë të deklarohemi për një çështje të caktuar.

Ti thuaje veç një fjalë, e nderuar nënkryetare: a ke kuorum të ndërrosh rendin e ditës, të kalohet në seancën e re? Nëse ke, hidhe në votim, kalon, vazhdojmë, nëse nuk ke, vazhdojmë me seancën e vjetër. Kaq!

KRYESUESJA: Faleminderit! Të gjithë e dimë që nuk kemi kuorum për ta votuar mocionin. Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka, urdhëro Milaim!

MILAIM ZEKA: Unë, kryesuese, e mbështes propozimin e Ganimete Musliut, vazhdojmë me seancën e vjetër se u bëmë horë, asgjë s'jemi duke bërë, të vazhdojmë me seancën e vjetër deri në orën 18:00, në orën 18:00 mblidhet kuorumi, hyjmë në një seancë të re parlamentare, i votojmë ligjet, edhe kryeministri merr pauzë deri në orën 18:00, në orën 18:00 kthehet kryeministri për seancën e re, që është punë me rëndësi për neve të jetë shefi i ekzekutivit, edhe kaq, kaq e thjeshtë, edhe socialdemokratët janë të pajtimit me këtë dhe të gjithë deputetët vazhdojmë me të vjetrën, edhe Vetëvendosja në orën 18:00 vjen, edhe LDK-ja dhe hyjmë në seancë të re. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu-Kodra, urdhëroni!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, nënkryetare!

Pajtohem që pakoja e ligjeve, e cila do të vijë sot në Kuvend është tejet e rëndësishme për të përforcuar sundimin e ligjit dhe është shumë e rëndësishme për përmyllur procesin e liberalizimit të vizave.

Prandaj, po e them edhe në cilësinë e kryetares së Komisionit për Integritet që ne duhet të provojmë të gjejmë një konsensus veçanërisht për tema të cilat janë të rëndësishme për Agjendën e Reformave Evropiane.

Prandaj, pajtohem që kjo seancë të mbahet në orën 18:00 dhe ne deri atëherë të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës që i kemi në seancën e sotme. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka kryeministri i Republikës së Kosovës, zoti Ramush Haradinaj. Urdhëroni, kryeministër!

KRYEMINISTRI RAMUSH HARADINAJ: Vetëm të dakordohemi që seanca të vazhdojë në orën 18:00, do të jemi bashkë dhe i kisha lutur deputetët që të jenë të gjithë prezentë, mundësisht.

KRYESUESJA: Faleminderit, kryeministër!
Vazhdojmë seancën.

Zonja Safete Hadërgjonaj, urdhëro!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesuese!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me planin vjetor të punës ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit numër 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Për këtë qëllim, komisioni caktoi një grup punues, i cili në bazë të planit të miratuar të veprimit ka realizuar vizitat në terren dhe janë zhvilluar takime me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse të drejtpërdrejta në zbatimin e ligjit.

Meqenëse kam qenë kryesuese e këtij grupi punues, unë dua t'i falënderoj të dy anëtarët e këtij grupi punues, zotin Blerim Kuqi dhe Ali Lajçi, si dhe stafin e administratës për një punë me përgjegjësi dhe shumë korrekte gjatë gjithë kësaj kohe, derisa kemi bërë monitorimin e këtij ligji.

Grupi punues ka realizuar vizita pune në Ministrinë e Financave, në Ministrinë e Administratës Publike, në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë, në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës dhe në Njësinë për Inteligjencë Financiare të Kosovës.

Komisioni, respektivisht grupi punues, pas takimeve që i ka realizuar dhe informatat që i ka siguruar nga përfaqësues dhe zyrtarë të institucioneve të ndryshme të lartpërmendura, vlerësoi se

në përgjithësi Ligji për bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare është i zbatueshëm.

Sistemi financiar në Kosovë është i qëndrueshëm dhe stabil si rezultat i rritjes së kreditimit, depozitave, pasurisë si dhe nivelit të ulët të kredive joperformuese, bankat janë stabile, likuide dhe solvente.

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës arrin të përmbushë detyrat dhe përgjegjësitë ligjore në licencimin dhe mbikëqyrjen e bankave komerciale dhe institucioneve të tjera financiare. Të gjitha bankat janë në pajtueshmëri të plotë me obligimet e tyre në lidhje me mbajtjen e llogarive, regjistrimet dhe pasqyrat vjetore të raportimit.

Gjithashtu bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucione financiare jobankare përgatisin raporte financiare mujore, periodike dhe vjetore, në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe të raportimit financiar dhe kërkesave të përcaktuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në pajtim me ligjin.

Çdo bankë dhe institucion mikrofinanciar ka të themeluar dhe i ka funksionale organet e tyre udhëheqëse, Komitetin e Auditimit, Komitetin e Menaxhimit të Riskut dhe në pajtueshmëri me kërkesat ligjore të Bankës Qendrore të Kosovës angazhojnë auditorë të jashtëm të pavarur dhe raportet e auditimit dërgohen po ashtu në Bankën Qendrore në baza vjetore.

Niveli i bashkëpunimit ndërinstitucional në mes të institucioneve përgjegjëse dhe të ndërlidhura në zbatimin e ligjit është vlerësuar i mirë dhe në nivel profesional.

Në kuadër të këtij bashkëpunimi të Bankës Qendrore të Kosovës dhe bankave dhe institucioneve mikrofinanciare dhe njësisë së inteligjencës financiare në çështje të ndërlidhura me raportimin e transaksioneve të ndryshme, me qëllim të parandalimit të pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit është vlerësuar i mirë dhe adekuat.

Sfidë për t'u trajtuar mbetet obligimi i kompanive të sigurimit dhe këmbimoreve si subjekte raportuese për të bashkëpunuar më afër me njësinë e inteligjencës financiare në raportimin e transaksioneve të dyshimta.

Po ashtu sfidë është evidentuar edhe nevoja për rritjen e kapaciteteve njerëzore dhe buxhetore të njësisë së inteligjencës financiare me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë të përcaktuara me Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit dhe Ligjin për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare.

Përkundër zbatueshmërisë së mirë të ligjit në fuqi, janë identifikuar disa gjetje, ndërsa më shumë është vlerësuar nevoja për plotësimet dhe ndryshimet e ligjit me qëllim adresimit të çështjeve për shkak të rrethanave të krijuara në zhvillimin e sektorit bankar me qëllim të avancimit të mëtejshëm të tij në lidhje me parimet e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, trajtimit të barabartë legjislativ të filialeve dhe degëve të bankave të jashtme, rregullimit më të mirë të ekspozimit financiar të bankës ndaj palëve të ndërlidhura si dhe harmonizimit të këtij legjislacioni me direktivat e Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Si rezultat, komisioni ka përpiluar raportin dhe ka propozuar 11 rekomandime për miratim në Kuvend, siç vijon:

1. Banka Qendrore e Republikës së Kosovës të kërkojë nga kompanitë e sigurimeve dhe këmbimoreve për bashkëpunim më të afërt me Njësinë e Inteligjencës Financiare të Kosovës për raportim të transaksioneve të dyshimta monetare në pajtim me Ligjin numër 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare dhe Ligjin numër 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

2. Institucionet mikrofinanciare si OJQ të përdorin fitimin e akumuluar për qëllime që janë themeluar dhe në përputhje me statusin e përfituesit të tyre publik.

3. Departamenti i Organizatave Joqeveritare në Ministrinë e Administratës Publike të revokojë statusin e përfituesit publik ndaj institucioneve mikrofinanciare OJQ që ushtrojnë aktivitete dhe përdorin fitimin e akumuluar për qëllime të kundërta për çka është themeluar dhe nuk raporton me rregull dhe sipas kriterëve ligjore të përcaktuara me Ligjin numër 04/L-57 për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

4. Qeveria të fillojë procedurat për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare, me qëllim të harmonizimit të mëtejshëm të këtij ligji me direktivat e Bashkimit Evropian që rregullojnë këtë fushë dhe përafrimin e tij me standardet e Komitetit të Bazelit në përputhje me këto standarde për mbikëqyrjen e bankave.

5. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të përfshihen definicionet të reja si: ekonomia e lirë e tregut, qeverisja korporatave, ekspozimet maksimale që janë në funksion të sqarimit të aktiviteteve ekonomiko-financiare dhe bankare që ushtrojnë bankat komerciale.

6. Me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 04/L-93 të rishikohet neni 20 me qëllim të përcaktimit të obligimit të bankave për adresimin e të gjitha kategorive kryesore të rrezikut, të cilave u ekspozohen si rezultat i aktivitetit të tyre.

7. Në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 04/L-093 të përfshihen dispozitat për trajtimin e barabartë legjislativ të filialeve dhe degëve të bankave të jashtme sa i përket themelimit të Bordit të drejtorëve në Kosovë dhe obligimit të plotësimit të kriterëve ndaj ekspozime të mëdha të rreziqeve.

8. Në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit numër 04/L-093 për bankat dhe institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare të rishikohen kushtet e kufizimet e ekspozimit financiar të bankës ndaj palëve të ndërlidhura.

9. Në ndryshimet dhe plotësimet e këtij ligji kemi rekomanduar të ndryshohen dispozitat e raportimit financiar për bankat, me qëllim që raportimi financiar të bëhet vetëm sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar.

10. Në ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të rregullohet çështje e eliminimit të kufijve numerikë për t'i adresuar ato përmes legjislacionit sekondar.

11. Ministria e Financave të rrisë kapacitetet njerëzore dhe buxhetore në Njësinë e Inteligjencës Financiare me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësive të përcaktuara me Ligjin numër 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimit të financimit të terrorizmit dhe Ligjit numër 04/L-093 për bankat, institucionet financiare dhe institucionet financiare jobankare.

Këto ishin rekomandimet, të cilat grupi punues i ka paraqitur në komision, komisioni i ka votuar. Kështu që i ftoj të gjithë deputetët që të miratojnë raportin me rekomandime, të cilat i kemi gjetur në bazë të monitorimit të Ligjit për bankat dhe institucionet mikrofinanciare, institucionet financiare jobankare. Faleminderit!

Nëse më lejohet, edhe në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, jap qëndrimin e grupit që ne do ta miratojmë këtë raport, të cilin domethënë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për ta miratuar këtë raport të monitorimit të këtij ligji. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, nënkryetare e komisionit! Kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesit e Grupit Parlamentar LDK nuk janë prezentë, PDK e kemi kryer. Grupi Parlamentar Lëvizja Vetëvendosje, nuk janë. Grupi Parlamentar PSD, Grupi Parlamentar AAK, Lista serbe, Nisma dhe 6+. Nuk ka të paraqitur, nuk kemi kuorum për të votuar.

- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e raportin me rekomandime.

E ftoj kryetaren e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Personat e Pagjetur dhe Peticione, në të vërtetë zëvendëskryetaren e komisionit, Luljeta Veselaj-Gutaj për paraqitjen dhe arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëroni, Luljeta Veselaj-Gutaj.

LULJETA VESELAJ-GUTAJ: Faleminderit, e nderuar kryesuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar ministra,

Të nderuar qytetarë,

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, duke u bazuar në nenin 73 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, si dhe në bazë të planit të punës në Komisionin Funkcional ka bërë monitorimin e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi. Gjatë monitorimit të zbatimit të ligjit janë identifikuar dhe janë listuar të gjetura faktike lidhur me zbatimin e Ligjit me institucionet kompetente.

Grupi punues mbi bazën e të gjeturave faktike ka hartuar raportin për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, të cilit ia ka paraqitur Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione për shqyrtim dhe miratim dhe komisioni ka miratuar raportin e monitorimit të ligjit në mbledhjen e mbajtur më 22.10.2018. Në takimet dhe vizitat monitoruese të ligjit, grupi punues ka gjetur se Zyra për qeverisje të mirë ka mungesë të stafit, një gjë e tillë përmendet edhe në Raportin e Progresit dhe kërkohet nga autoritetet kompetente që të përkrahët kërkesa e ZQM-së për rekrutimin e zyrtarëve të rinj.

Zbatimi i rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga ana e Zyrës për qeverisje të mirë për vitin 2017 kryesisht është përmbushur me sukses, ndërsa për vitin 2018 është rritur minimumi i kuotës së rekomandimeve, të cilat duhet të zbatohen. Sa i përket komponentës së arsimit, më të diskriminuarit ndihen komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian. Sa i përket komponentës së mirëqenies sociale, më të diskriminuar ndihen personat me aftësi të kufizuar, ndërsa për komunitetin e të shurdhërve është bërë progres dhe me zyrtarizimin e gjuhës së shenjave, ku secili qytetar i shurdhër në Republikën e Kosovës që ka nevojë i mundësohet të ketë interpretues në gjuhën e shenjave. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi i mundëson çdo personi që pretendon se është viktimë e diskriminimit që ka të drejtë të parashtrijë padi kundër të paditurit dhe t'i ndër marrë të gjitha veprimet juridike në gjykatën kompetente.

Ndërsa, nga ana tjetër, Kodi Penal në fuqi çështjen e diskriminimit nuk e trajton si vepër penale. Mundësia e zhvillimit të disa procedurave në të njëjtën kohë, sipas vlerësimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, e vështirëson zbatimin e ligjit dhe kjo e bën ligjin të jetë i pazbatueshëm. Sipas Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk ka asnjë rast në gjykata që është vendosur në bazë të këtij ligji që nga hyrja në fuqi e Ligjit në vitin 2015. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal me shpresë zyrtare u është drejtuar të gjithë kryetarëve të komunave për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, si dhe Rregullorja për mekanizmat institucionalë për mbrojtje nga diskriminimi në Qeveri dhe në komuna. Deri më tani, vetëm 19 komuna kanë caktuar zyrtarin përkatës për mbrojtjen nga diskriminimi, e që kryesisht në këtë pozitë janë caktuar zyrtarë ekzistues për barazi gjinore që njëkohësisht kanë qenë edhe koordinatorë të njësive për të drejtat e njeriut.

Deri më tani, 18 ministri kanë zgjedhur zyrtarin për mbrojtjen nga diskriminimi, sipas Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Asnjë komunë deri më tani, si dhe 5 ministri nuk kanë përcaktuar një zyrtar të vetëm, i cili do të ishte përgjegjës për t'i koordinuar dhe raportuar lidhur me zbatimin e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi. Sipas zyrtarëve të Ministrisë së Administrimit dhe Pushtetit Lokal, problem kryesor për mosshpalljen e konkurseve për komuna për plotësimin e këtyre pozitave për zyrtarë për mbrojtjen nga diskriminimi ka qenë mungesa e buxhetit.

Komisioni, duke u mbështetur në të gjitha të gjeturat faktike gjatë procesit të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, në mbledhjen e mbajtur më 22. 10. 2018 vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime:

Rekomandimi i parë është se Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtjen nga diskriminimi në strategjinë legjislative për vitin 2019 dhe,

Rekomandimi i dytë është se Qeveria e Republikës së Kosovës në Projektligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 të parashohë kosto financiare për rekrutimin e zyrtarëve për mbrojtje nga diskriminimi nga ana e komunave në pesë ministritë e Qeverisë së Republikës së Kosovës, ku kjo pozitë është e pambuluar në pajtim me nenin 11 të Ligjit nr. 05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi. Unë ju falënderoj për vëmendje dhe kërkoj mbështetje që këto rekomandime të votohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nëse ka mundësi të flas edhe në emër të grupit? Grupi i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin dhe ne si grup parlamentar u japim mbështetje këtyre rekomandimeve dhe kërkojmë nga kolegët deputetë që ta votojnë raportin. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, nënkryetare e komisionit! Nuk ka të paraqitur për diskutim, nuk kemi kuorum për të votuar. Vazhdojmë me pikën tjetër:

- Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017

Komisioni FunkSIONAL për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit të Pavarur për media për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Tani ftoj kryetarin e Komisionit për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, zotin Nait Hasani, nuk është. Nënkyetari i komisionit?

Zonja Shqipe Pantina, urdhëroni!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesuese! Në fakt, unë jam nënkryetare e komisionit, por nuk kam marrë autorizim nga kryetari i komisionit për ta paraqitur raportin dhe nuk më ka njoftuar se ai nuk do të jetë këtu, prandaj unë nuk e kam as raportin përpara dhe nuk mund të flas në emër të komisionit, më vjen keq.

KRYESUESJA: Faleminderit, nënkryetare! Fjalën e ka Rasim Selmanaj.

RASIM SELMANAJ: Faleminderit!

Unë flas në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës.

E nderuar kryesuese,

Raporti vjetor i KPM-së për vitin 2017 ka kaluar në dy komisionet e Kuvendit, pra në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe në Komisionin për Administratë, Qeverisje Lokale dhe Media. Ky raport paraqitet me përmbushje të detyrimeve të parashikuara në pajtim me Ligjin nr. 04/L-044 për KPM-në.

Raporti nxjerr në pah vështirësitë që i ka KPM-ja për zbatimin e detyrimeve që derivojnë nga Ligji për digjitalizimin e transmetueseve. Moskalimi i strategjisë për digjitalizim në Qeveri po e vështirëson kalimin nga transmetimet analoge në ato digjitale, e ky fakt po e pamundëson publikun e gjerë që të kenë më shumë programe pa pagesë dhe me cilësi të lartë. Gjithashtu, digjitalizimi si proces ka shpërfaqur edhe problematikat tjera, si interferimin e frekuencave të shteteve fqinje me mbi 48% në territorin e Kosovës. Problematikë kjo, e cila duhet të na bëjë të reflektojmë ne si Kuvend dhe ta adresojmë si situatë me prioritet të lartë shtetëror.

Të nderuar deputetë,

Duke e ditur rolin dhe rëndësinë e medias, si dhe zhvillimin enorm të teknologjisë mediale në botë, duhet të jemi të vetëdijshëm për vështirësitë financiare të paraqitura nga Komisioni i Pavarur i Mediave. Në këtë pikë kërkoj rritje të buxhetit duke ruajtur pavarësinë institucionale, me një zhvillim të pluralizmit medial që u shërben të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës. Kjo rritje mund të vijë qoftë nga Ministria e Financave, qoftë duke u lejuar atyre që të hyrat që

gjenerojnë nga licencat të përdoren për zhvillim të mëtutjeshëm të tyre. Kjo do të mundësonte që rregullatori të jetë në trend me rregullatorët në rajon dhe më gjerë.

Grupi Parlamentar i AAK-së i jep përkrahje këtij raporti. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Tani ftoj kryetarin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, zotin Lumir Abdixhiku, nëse do, nënkryetarja e komisionit, zonja Safete Hadërgjonaj, urdhëroni!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryesuese!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Komisioni i Pavarur për Media ka dorëzuar në Kuvend raportin financiar vjetor për vitin 2017 sipas të dhënave të kërkuara me ligj.

Raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe klasifikimet për vitet paraprake. Buxheti fillestar i ndarë për Komisionin e Pavarur për Media për vitin 2017 ka qenë 1 214 275 euro, ndërkaq buxheti përfundimtar ishte 764 mijë e 275 euro, duke përfshirë ndryshimet që kanë ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe shkurtimet sipas vendimit të Qeverisë në pajtim me Ligjin për buxhetin. Nga kjo shumë janë shpenzuar 728 952 mijë euro, apo 95,38%. Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë: paga dhe mëditje 95,42%, mallra dhe shërbime 85,31% dhe shpenzime komunale 95,73%. Komisioni i Pavarur për Media ka realizuar të hyra në shumën prej 206 362 euro dhe këto të hyra janë derdhur në buxhetin e Republikës së Kosovës, ashtu siç e parasheh Ligji për menaxhimin e financave publike. Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 26. 6. 2018, pasi shqyrtoi raportin vjetor financiar të Komisionit të Pavarur për Media për vitin 2017, ka vlerësuar se raporti i përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësive dhe i rekomandon Kuvendit ta miratojë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, nënkryetare! Fjalën e ka deputetja Shqipe Pantina, urdhëroni!

SHQIPE PANTINA: Faleminderit, kryesuese!

Tani unë flas në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialdemokrate. Raporti i Komisionit të Pavarur për Media natyrisht se paraqet gjendjen reale në këtë institucion. Edhe vitin e kaluar Komisioni i Pavarur është ballafaquar me disa vështirësi, kryesisht edhe për shkak të mbështetjes së pamjaftueshme financiare, sidomos për një proces të rëndësishëm në fushën e zhvillimit të mediave në Kosovë, e që është procesi i digjitalizimit, për të cilin Qeveria ende nuk e ka miratuar strategjinë, e pa miratimin e kësaj strategjie Komisioni i Pavarur për Media nuk mund të fillojë procesin e digjitalizimit në vend.

Prandaj, Qeveria do të duhej që sa më parë ta shqyrtonte strategjinë dhe ta miratonte atë, duke ndarë edhe buxhetin e nevojshëm, në mënyrë që Komisioni i Pavarur i Mediave të fillojë me procesin e digjitalizimit. Po ashtu, komisioni, gjegjësisht bordi ka pësuar disa ndryshime për shkak të kalimit të afatit të anëtarëve më herët dhe bordi i ri si duket ende nuk ka filluar në përmbajtjen e plotë që të funksionojë si duhet, por kjo nuk është problem sa është problem çështja e ndikimeve politike që ka ndodhur te ky komision, e të cilat kanë bërë që komisioni të marrë disa vendime, për të cilat pastaj të shqyrtohen, bile edhe të hedhen poshtë nga Komisioni për Ankesa.

Prandaj, thirrja ime është te politika, gjegjësisht edhe te kolegët e mi deputetë që të mos bëjnë presione te asnjë institucion i pavarur, e në veçanti këtu te Komisioni i Pavarur i Mediave. Ne u kemi besuar mandatin, kemi besuar në profesionalizmin e tyre, prandaj le t'u lëmë ata ta bëjnë punën e tyre, por t'i kryejmë ne obligimet tona edhe si Kuvend, por edhe si Qeveri në këtë rast, duke miratuar strategjinë për digjitalizim dhe duke ndarë buxhetin e nevojshëm që ky institucion, si dhe institucionet e tjera t'i kryejnë përgjegjësitë, të cilat i kanë të përcaktuara me Kushtetutë. Pra, në parim ne e votojmë raportin, sepse siç thashë, e paraqet gjendjen reale në këtë institucion. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka, urdhëroni!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Edhe ne i japim mbështetje raportit, por desha vetëm dy fjalë për të vazhduar pak rreth diskutimit të deputetes Shqipe Pantina. Është e vërtetë se edhe unë si anëtar i Komisionit të Pavarur të Mediave kam informacione se grupe të ndryshme politike edhe brenda Parlamentit, edhe jashtë Parlamentit, janë duke u munduar të ushtrojnë presion ndaj Komisionit të Pavarur për Media për marrjen e vendimeve të ndryshme, të cilat do t'i kushtonin shumë buxhetit të Qeverisë së Kosovës.

Prandaj, ideja jonë ka qenë edhe në takimet tona të drejtpërdrejta me KPM-në që ata të marrin vendime të veta të pavarura, ani pse janë të zgjedhur nga Parlamenti i Kosovës, dhe na kanë nën mbikëqyrje ne si Komision i Pavarur i Mediave, por ky ka qenë sugjerimi ynë. Sa i përket çështjes së digjitalizimit, ne mendojmë se kjo është një çështje më shumë që i përket Parlamentit për të ndarë buxhetin, por pak a shumë ka edhe barriera politike për shkak të frekuencave, të cilat do të diskutohen më vonë. Ne si grup parlamentar edhe një herë po them që i japim mbështetje këtij raporti.

KRYESUESJA: Faleminderit! I kemi kryer diskutimet, për votim nuk kemi kuorum. Vazhdojmë me pikën tjetër:

- Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike lidhur me raportin vjetor të auditimit për vitin 2017

Komisioni Funkcional për Mbikëqyrje të Financave Publike e ka shqyrtuar raportin vjetor të auditimit për vitin 2017 të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe Kuvendit i ka paraqitur për miratim rekomandimet lidhur me këtë raport.

E ftoj Auditorin e Përgjithshëm, zotin Besnik Osmani, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë raportin vjetor të auditimit për vitin 2017. Urdhëroni, zoti Besnik Osmani!

BESNIK OSMANI: E nderuar kryesuese,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Në pajtim me përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore, më lejoni që të sjell para jush mendimin tim si Auditor i Përgjithshëm për pasqyrat vjetore të buxhetit fiskal 2017 dhe për mbledhjen e rezultateve individuale të auditimit, të rregullsisë dhe auditimit të performansës të realizuara në vitin 2017.

Në pajtim me planin vjetor, Zyra Kombëtare e Auditimit gjatë këtij viti ka publikuar 118 raporte, të cilat ofrojnë informata të besueshme për shpenzimet rreth 2 miliardë eurove të parasë publike dhe disa fonde të donatorëve. Këto raporte përfshijnë: 100 raporte të auditimit të rregullsisë të dy organizatave buxhetore, nëntë ndërmarrje publike, shtatë projekte të financuara nga donatorët, nëntë auditime të performansës.

Cilësia e raportimit - Përgjithësisht mund të thuhet se cilësia e raportimit dhe saktësia e informatave, pasqyra individuale në raportin e Qeverisë është përmirësuar dhe janë respektuar standardet e raportimit.

Sidoqoftë, përveç 77 opinioneve pozitive të auditimit, janë dhënë 25 opinione me rezervë, apo të modifikuara. Shqetësues është fakti që asnjë nga nëntë ndërmarrjet publike të audituara nuk kanë opinion pozitiv dhe ky është një tregues se raportimi i tyre ka mangësi serioze.

Shkalla e realizimit të pranimeve në krahasim me buxhetin fillestar është 91 për qind. Realizimi i pagesave kundrejt buxhetit fillestar ka qenë rreth 88 për qind. Kjo tregon se planifikimi fillestar i buxhetit kërkon analiza më të mira para se i njëjti të miratohet. Gjatë vitit 2017, me vendime të Qeverisë, buxheti ka pësuar ndryshime të dukshme dhe në fund të vitit ka rezultuar me 95 për qind të shpenzimeve të buxhetit përfundimtar.

Shuma maksimale e lejuar e deficitit ishte 128 milionë, apo dy për qind e bruto-produktit. Shuma e aprovuar ishte 96,5 milionë, apo 1,5 për qind, ndërsa deficitit faktik ishte 49 milionë, apo 0,8

për qind. Pra, Qeveria ka mbajtur nën kontroll deficitin dhe ai është brenda kufijve të lejuar me ligj.

Sa i përket borxhit publik, shuma është mbi një miliard euro, duke llogaritur edhe 44 milionë të garancive shtetërore. Niveli i borxhit publik në fund të vitit 2017 ka qenë 16,7 e bruto-produktit vendor. Theksi ynë lidhur me këto borxhe është mosefikasiteti i shpenzimeve, pasi 295 milionë euro kredi që nga viti 2014 ende nuk janë tërhequr për shkak të vonesave në fillimin dhe realizimin e projekteve, ndërkohë që shuma të konsiderueshme të shpenzimeve dhe tarifave të tjera janë paguar brenda kësaj periudhe, rreth 19 milionë euro të Buxhetit të Kosovës.

Marrë parasysh këto që u thanë deri më tani dhe në bazë të shumë të dhënave të detajuara të raportit tonë, mund të themi se nuk ekziston ndonjë kërcënim serioz i stabilitetit financiar. Megjithatë, ne kemi shpalosur në këtë raport disa probleme serioze që ndikojnë në bilancin e buxhetit dhe unë do t'i veçoja tri:

E para, detyrimet e papaguara dhe ato kontigjente. Detyrimet e papaguara të organizatave buxhetore ndaj operatorëve ekonomikë në fund të vitit kanë qenë 200 milionë. Prej tyre, 170 milionë të nivelit qendror, 30 milionë të nivelit komunal. Përveç këtyre detyrimeve, ekzistojnë edhe disa detyrime kontigjente apo potenciale, të cilat janë rezultat i padive gjyqësore dhe pritet ta marrin epilogun. Shuma e këtyre detyrimeve të mundshme është 140 milionë, 76 në nivelin qendror dhe 66 milionë në nivel lokal. Pra, këto dy lloje të detyrimeve, nëse realizohen, arrijnë vlerën prej 340 milionë euro që mund t'i bëjnë presion Buxhetit të Kosovës.

Sa u përket llogarive të arkëtueshme, po aq sfiduese është për Qeverinë, sepse borxhet e pambledhura nga qytetarët dhe bizneset kapin shumë prej 565 milionë eurove. Prej tyre janë 403 milionë në nivel qendror dhe 162 milionë në nivel lokal. Pjesa dërmuese e këtyre borxheve të pambledhura ka të bëjë me Administratën Tatimore dhe Doganat, të cilat së bashku përbëjnë 364 milionë borxhe të pambledhura, apo 65 për qind të shumë totale. Kjo sjell rrezikun real që për shkak të vjetërsisë së tyre të shndërrohen në borxhe të këqija dhe të mos inkasohen asnjëherë.

Sa u përket pasurive dhe stokeve, regjistrimi i pasurive në kontabilitetin qeveritar mbetet një proces i papërfunduar. Procesi i regjistrimit është i ngadalshëm dhe larg përfundimit. Shuma totale e regjistruar e pasurive të shtetit është më pak se 8 miliardë euro. Prej tyre 6,4 miliardë janë pasuri të regjistruara vetëm në nëntë komuna dhe në pesë ministri, ndërsa 1,7 miliard janë regjistruar në 78 organizata të tjera buxhetore. Përveç regjistrimeve kontabël të pasurive, pjesa dërmuese e organizatave nuk e bëjnë inventarizimin e pasurisë për ta vlerësuar përdorimin e tyre. Mungesa e regjistrimit në fund të vitit krijon mundësinë e keqmenaxhimit dhe të keqpërdorimit të pasurive.

Për shkak të mospagesës së obligimeve me kohë të organizatave buxhetore, Thesari ka ekzekutuar 20 milionë euro pagesa në bazë të Ligjit për menaxhimin e financave publike, nga të cilat 8,6 milionë si pagesa direkte në llogari të operatorëve dhe 11,5 milionë euro sipas vendimeve të gjykatave.

Rezultatet e auditimit të ndërmarrjeve publike shpalosin pasqyrat e pasakta dhe gjendjet e tyre financiare të vështirë. Këto nëntë ndërmarrje që i kemi audituar vitin e kaluar e kanë një shumë të kredive prej 95 milionë eurove. Aftësia e tyre likuiduese për kthimin e këtyre kredive është e dobët, duke marrë parasysh faktin se të gjitha janë në kufijtë e rentabilitetit, e disa operojnë edhe me humbje. Qeveria jep një shumë të konsiderueshme të subvencioneve për mbulimin e deficiteve dhe për sa kohë vazhdojnë trendët e tillë në këto ndërmarrje, barra financiare e Qeverisë do të ngarkohet edhe më shumë.

Vitin e kaluar ne kemi dhënë 1 177 rekomandime. Prej tyre plotësisht janë zbatuar 395 apo 34 për qind, pjesërisht 311 apo 26 për qind, dhe nuk janë zbatuar fare 471 apo 40 për qind. Rekomandimet me shkallë më të kënaqshme janë te institucionet e pavarura me 54 për qind, që pasohet nga Qeveria me 36 për qind, ndërsa më së keqi qëndron niveli komunal, komunat, me vetëm rreth 25 për qind, apo vetëm $\frac{1}{4}$ e rekomandimeve.

Përveç auditimeve financiare, ne kemi bërë shumë auditime të performansës. Disa nga to më të rëndësishme po i veçoj për ju. E para është efikasiteti i menaxhimit të lëndëve civile në gjykata, që nxjerr se pavarësisht përpjekjeve që janë bërë, gjykatat vazhdojnë të ballafaqohen me një numër të konsiderueshëm të lëndëve të vjetra të pazgjidhura, e në disa raste këto lëndë janë më shumë se 10 vjet. Për më shumë, numri i përgjithshëm i lëndëve civile është vazhdimisht në rritje dhe zgjidhja e tyre po merr shumë kohë.

Raporti i auditimit për mekanizmat e kontrollit të cilësisë të ajrit ka nxjerrë në pah se sistemi aktual i monitorimit dhe raportimit karakterizohet me parregullsi të shumta. Vetëm 17 për qind e stacioneve monitoruese kanë qenë funksionale gjatë vitit 2017, ndërkohë që 33 për qind e stacioneve kanë qenë jashtë funksionit gjatë shtatë muajve të vitit. Shqetësues është fakti që parametrat e rrezikshëm për shëndetin e njeriut janë evidentë dhe nuk janë raportuar mesatarisht katër muaj gjatë vitit 2007. Për më shumë, këta parametra në dy stacione e kishin tejkaluar sasinë e ndotjes në më shumë se 100 për qind.

Auditimet e sistemeve të teknologjisë informative e kanë përfshirë sistemin informativ shëndetësor, aplikacionin softuerik E-pasuria, sistemin informativ të tatimit në pronë, dhe përkundër investimeve që janë bërë nga Qeveria dhe ndihma ndërkombëtare, këto nuk kanë arritur ta sigurojnë një menaxhim efektiv dhe efikas në sistemet teknologjike. Qeveria nuk ka siguruar që këto sisteme plotësisht të jenë të besueshme dhe të jenë të sigurta dhe se ato i shërbejnë rritjes së efikasitetit.

Zbatimi i Sistemit Informativ Shëndetësor, që është realizuar nga viti 2014 deri në vitin 2017, nxjerr në pah se objektivi për shitjen e këtij sistemi në 30 për qind nuk është realizuar ende në vitin 2017. E-pasuria nuk funksionon dhe nuk ka operim të mirëfilltë të aplikacionit. Kjo ka hyrë në funksion në vitin 2010 për t'u mundësuar institucioneve publike të dhëna për gjendjen e pasurisë së tyre. Edhe pse Qeveria ka investuar një milion euro për krijimin e një data-baze qendrore të unifikuar për menaxhimin efektiv të pasurisë publike, kjo deri më tani nuk është realizuar.

Të nderuar deputetë,

Aktualisht ne kemi vazhduar në këtë vit me një plan për auditimet fiskale të vitit 2018. Kemi përfshirë organizata të reja. Për herë të parë kemi përfshirë katër ndërmarrje publike më shumë se vitin e kaluar, duke çuar në 12 nga numri zero sa ka qenë në vitin 2016 dhe i kemi shtuar dukshëm auditimet e performacës. Për herë të parë ne po auditojmë projekte të financuara nga fondet e auditorëve dhe tanimë po auditojmë edhe të gjitha projektet e financuara nga Banka Botërore.

Ne jemi në detyrë këtu për t' i ndihmuar Kuvendit dhe subjektet e auditimit dhe ky është misioni dhe qëllimi ynë primar. Ne nuk jemi në pozitë ligjore për të marrë asnjë vendim në emër të përdoruesve të buxhetit publik. Vendimet natyrisht që u takojnë bartësve të institucioneve dhe po provojmë ta përmbushim këtë mision duke i ofruar informata dhe përkrahjen e plotë në rend të parë Kuvendit, e pastaj edhe entiteteve të audituara.

Më lejoni që në fund të falënderoj për bashkëpunim korrekt që gjithë deputetët, në mënyrë të veçantë dy komisionet parlamentare, për Buxhet e Financa dhe për Mbikëqyrje Financiare, me të cilët kemi punuar gjatë gjithë vitit, dhe të mbyll prezantimin këtu, duke ju informuar që të gjitha detajet dhe informata janë në raportet tona, në 114 raporte, të gjitha janë të publikuara dhe janë në dispozicion edhe të Kuvendit, edhe të deputetëve. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Osmani! E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zoti Driton Selmanaj,... Nënkyetar i Komisionit, zoti Mërgim Lushtaku, urdhëroni!

MËRGIM LUSHTAKU: Përsëndetje!

Besoj se kryetari i Komisionit, Driton Selmanaj ka punë më të mençur sesa të jetë në Kuvend. Unë si nënkryetar i këtij komisioni po i lexoj rekomandimet që i kemi nxjerrë në këtë komision.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, në bazë të neneve 62 dhe 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 tetor 2018, e shqyrtoi raportin vjetor të auditimit për vitin 2017, me numër 06/1917-RA-025 të Zyrës Kombëtare të Auditimit dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këto rekomandime:

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i rekomandon seancës plenare miratimin e rekomandimeve të dala nga shqyrtimi i raportit vjetor të auditimit për vitin 2017.

Nën një, Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Qeveria e Kosovës që të implementojë të gjitha rekomandimet e dala nga raporti vjetor i auditimit për vitin 2017 dhe të raportojë me shkrim në Kuvend në fund të çdo tremujori të vitit 2019 për ecurinë e implementimit të këtyre rekomandimeve.

Në veçanti, Kuvendit të Kosovës i rekomandon Qeverisë si më poshtë:

1. Brenda tremujorit të parë të vitit 2019 të fillojë procesin e regjistrimit të të gjitha pasurive të pronës të institucioneve publike, të cilat nuk janë të regjistruar, nuk janë në regjistrat e pasurisë dhe ta përfundojë këtë aktivitet brenda afatit trevjeçar. Procesi i regjistrimit duhet të bëhet sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

2. Deri në fund të vitit ta hartojë programin e masave dhe të aktiviteteve për zvogëlimin e detyrimeve të papaguara dhe kontingjenteve dhe ky program të përfshihet në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve Publike, në mënyrë që të reflektohet në ligjin vjetor të buxhetit për tre vjetët e ardhshëm. Masat duhet të rezultojnë me përmirësimin e dukshëm të disiplinës financiare dhe pagesën e detyrime brenda afateve të përcaktuara ligjore.

3. Marrja e masave me aktivitete për përmirësimin e arkëtimeve në të gjitha organizatat buxhetore me qëllim të reduktimit të riskut për stabilitetin buxhetor dhe financiar të shtetit dhe që duhet të rezultojë me uljen e ndjeshme të vlerës së paarkëtueshme në periudhën e ardhshme trevjeçare. Kjo nënkupton, përveç tjerash, që të bëhet vlerësimi i vjetërsisë së llogarive të arkëtueshme, shkaqeve të vonesave dhe probabilitetit të arkëtimit të tyre, rritjen e shkallës së inkasimeve dhe që llogaritë e arkëtueshme të cilat vlerësohen si borxhe të këqija dhe të pambledhshme të trajtohen sipas standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.

Komisioni kërkon nga Kryesia e Kuvendit që ta ftojë Auditorin e Përgjithshëm për ta prezantuar në mbledhjen plenare të Kuvendit raportim vjetor të auditimit për 2017. Meqë e kemi bërë këtë gjë, e falënderoj Auditorin për këto paraqitje.

Më lejoni që edhe në emër të Grupit Parlamentar të shprehem që e kemi shqyrtuar këtë raport vjetor të Auditorit të Përgjithshëm Kombëtar dhe e mbështetim raportin në fjalë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Nuk kemi të paraqitur për fjalë. Bekim Haxhiu, urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Fillimisht para se të flas për raportin e Auditorit të Përgjithshëm të Zyrës së Auditimit, dua të tërheq vërejtjen që kur ta udhëhiqni seancën, dilni jashtë Rregullores, atëherë vazhdojeni me atë, replika, kundër-replika, replika, atëherë çfarë ndodh tutje, atëherë vazhdoje derisa të përfundojë ajo. Jo dikujt t'ia japësh të drejtën, dikujt tjetër jo.

Por, po kthehem te tema e raportit. Është një seancë e cila nuk ka shkuar si duhet kjo e sotmja dhe që nga fillimi, është më se evidente.

Edhe ne diskutuam më herët dy-tri orë për raportin e auditimit të Stacionit të Autobusëve dhe kryetari i Komisionit Parlamentar, Driton Selmanaj, e mbajti një demagogji të veten këtu, duke na folur për rëndësinë e raportimit dhe të shqyrtimit të atij raporti të Stacionit të Autobusëve të Prishtinës, e ka ikur tash kur është raporti i Auditorit të Përgjithshëm, atij që i ka bërë këto auditime, atij institucioni që i bën auditimet e të gjitha institucioneve publike. Ku është tash Driton Selmanaj me demagogjitë e tij?

Ku mbeti Driton Selmanaj të na tregojë kush janë ushtarët e vërtetë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, a jam unë i vërtetë, a është Dauti, Ahmeti, a Topi, a Antoni? Për kë e ka fjalën, kush janë ata ushtarët e vërtetë, le të na tregojë Dritoni se s'po e dimë ne. Ne që jemi me plagë në trup, ndoshta për Driton Selmanajn nuk jemi ushtarë të vërtetë. Ushtarë të vërtetë janë ata që e kanë dhunuar këtë popull, që e kanë masakruar, ndoshta ata mendon që janë ushtarë të vërtetë. Ata që kanë bërë këtu me mijëra krime, për ta janë ushtarë të vërtetë të Driton Selmanajt. Kush janë ata profesorë akuzues të Driton Selmanajt, sepse e ka marrë një shprehi ciu-ciu, disa ata, ata disa, ciu-ciu! Le të tregojë kush janë. Unë e kuptoj se sot është dita e vërtetë e Driton Selmanajt, është Black-Friday, e premtja e zezë.

Prej se mbahet në mend në institucionet që ka udhëhequr, shoqërinë civile dhe në politikë, Driton Selmanaj veç zi ka parë dhe veç zi ka folur.

KRYESUESJA: Ju lutem, zoti Bekim Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Prandaj, ia uroj sot ditën e zezë Black-Friday, Driton Selmanajt. Faleminderit!

KRYESUESJA: Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar Nisma, zoti Enver Hoti.

ENVER HOTI: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Unë dua ta falënderoj në emër të Grupit Parlamentar Nisma Socialdemokrate Auditorin e Përgjithshëm për paraqitjen që e pati, po ashtu edhe për raportin që e ka përgatitur, një raport i

cili është korrekt, është i strukturuar mirë dhe i cili paraqet të dhëna të mjaftueshme dhe reale mbi organizimin dhe menaxhimin e të gjitha organizatave buxhetore.

Ajo që dua të theksoj është se ende mbetet shqetësues moszbatimi i rekomandimeve nga institucionet, e kam fjalën për rekomandimet e Auditorit të Përgjithshëm. Edhe ashtu mbetet shqetësues mosregjistrimi i pasurisë dhe i pronave në institucionet publike dhe e inkurajojmë dhe është një nga rekomandimet, i cili kërkon që institucionet të veprojnë me urgjencë dhe të veprojnë në mënyrë të pandalshme që t'i kryejnë këto detyrime ligjore.

Është diçka risi për çka dua ta falënderoj Auditorin e Përgjithshëm për auditimin e ndërmarrjeve publike, e i cili deri më tani ka pasur ngecje apo mosangazhim në këtë drejtim dhe unë uroj që Auditori të vazhdojë me auditimin e këtyre ndërmarrjeve publike dhe bëj thirrje që të gjitha institucionet e vendit t'i zbatojnë rekomandimet e dala nga raporti i auditimit.

Ne e mbështetim dhe bëjmë thirrje për një mbështetje nga të gjithë deputetët e Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Hoti! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit AAK, zoti Blerim Kuçi.

BLERIM KUÇI: Faleminderit, kryesuese!

Ne e përgëzojmë për punën e vet Auditorin e Përgjithshëm, sepse është duke bërë një punë të mirë, pa marrë parasysh se duket se rezultatet e saj nuk janë të kënaqshme, sepse performansa e organizatave buxhetore nuk është e mirë.

Mirëpo, unë do të fokusohem në tri çështje që janë me rëndësi. Edhe Auditori i Përgjithshëm tha janë tri probleme: detyrimet e papaguara, mosregjistrimi i pasurisë dhe rezultatet e auditimit në ndërmarrjet publike. Pra, këto janë tri probleme kryesore. Mirëpo, për këto tri probleme na dha një përgjigje edhe zëvendëskryetari i Komisionit që ia bëri me dije edhe Qeverisë se rekomandimet dhe zbatimi i atyre rekomandimeve është shumë me rëndësi.

Është organi i vetëm, puna më kryesore për një performansë të Qeverisë është ky raport. Ky raport ka të bëjë me vitin 2017, pra kryesisht për një qeveri të kaluar. Mirëpo, do të vlejë, sepse qeveria aktuale Qeveria Haradinaj duhet të jetë shumë më e përkushtuar për çështjen e raporteve të auditimit.

Sot është dashur së paku pjesa kryesore e ministrave të jenë të pranishëm, pse jo edhe kryeministri. Pra, sot është dashur që ministrat të jenë të pranishëm këtu, sepse ka të bëjë ne performansën e tyre, e sidomos me njëllot zotimi për zbatimin e rekomandimeve. Qeveria duhet

ta krijojë një plan të zbatimit të këtyre rekomandimeve. Ashtu siç tha edhe zoti Lsuhtaku, ajo duhet të raportojë për zbatimin e këtij plani.

Në qoftë se nuk e bën, sidomos do të kemi probleme me problemin numër dy që e tha zoti Osmani, që ka të bëjë me mosregjistrimin e pasurisë. Ky proces ka filluar vonë. Jemi në fazën fillestare, por është shumë i rëndësishëm.

Qeveria jonë me të gjitha organizatat buxhetore, qoftë ato që varen prej Ekzekutivit, qoftë prej Legjislativit, qoftë qeveritë lokale, duhet t'i kushtojnë vëmendje të madhe regjistrimit të pasurisë. Duhet të bëhet një plan i zbatimit të veçantë, pak kanë nevojë edhe për këshilla, edhe për ndonjë këshillë sesi bëhet regjistrimi i pasurisë, sepse nuk e kanë përvojën e duhur.

Unë edhe një herë e falënderoj për ato rekomandime që i dha zoti Lushtaku nëpërmjet komisionit, dhe e thërras Qeverinë, e sidomos kryeministrin, që të punojë në hartimin e një plani për zbatimin e rekomandimeve që kanë të bëjnë me auditimin e përgjithshëm. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Milaim Zeka. Urdhëroni!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Veç desha një replikë me deputetin Blerim Kuçi, që më duket ishte në sallë, unë e lirova kryeministrin Haradinaj deri në orën 18:00, kështu që ky duhet ta tërheqë atë kritikën e tij.

Edhe Bekim Haxhiun e kisha lutur që të mos merret me njerëz që nuk janë në sallë!

KRYESUESJA: Faleminderit! E kemi përfunduar me diskutimet. Siç e dini, nuk kemi kuorum për votim. Vazhdojmë me pikën tjetër:

- Formimi i Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala

Deputeti Milaim Zeka, i mbështetur edhe nga pesë deputetë të tjerë, në bazë të Ligjit për hetim parlamentar, i ka propozuar Kuvendit formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen në PTK dhe Vala.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 20 tetor 2018, ka kërkuar nga grupet parlamentare të cilat nuk i kanë propozuar anëtarët që t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionin Hetimor Parlamentar sipas propozuesit.

Përbërja e komisionit do të jetë me 11 anëtarë. Grupet Parlamentare të LDK-së, të Lëvizjes “Vetëvendosje” dhe PSD-së i propozojnë pesë anëtarë, në mesin e tyre e propozojnë kryesuesin,

si dhe Grupet Parlamentare të PDK-së, AAK-së, Lista serbe, Nisma Socialdemokrate dhe 6+ propozojnë 6 anëtarë, në mesin e tyre e propozojnë edhe zëvendëskryesuesin e komisionit.

E ftoj deputetin Milaim Zeka që në cilësinë e propozuesit ta paraqesë propozimin për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar. Urdhëroni, Milaim Zeka!

MILAIM ZEKA: Faleminderit, kryesuese!

Së pari si deputet i Parlamentit të Kosovës jam shumë i lumtur që kam arritur që t'i bind kolegët e mi që për herë të parë, pas shumë përpjekjeve, ta krijojmë një komision hetimor për të gjitha skandalet të cilat kanë ndodhur në Postë-Telekomin e Kosovës dhe në Vala.

Unë mendoj që piramida e krimit është pikërisht në këtë institucion, duke mos i përjashtuar edhe institucionet e tjera. Prandaj, i ftoj kolegët, partitë politike, të cilat janë në sallë, edhe ata që nuk janë në sallë, që ta krijojmë një komision hetimor dhe t'u hyjmë rend me rend të gjitha skandaleve të cilat kanë ndodhur në këtë institucion.

Ne e dimë që vetëm kontrata e lidhur ndërmjet Valës dhe Z-Mobile është kontrata më shkatërrimtare e parasë publike të qytetarëve të Kosovës. E kam thënë në këtë foltore dhe po e ripërsëris se është njësoj sikur prindi im ose babai i çdo familjeje, një zot shtëpi të blejë një lopë për qumësht për t'i ushqyer fëmijët e vet, dhe e ka paguar lopën në treg, e ka ushqyer lopën, ndërsa qumështin e ka marrë komshiu dhe fëmijët kanë ngelur pa qumësht.

Kontrata me Z-Mobile i ngjason kësaj historie. Z-Mobile i ka marrë të gjitha shërbimet e Postë-Telekomit të Kosovës, të Valës në këtë rast, dhe e ka shkatërruar këtë institucion. Më mirë do të ishte sikur të shitej Vala për 100 dollarë në fillim kur ka dalë në privatizim. Sikur të shitej për 100 dollarë nuk do të kishte investuar dhe ky institucion nuk do të financonte grupe kriminale.

Mjafton sikur ta përmendim një rast, 4 milionë euro u janë dhënë në formë pagese mediave të nëntokës e të mbitokës, portaleve të ndryshme, gazetarëve, grupeve mafioze, vetëm për ta shkatërruar shtetin e Kosovës, dhe kjo ka qenë Vala. Prandaj, mbi bazën e kësaj ne duhet ta hetojmë këtë institucion dhe pastaj raportin final ta bëjmë publik këtu në Parlament të Kosovës.

Unë besoj se çdo deputet i Parlamentit të Kosovës që nuk ka interes të drejtpërdrejtë në këtë institucion është i interesuar që ta hetojë këtë institucion. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Daut Haradinaj. Urdhëroni!

DAUT HARADINAJ: Faleminderit, kryesuese!

Është e vërtetë që çdo komision hetimor parlamentar nuk ka asgjë të keqe, por meqenëse jemi duke folur rreth gjendjes për të kaluarën në PTK, unë kisha dashur që edhe në këtë seancë,

ndoshta edhe në të ardhmen e afërt, ta krijojmë një komision hetimor edhe për KEDS-in, i cili pothuajse 80% të Kosovës e ka lënë pa energji, pa i raportuar askujt për atë që po e bën.

KEK-u thotë ne nuk kemi obligime për furnizim me energji. KEDS-i andej thotë se kemi renovim, bëjmë ashtu, ndërsa implementimin e kontratës nuk e ka as për së afërmi.

Do të thotë, shpresoj që kolegët e mi kanë për ta trajtuar edhe këtë temë sikur PTK-në, sepse është e patolerueshme tash që kur temperaturat janë kaq të ulëta, e ne lexojmë nëpër media se shumica e zonave në Kosovë nuk kanë energji. Do të thotë, duhet edhe si Parlament në njëfarë forme ta kryejmë detyrën tonë që të shohim ku është gjendja, ku ka probleme dhe pse nuk furnizohet me energji qytetari i Kosovës. Në parim, e përkrahim komisionin hetimor. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, deputet! Fjalën e ka deputeti Dardan Sejdiu.

DARDAN SEJDIU: Faleminderit!

Mendoj që një prej instrumenteve të cilat Kuvendi duhet çdo ditë e më shumë t'i fusë në përdorim janë komisionit hetimor parlamentar. E sidomos duke i pasur parasysh, si të themi, orvatjet e dy dekadave të fundit me asete publike dhe pasurime private prej aseteve publike.

Unë po dua të ritheksoj, e para po them që e përkrahim këtë iniciativë dhe që në emër të PSD-së, pjesë e këtij komisioni hetimor do të jetë zoti Visar Ymeri. Por, duhet gjithsesi të ecim tutje me hetimin e kontratave dhe deputeti Haradinaj e përmendi edhe një, e që ka të bëjë me KEDS-in. Edhe në këtë do ta keni përkrahjen, e ndoshta edhe ne e nisim si iniciativë, meqë kam qenë edhe vetë goxha i zëshëm karshi sektorit energjetik në Kosovë, e sidomos kontratave të radhës që po vijnë.

Është tepër më rëndësi të kuptojmë që ajo që ka ndodhur 18 vjetët e fundit në Republikën e Kosovës me asetet publike ka qenë fare e thjeshtë. E kemi nacionalizuar humbjen, e kemi privatizuar fitimin. Pra, krejt barrën për mirëmbajtjen e Postës-Telekomit të Kosovës ia kemi lënë publikut, ndërmarrjes publike, ndërsa fitimin e kemi transferuar, apo e kemi bartur.

Njëjtë ka ndodhur me secilën ndërmarrje publike. Rrjedhimisht, një komision hetimor, i cili, nuk e di a keni specifikuar zoti Zeka, periudhën kohore për të cilën po dëshironi ta bëni hetimin. Besoj që është mirë edhe kjo të specifikohet në kërkesën tuaj. Të bëhet një punë, e cila ne si Kuvend na bën me dije me rekomandime të qarta sesi të dalim prej situatës së krijuar, jo vetën në Postë- Telekomin e Kosovës, po përgjithësisht në sektorin në fjalë.

Rrjedhimisht, Partia Socialdemokrate e përkrah dhe e propozon zotin Visar Ymeri si anëtar të komisionit. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti Muharrem Nitaj. Urdhëroni!

MUHARREM NITAJ: Faleminderit, zonja kryesuese!

Dua të them që në fillim se e kam mbështetur nismën e deputetit Zeka për krijimin e një komisioni hetimor parlamentar për situatën e krijuar në Postë-Telekomin e Kosovës. Nuk e pranoj absolutisht logjikën e zotit Zeka, i cili faktikisht e dha verdiktin e punës së këtij komisioni parlamentar, duke thënë se piramida e krimit në Postë-Pelekomin e Kosovës, faktikisht është vendosur, Postë-Telekomi i Kosovës e ka vendosur piramidën e krimit.

Milaim, nuk besoj për shembull akoma për pa e nisur punën do duhej që të paragjykohej për rezultatin përfundimtar. Unë dua të tërheq vërejtjen, për shembull, ne i kemi edhe dy komisione aktualisht parlamentare hetimore, të cilat janë duke e kryer punën e tyre. Dhe, dua t'i njoftoj kolegët deputetë që pjesa më e madhe e punës në këto komisione është shndërruar në njëfarëlloj lufte politike ndërmjet përfaqësuesve të ndryshëm të grupeve politike që marrin pjesë në këto komisione hetimore.

Nuk jam kundër që të krijohet komisioni hetimor. E mbështes edhe e logjikën e kolegut Sejdiu, i cili thotë, për shembull, që Parlamenti i Kosovës do duhej të krijonte më tepër komisione hetimore, por unë e kam drojën se këto komisione hetimore po shndërrohen në njëfarë lloj instrumenti të përplasjeve politike, dhe në fund të fundit nuk do të prodhojnë rezultat.

Sidoqoftë, unë e mbështes Milaimin, e lus që të përmbahet nga vlerësimet, nga gjykimet e tij për situatën e krijuar, meqenëse ai e ka propozuar një komision hetimor. Le t'ia lërë komisionit hetimor që ta bëjë punën e vet dhe në fund të dalë me raport dhe eventualisht ndoshta edhe të konkludojë, ose të vlerësojë se Posta dhe Telekomi i Kosovës janë shndërruar në piramidë të krimit.

Nga komisioni, faktikisht nga Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, në këtë komision do të jetë deputeti Shkumbin Demaliaj.

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit 6+, zoti Fikrim Damka.

FIKRIM DAMKA: Sayın başkan yardımcımız teşekkür ederim.6+ Parlamento Grubu bu komisyona üyesini kendi arasında istişar ettikten sonra yazılı bir şekilde başkanlığa iletacaktır.

KRYESUESJA: Fjalën e ka Hajdar Beqa.

HAJDAR BEQA: Faleminderit, kryesuese!

Përshëndetje kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike për formimin e Komisionit Hetimor Parlamentar në lidhje me gjendjen PTK dhe në Vala i propozon dy deputetë; zonjën Blerta Deliu-Kodra dhe zotin Bekim Haxhiu.

Në të njëjtën kohë kisha kërkuar nga anëtarët e komisionit, por në këtë rast edhe nga zoti Zeka që të mos raportojnë para se ta fillojnë punën, të bëjë paragjykime, po është një punë shumë konfidenciale që do të punojnë në harmonizim me Ligjin për hetim parlamentar dhe mendoj që në fund do të na vijnë me raport konkret. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka deputeti zotëri Haxhi Shala, nga Grupi Parlamentar Nisma. Urdhëroni!

HAXHI SHALA: Edhe Nisma për Kosovën e mbështet iniciativën e deputetit Zeka. Nuk e di me Rregullore a ka të drejtë që zoti Zeka të jetë anëtar i atij komisioni, pasi është propozues. Nëse ka të drejtë, zoti Zeka do të jetë anëtar nga Nisma për Kosovën në këtë komision. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Grupi Parlamentar LDK e ka propozuar Armend Zemajn anëtar, Haxhi Avdylin anëtar. Grupi Parlamentar i PDK-së propozon Bekim Haxhiun dhe Blerta Deliu. Grupi Parlamentar i PSD-së e ka propozuar Visar Ymerin. Grupi Parlamentar i AAK-së e propozon Shkumbin Demaliajn. Grupi Parlamentar Nisma e propozon Milaim Zekën.

Me mungesë të emrave për anëtarë të komisionit hetimor, kjo pikë shtyhet për seancën e radhës. Faleminderit! Vazhdojmë me pikën tjetër:

- Kërkesa e Grupit Parlamentar të PSD-së për caktimin e kryesuesit të Komisionit për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë

Grupi Parlamentar i PSD-së ka kërkuar nga Kuvendi emërimin e kryetarit të Komisionit Parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë nga radha e këtij grupi parlamentar.

Kryesimin e këtij komisioni e ka pasur Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje deri me dorëheqjen e deputetes Donika Kadaj-Bujupi. Marrëveshja ndërmjet grupit të Lëvizjes Vetëvendosje dhe të PSD-së nuk është arritur për këtë çështje. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PSD-së, Dardan Sejdiu, që ta arsyetojë kërkesën. Urdhëroni, zoti Dardan Sejdiu!

DARDAN SEJDIU: Faleminderit, kryesuese!

Në fakt, me themelimin e Grupit Parlamentar të PSD-së, formula e Kuvendit përcakton ndarjen e komisioneve sipas fuqisë së grupit parlamentar. Dhe, me formulë ndërmjet Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Grupit Parlamentar të PSD-së, neve na takon kryesimi i dy

komisioneve, në këtë rast veç se e kryesojmë Komisionin e Shëndetësisë dhe na takon edhe kryesimi i Komisionit për Agjencinë Kosovare të Inteligjencës.

Meqenëse nuk kemi hasur në dakordim nga kolegët e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje që kështu të ecim përpara, pra me dakordim ndërmjet dy palëve, tash pas gjashtë muaj orvatjesh është kërkesë e grupit tonë parlamentar që ky komision me votë të Kuvendit t'i jepet në kryesim Partisë Socialdemokrate.

Në këtë rast propozimi ynë për kryetarin e këtij komisioni është zoti Faton Topalli. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar zoti Zenun Pajaziti. Me kartelë, Zenun Pajaziti. Zoti Bekim Haxhiu, urdhëroni!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, e nderuar kryesuese!

Pasi u caktova në Komision Parlamentar për Hetimin e gjendjes në PTK dhe Vala, dua prej kryesuesi që të na e sqarojë, do të thotë sepse PTK-ja më si institucion si ka qenë përpara nuk është, është e ndarë në Postën e Kosovës dhe në Vala. Do të thotë, le të përmirësohet kjo që të jetë Posta e Kosovës dhe Vala, apo veç Telekomit dhe Vala? Kërkoj prej propozuesit që ta sqarojë këtë çështje.

KRYESUESJA: Faleminderit! E kemi kaluar këtë pikë. Për ta shqyrtuar këtë pikë nuk ka kuorum. Vazhdojmë në pikën tjetër:

- Kërkesa e Grupit Parlamentar të PSD-së për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike

Grupi Parlamentar i PSD-së ka propozuar zëvendësimin e deputetëve në Komisionin Parlamentar, si në vijim: Deputeti Faton Topalli propozohet për anëtar në Komisionin për Mbikëqyrjen e Financave Publike në vend të deputetit Visar Ymeri.

Kërkoj nga ju që me ngritje dore... nuk kemi kuorum, dhe Dardan Sejdiu e ka fjalën. Urdhëro, Dardan!

DARDAN SEJDIU: Kryesues, ne e tërheqim këtë propozim për momentin.

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Sejdiu! Me këtë i mbyll punimet e kësaj seance. Për vazhdimin e kësaj seance, vendos Kryesia. Faleminderit! Mirupafshim në seancën e radhës sonte, në orën 18:00!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*